

DEBATI MBI FILMAT E ISH-KINOSTUDIOS

PROPAGANDË APO PASURI KOMBËTARE?!

Studim



www.idmc.al

Instituti për Demokraci Media dhe Kulturë (IDMC)



Titulli: Debati mbi Filmat e Ish-Kinostudios
Propagandë apo Pasuri Kombëtare?!

Ky studim u përgatit nga Erblin Vukaj, gazetar dhe kërkues shkencor pranë
IDMC, në Dhjetor 2019.

Redaktore shkencore: Dr. Jonila Godole

Email: office@idmc.al, www.idmc.al

Ky botim u mbështet nga Fondacioni Konrad Adenauer, Zyra Tiranë



Grafika dhe faqosja: Iceberg Communication

Shtypshkronja: Gent Grafik

ISBN 978-9928-4482-6-2

© 2019 Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC)

Adresa: Rr. Bardhok Biba, Hyrja A, Kati 11, Tiranë

IDMC - Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë është një organizatë e pavarur, jo-fitimprurëse dhe joqeveritare me qendër në Tiranë. Aktiviteti i saj shtrihet në tri fusha të rëndësishme: demokracia, media dhe kultura. IDMC promovon zhvillimin e vlerave demokratike, rolin dhe impaktin e medias e të kulturës brenda dhe jashtë vendit.

DEBATI MBI FILMAT E ISH-KINOSTUDIOS

**PROPAGANDË APO PASURI
KOMBËTARE?!**

STUDIM

Instituti për Demokraci Media dhe Kulturë (IDMC)
Tiranë, 2019

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	7
HYRJE	15
1. KOMERCIALIZIMI I NOSTALGJISË	17
1.1 Debati për mostransmetimin	20
2. ADMINISTRIMI DHE TRANSMETIMI I FILMAVE TË ISH-KINOSTUDIOS.....	25
2.1 Historiku i administrimit të prodhimtarisë filmike.....	25
2.2 Transmetimi i materialeve propagandistike në televizionin publik.....	34
3. AUTORËSIA E FILMAVE TË ISH-KINOSTUDIOS DHE DEBATI I VITIT 2017.....	37
3.1 Tarifat - Sa vlejné filmat e “komunizmit”?.....	40
3.2 Metodologjia e tarifimit.....	44
3.3 Modele për një transmetim të denjë të filmave.....	52
4. PERSPEKTIVA NDËRKOMBËTARE PËR FILMAT E DIKTATURËS.....	54
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	62
SHTOJCË I: INTERVISTA.....	64
SHTOJCË II: “FILMAT E NDALUAR” DHE SHIKUESHMËRIA E TYRE.....	100
REFERENCA.....	135

LISTA E SHKURTIMEVE

Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Artistëve Interpretues/Ekzekutues	- AKDIE
Agjencia për Mbrojtjen e Producentëve	- AMP
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	- AQSHF
Autoriteti i Mediave Audiovizive	- AMA
Electronic Program Guide	- EPG
Forumi i Mbrojtjes së Autorëve të Audiovizualit	- FMAA
Geschiedenis Totalitaire Regimes en hun Slachtoffers	- SGTRS
Instituti i Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë	- IIPP
Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojat e Komunizmit	- ISKK
Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë	- IDMC
Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit	- KKDA
Kontrolli i Lartë i Shtetit	- KLSH
Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit	- MSA
Partia e Punës e Shqipërisë	- PPSH
Qendra Kombëtare e Kinematografisë	- QKK
Qendra Kombëtare e Biznesit	- QKB
Radiotelevizioni Shqiptar	- RTSH
Sporteli Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit	- SUADA
Televizioni Arbëria	- TVA
Zyra Shqiptare e të Drejtave të Autorit	- ZSHDA

PARATHËNIE

Agron TUFA

KINEMATOGRAFIA KOMUNISTE DHE INERCIA E SAJ TOTALITARE

“Sektori i kinematografisë ishte më i kontrolluari, më në shërbim të propagandës së regjimit komunist. Mjerisht ata që ishin kineastë, regjisorë, skenaristë, operatorë, megjithëse shkuan në shkolla të mira lindore, të mëkuar me modele nënash të ashpra, baballarësh komunistë, u kthyen dogmatikë dhe produktet e tyre janë të egër, pa lirisëm. Shikoni një film nga të paktët e periudhës komuniste që ka një skenë lirike: është një prift që don të përdhunojë një murgeshë të hijshme! E imagjiloni çfarë absurdi? Në filmat tanë nuk kishte humanizëm, nuk kishte histori dashurie, por kishte egërsi. Imagjiloni, dhe në filmat për fëmijë kishte mësim si të ishin vigjilentë, si të raportonin për armikun e klasës. Dogma e armikut të klasës ishte dominante”.¹

Ismail Kadare

1.

“E dini kush e ka bâ luftën?”

“Partizanët. Kush tjetër?”

“Joo ... E ke gabim! Luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare e ka bâ bash Kinostudio “Shqipëria e Re”.

1. <http://www.observatorikujteses.al/kadare-e-patoluerueshme-te-shihen-sot-ato-filma/>

Këtë fragment kuvendimi e kam dëgjuar në tetor të vitit 1989 mes një grup letrarësh të Institutit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër. Për herë të parë dëgjoja të shprehej një vërtetësi aq e esëllt nën maskën groteske të parodisë. E ky kinse-dialog i qëllimshëm grotesk, hamendësoj se duhet të ketë qenë shumë më i vjetër nga koha kur e dëgjoja për herë të parë. Çfarë sugjeronte morali i kësaj batute? Më së paku mprehjen e shqisë inteligjente për të nuhatur e refuzuar propagandën komuniste të servitur gjoja si art; për të mos rënë viktimë e manipulimeve, hiperbolizimeve, megallomanisë së krisur e të trashë të ushqimit indoktrinues përmes artit masovik të kinemasë. Batuta shkodrane për filmat e Kinostudios “Shqipëria e Re” (dhe gjithë batutat e tjera groteske mbi propagandën komuniste), provokonte mospranimin, alergjinë, kundërshtimin për t’u përpunuar si parafabrikat në ngrehinën gërdallë të diktaturës në prag të falimentit të saj të gjithanshëm. Por me apo pa ndihmën e një grotesku të tillë “apokrifik”, vetëm një pjesë e vogël e shoqërisë mundi t’i shpëtojë gjymtimit mendor e botëkuptimor. Mjerisht vetëdija masive e popullatës rezultoi e masakruar, e paaftë të analizojë e gjykojë mbi plojen rrënimtare që kishte bërë me ta e jetët e tyre, diktatura. Stadi i vetëdijes së tyre qytetare kishte mbërritur tashmë rezultatin e zombifikimit të plotë: skllavërinë e pakushtëzuar me të gjitha hallkat, atë që poeti nobelist polak, Çesllav Milosh e ka pagëzuar: “Njeriu i robëruar”.

2.

Homo sapiens-i ynë i robëruar nuk është në gjendje të bëjë ndonjë dallim midis diktaturës dhe lirisë. I rritur e i gatuar në epruvetën e eksperimentit ideologjik, ai, fatkeqësisht, pas rënies formale të diktaturës, nuk qe në gjendje të analizonte vetveten e botën përreth, të gjykonte çfarë ka ngjarë me të. Ashtu, i alienuar nga kushtet e lirisë, vakuumin e paemër që u hap para tij ai e mbushi me mosbesim, frikëra e pasiguri, përpos një dinakërie tipike për

t'u përshtatur – për mbijetesën fizike të llojit. E vetmja mbresë, të vetmet raporte të tij me botën – mbetën po ato të mëparshmet: mbushja ideologjike, propaganda, adhurimi i skllavit para faraonit, edhe pse i vdekur tashmë. I vetmi kanal i gjallë që e bën të ndihet gjallë është nostalgjia dhe përulja para atij zoti absolut pagan, që vran e kthjell, që të var e të vret, të burgos e të internon, të shqep në dru apo të dhuron një buzëqeshje premtuese.

Ky është arketipi i gjerë i nostalgjikut, formatit të zombifikuar të diktaturës, përndryshe – shikuesi dhe shijuesi i adrenalines së filmit shqiptar, të prodhuar nga kombinati i industrisë propagandistike komuniste – Kinostudio “Shqipëria e Re”. Ky ishte dhe vazhdon të jetë shikuesi i miliona herëve të filmave që Partia krijoi për të. Deri në vdekje! Po nuk është ky personazhi kryesor i incercisë tonë totalitare postkomuniste.

Në fakt disa nga këto që them në këtë parafjalë, do t'i gjeni të shtjelluara në këtë studim racional e empirik që Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC) i ofron lexuesve dhe studiuesve. Studimi mbi filmat e Kinostudios “Shqipëria e Re” e shtron qartë problemin se si duhet të sillemi ne sot, përballë kësaj trashëgimie të artit më popullor e më masovik, siç ka qenë kinemaja përgjatë gjithë shekullit XX dhe siç me të drejtë, kulturologët e kanë përcaktuar rolin e filmit si një mikser gjigand në përpunimin e vetëdijes masive. Studimi e vë theksin në një prej tumoreve që po e kalbëzon përditë shoqërinë tonë, me brerjen e saj konsekuente, si një gangrenë që përpin gjymtyrët e infektuara të të sëmurit. E ky tumor është imponimi i bashkëjetesës sonë në demokraci në një horizont dominues të krimit dhe gjenocidit kulturor masiv, siç dhe janë filmat e përçudshëm – dokumentarë e artistikë - të porositur nga Partia dhe KQ i PPSH në kombinatin masovik të quajtur Kinostudio “Shqipëria e Re”.

Studimi është një kontribut i çmuar njohës, ndërgjegjësues e meditativ mbi trashëgiminë më agresive propagandistike të diktaturës, të ngjallur në hapësirën e lirive demokratike. Çështjen e kësaj trashëgime të diktaturës ky studim e shtron midis alternativës “propagandë” apo “pasuri kombëtare”, duke ofruar historikun, të dhënat, konsultimet me shifra të matshme dhe pikëpamjet e palëve të kundërta në debatin e vitit 2017 mbi filmat e periudhës komuniste. Dukuria është parë në planin historiko-ideologjik, e mandej, se si nga kjo kufomë e artit, nxirren përfitime jo të vogla, tash e 30 vite, nga po ajo korporatë që i pati krijuar këto filma indoktrinues. Është po kjo korporatë autorësh, që dashje padashje ushtroi një kulturocid kombëtar në shërbim të propagandës, si në asnjë kulturë totalitare komuniste të Lindjes! Krahasimet dhe analogjitë nuk shkojnë, nuk rrinë në asnjë kontekst me artin kinematografik të kolegëve të tyre në vendet e “demokracive popullore”. Tashmë me kufomën e këtij kulturocidi filmik ushqehen autorët e tyre, dhjetra telekanale televizionesh kombëtare, publike e jopublike, televizione lokale, platforma të ndryshme të transmetimit analog dhe digjital. Korporata e autorëve të këtyre filmave, që i ka përshtatur e ujdisur mirë shoqatat e veta në akord me legjislacionin e “të drejtës së autorit”, e përhap molepsjen e vet për vite e vite përmes kontratash vjetore dhe na imponon kështu rehabilitimin moral, politik e “estetik” të një prej diktaturave më gjakatare të shekullit XX. Po për çfarë “të drejte të autorit” është fjala? Për çfarë “lirie të artit e të shprehjes” bëhet fjalë? Sepse këto janë pretendimet e autorëve dhe korporatës që prodhuan platformën më masive të kulturocudit shqiptar me rreth 250 filma, pjesa dërrmuese manipulativë, genocidiale, propagandistike, të ashtuquajtur “artistike”, përfshij dhe idilet e neveritshme që pudrosin e rehabilitojnë me gjoja humanizëm sistemin kriminal. E po t’i shtojmë kësaj hataje edhe rreth 1000 filma dokumentarë, kinoreportazhe e kronika, portrete heronjsh të popullit, portrete komunistësh e heronjsh të punës socialiste, fjalime të diktatorit dhe anëtarësh të KQ të PPSH,

serialet me Kongrese e Pleniume, deri dhe vdekjet e Besnikut të Partisë, Hysni Kapos dhe vetë diktatorit Hoxha, atëherë, tërë këto hije të errëta e të dendura të së shkuarës totalitare shkarkohen non stop nëpër shtëpitë e shqiptarëve edhe 30 vjet pas rënies së komunizmit! Ky është një atentat ndaj hapësirave të lirisë që thuhet se na i garanton kushtetuta. Të gjitha liritë janë shkelur, janë dhunuar! Lufta e klasave vazhdon, duke fyer sërish sensibilitete të gjera shoqërore – historike, sociale, politike, religjioze, diku mbi 30% e shoqërisë sonë. Dhe kjo nuk ka emër tjetër përveçse fyerje, ridënim, ripushkatim, rideklasim ku mijëra familje nuk kanë gjetur ende eshtrat e familjarëve të pushkatuar nga diktatura, që lëvdohet në këto filma, tok me xhelatët e saj, hetuesët, oficerët operativë të sigurimit, sekretarët e partive, deri tek fidanishtja e re, spiunët e vegjël të partisë.

Pra, nuk është e vërtetë pretenca e “pronës intelektuale”. Artistët e partisë i krijuan këto filma të kulturocidit masiv me urdhër të partisë dhe bekimin e saj. Morën famë, shpërblime e benefite. Nuk ua zëmë në gojë. Sepse pronar ishte shteti diktatorial. Tani, si qenka e mundur të na servirin si “pronë intelektuale”, një punë të paguar nga Pronari me emër PPSH? Pa llogaritur dëmin e inerteve toksike të propagandës diktatoriale, të këtij Çernobili kulturor. Ndërsa për mbrojtjen e po këtyre autorëve dhe Korporatës për të drejtën kushtetuese të “lirisë së veprës artistike e të shprehjes”, kush po i pengon? Le t’i krijojnë! Por nuk ka kushtetutë që mbron veprat propagandistike të kulturocidit komunist, për t’ia rishitur një shoqëria demokratike, që e ka lënë pas diktaturën.

3.

Kur së pari nisi debati mbi filmat e Kinostudios “Shqipëria e Re” shpresova fort, që argumentet që parashtrova, të vinin në lëvizje institucionet politike e ligjëbërëse të Republikës sonë. Fushata e

egër në media, nuk më gjeti të vetmuar, pasi të njëjtin mendim e botëkuptim ndanim ndërkohë me Dr Jonila Godolen e IDMC-së dhe me studiuesin Erald Kapri, në kryesinë e AMA-s. Sigurisht, kolegë të panumërt na mbështetën në këtë debat të shoqëruar me fyerje e mesazhe kërcënuese private. Kishim pra, një mirëkuptim të gjerë të opinionit intelektual dhe kundërshtari ynë i vetëm dhe histerik qe Korporata me shoqatat e autorëve të këtyre filmave të kulturocidit masiv. Njeri prej tyre më sulmon në intervistat e përfshirë në këtë libër, duke më krahasuar me nazistët e kohës së Hitlerit, që digjnin libra. Në fakt djegia e librave (apo filmave), sado të dobët apo agjitativë të kenë qenë, madje edhe kulturocidialë, siç janë filmat e Kinostudios “Shqipëria e Re”, është mënyra më e keqe e sjelljes me to: kjo vetëm se do ta shenjtëronte një art të dobët e propagandistik. Mënyra më e denjë e sjelljes me këto lloj veprash dihet, që është shpërfillja. Por shoqëria jonë nuk është në lartësinë intelektuale të shpërfilljes, si kundërpërgjigje: ajo është viktimë, kryesisht pasive. Prandaj dhe unë me kolegët e mi bashkëmendimtarë, sugjeruam një debat të hapur, ani pse përballë kishim një palë krejtësisht në konflikt të pastër interesi me objektin e diskutimit: autorët e filmave dhe, jo rrallë, mediat që i transmetonin këta filma. Pra, ne sugjeruam që ndaj kësaj trashëgimie toksike të diktaturës, të bëhej një qasje ligjore, jo për ndalimin e plotë të tyre (me përjashtim të një liste prej 50-60 filmash), por për kufizimin, filtrimin e tyre, vendosjen në kontekst orientues për recipientin. Këto hollësi propozon shkresa zyrtare që i nisa në emër të ISKK, Parlamentit shqiptar në fund të marsit 2017, për të cilën nuk morëm kurrë përgjigje. Informalisht na e bënë të qartë: Kryetari nuk do ta shtrojë kurrë në agjendë një çështje të tillë “sensitive”.

4.

Në një prej debateve televizive mbi filmat e kohës së komunizmit, kur propozova, që përveç orareve të vona të transmetimit të këtyre filmave, ato duhet të pajiseshin patjetër me një logo me shkronja të kuqe në cep, për shembull “PPSH”, një regjizor i njohur në studio u hodh si ta kishte pickuar gjarpri: “Kjo është e tmerrshme! Ne jemi artistë dhe nuk do të pranojmë kurrë të na damkosin punën tonë, artin tonë, siç damkosin delet”. Pa hyrë në analizën e këtij reagimi (që flet vetë), do shtoja vetëm kaq: këta autorë (e theksoj – me dashje apo padashje) nuk e patën problem, që nën direktivat e Partisë të damkosnin grupe të tëra popullatash si “armiqtë e popullit”, “diversantë”, “spiunë”, “sabotatorë”, “të shitur”, “amoralë”, të penalizonin e të falsifikonin ngjarje e persona historikë, të ushtronin një luftë fanatike klasash, etj., etj... ndërsa tani, kur qenë vetë ata që himnizuan vlerat kriminale të diktaturës, nuk pranuan një logo, që simbolikisht ndan dy epokat: lirinë me robërinë, dhe e quajnë këtë ndërhyrje “damkë”. Sinqerisht nuk kam pritur ndonjë reflektim më të mirë, aq më pak ndjesë prej tyre për lavazhin propagandistik, çfarë mund të kishte vend në këto 30 vite lirie, ndonëse formale. Por ta quash veten “artist” me këto vepra dhe kjo të të japë të drejtë të përcaktosh gjithçka, kjo është kundërthënëse. Artiste, regjisore shumë herë më e talentuar se gjithë bërlloku i Kinostudios ka qenë Leni Riefenstahl, regjisorja e dokumentarëve dhe paradave të Adolf Hitlerit (ka plot parada të Enverit në dokumentarët tanë, që transmetohen free), por më gjeni një rast që televizionet gjermane apo amerikane të transmetojnë filmat e saj!

Mospërgjigjja e kreut të Parlamentit dhe e klasës politike shqiptare për të ndërhyrë në këtë produkt agjitativ e propagandistik të diktaturës, që quhet film dokumentar dhe artistik i Kinostudios “Shqipëria e Re”, nënkupton haptas mungesën e vullnetit politik për të pastruar shoqërinë e sotme demokratike nga ndotja me inertet

totalitare. Ato vazhdojnë të lëshojnë rrezatimin e tyre të dëmshëm radioaktiv si inerci e diktaturës, duke provokuar e fyer një palë të shoqërisë dhe duke inkurajuar dhe ushqyer me nostalgji një palë tjetër nën pretekstin e “të drejtës së autorit” apo “lirisë së veprës artistike dhe shprehjes”. Kështu, horizonti totalitar është gjithnjë i pranishëm midis nesh, në çdo familje. Ai po përgatit habitatin e vet të natyrshëm midis nesh dhe, nëse vjen, do vijë pahetueshëm, përderisa ne kemi lejuar me dekada që ai (horizonti totalitar) të na jetë bërë shprehje e rëndomtë intime, të na jetë bërë familjar.

Debati mbi filmat e diktaturës dhe absurditetin e transmetimit të tyre sot, si të ishim në pikun e viteve '70, zgjati me muaj. Me gjuajtje nën brez. Kanalizimi institucional i çështjes, duke ua deleguar organeve më të larta ligjvënëse, dështoi, siç ka dështuar deri më sot kauza e dekomunistizimit të Shqipërisë. Trajtimi i trashëgimisë filmike të diktaturës mbetet pjesë esenciale e Platformës së Dekomunistizimit, nëse do të ketë ndonjëherë vullnet politik në Parlamentin shqiptar, ashtu siç dëshmoi vullnetin e vet në vitin 2011 Parlamenti i Ukrainës.

Por jam absolutisht kundër atyre nihilistëve që debatin e gjatë të vitit 2017 mbi filmin komunist, e quajnë të dështuar. Ne si inicues të debatit fituam një mirëkuptim shumë të gjerë shoqëror e intelektual. Por strukturat ekonomike të biznesit, elita politike dhe instancat ligjzbatuese nuk ndërmorën asnjë hap në përkrahjen e idesë sonë, duke lënë një perspektivë të ndotur estetike dhe etike për edukimin e brezave të rinj. E ka theksuar këtë amoralitet dhe shkrimtari Ismail Kadare, i cili iu bashkangjiti në këtë diskurs pikëvështrimit tonë, me konstatimin: “Është krejtësisht e pahijshme, e pamoralshme, e patolerueshme, që spektatori shqiptar t’i shohë sot ata filma, ku ka personazhe, fëmijë që spiunojnë në favor të regjimit”.

HYRJE

Komandanti: *Faredin, ke dëgjuar ndonjëherë ti, [që ne, partizanët] të djegim shtëpitë e fshatarëve tanë?!... Sa ballistë ka fshati juaj?*

Faredini: *Pesë...*

Komandanti: *Po mirë, ke parë t'u dalë tym çative të tyre, përveç tymit të oxhakut? Kur ne nuk djegim shtëpitë e ballistëve... se nuk duam vëllavrasje... atëherë si mund të djegim shtëpinë tuaj, more Faredin?!*

Fragment nga filmi “Njeriu me Top” (1977). Ballafaqimi mes fshatarëve, pasi Mato Gruda qëllon me top shtëpinë e Faredinit.

Televizioni publik shqiptar, por edhe televizione të ndryshme private, vazhdojnë të transmetojnë filmat e ish-Kinostudios “Shqipëria e Re”, edhe pse kanë kaluar rreth 30 vite nga rrëzimi i regjimit komunist. Paralelisht me këtë shtrirje kohore, procesi i rehabilitimit të ish-të përndjekurve nga diktatura, i nisur në vitin 1991, ka ecur me hapa të ngadaltë, shoqëruar shpesh me frymë konfliktuale.

E ndërsa ky proces ka qenë i çalë, mbytës në zvarritje, në televizione, filmat që e propaganduan regjimin e kaluar jo vetëm që vazhdojnë të transmetohen, por janë të rregulluar me ligj në të atillë mënyrë sa të gjenerojnë edhe të ardhura e aktivitet ekonomik.

Ky paradoks shoqërohet edhe me një tjetër. Ditët e sotme ndihet një hendek mes brezit që e jetoi komunizmin dhe brezit të ri që

po jeton dhjetëvjeçarin e tretë të demokracisë. Të rinjtë kryesisht po kultivojnë nostalgji, indiferencë dhe mungesë informacioni mbi të shkuarën.

Natyrisht ka shumë arsye përse kemi këtë gjendje, por transmetimi i filmave të periudhës së komunizmit nuk ndihmon për të ndryshuar situatën. Rëndom në rrjetet sociale sheh manifestime të deformimeve të të kuptuarit të komunizmit shqiptar. Shpesh mes të rinjsh hasen “*memë*” që citojnë shprehje të filmave si “Prefekti”, “I teti në bronz”, “Lulëkuqet mbi mure” etj. Personazhe si Qazim Mulleti apo Sali Protopapa, të cilët në thelb prej regjimit u deformuan enkas në mënyrë groteske për të goditur figurat reale dhe bashkë me to edhe familjet e tyre, perceptohen nga të rinjtë jo si personazhe fiktive, por si figura historike reale. Ironike apo jo?! Një poliglot i viteve 1930–1940 si Qazim Mulleti, i cili dinte 9 gjuhë të huaja, nga të rinjtë e sotëm njihet për aforizmën e krijuar nga skenaristi Besim Levonja në dialektin e Shqipërisë së Mesme: “Kur kat’naria zbrat m’qytet, atdheu osht m’rrezik!”

Rastet e ngjashme të deformimeve në kuptim, prej manipulimeve kinematografike të propagandës së regjimit komunist, janë të shumta, dhe kjo ka shtyrë institucionet që përkrahin rehabilitimin e ish-të përndjekurve që të rishikojnë transmetimin e kinematografisë që prodhoi komunizmi.

Ky studim përshkruan debatin më të fundit të hapur rreth çështjes së transmetimit të filmave që propagandojnë regjimin komunist, analizon dhe e shtjellon atë duke rendur t’i japë elemente shtesë, dhe në fund disa përfundime dhe rekomandime.

1. KOMERCIALIZIMI I NOSTALGJISË

Në vitin 2004, një spektakël muzikor i ideuar nga Pandi Laço solli në TV “Klan” një për zgjedhje këngësh ndër vite me titull “100 këngët e shekullit”. Me ndryshime (të vogla), kryesisht në interpretim (me këngëtarë të rinj), por në disa këngë edhe në tekst, për dhjetë të shtuna me radhë, publikut shqiptar iu përcoll melodi nga repertori i festivaleve të këngës në të kaluarën. Mes tyre nuk bënë dallim as këngët e periudhës komuniste. Ky spektakël do të rikthehej në skenë deri në vitin 2013, ndërkohë që këngët e riorkestruara ishin nxjerrë në treg në versionet CD apo DVD. Por pavarësisht suksesit në publik, spektakli i ideuar nga Pandi Laço nuk kaloi pa kritika.

Në një shkrim në gazetën “Korrieri”, Fatos Lubonja do ta cilësonte spektaklin e Laços, “komercializim banal të nostalgjisë” (2009). Ndërsa analizonte të gjitha detajet që sipas tij e bënë rikthimin e këngëve të komunizmit “një fenomen tejet shqetësues që meritonte më shumë vëmendje”, Lubonja theksonte se “përmbajtja e këngëve ka pak ose aspak të bëjë me ndjenjat e vërteta njerëzore të shqiptarëve të asaj kohe”. Ai thoshte se “as heqja e fjalëve parti apo Enver” nuk ua hiqte “atmosferën e rrejtshme festive apo optimizmin që (regjimi)² kërkonte të ngjallte tek njerëzit në kuadrin e propagandës trushpëlarëse...”².

“... kur pashë se spektakli u mbyll me këngëtarët tanë të vjetër e të rinj, që kënduan duke ia kaluar radhën njëri-tjetrit, këngën më të dashur të shokut Enver, “Për ty Atdhe”. U tha se është kënga e kënduar nga i madhi Mentor Xhemali. Nuk u tha se është kënga më e dashur e diktatorit, një hymn i ideologjisë nacional-komuniste të pushteti të Enver Hoxhës, i cili, gjoja në emër të atdheut që qëndronte si “shkëmb graniti vigan kundër çdo stuhie dhe tufani”, e izoloi dhe e masakroi atë...” – shkruante ai më tej, ndërsa kalonte dhe analizonte elementin e nostalgjisë.

2. Fatos Lubonja: “Biznesi banal me nostalgjinë e komunizmit”; Korrieri, 16 dhjetor 2009 <https://bit.ly/2teqtz2>

Sipas Lubonjës “një nostalgji për atë kohë pa vështrimin kritik ndaj saj, pa ndjenjën e empatisë për viktimat e asaj kohe, pa pendesën dhe pa ndjenjën e vënies së drejtësisë, mund ta kenë vetëm pjesa më e keqe e xhelatëve të asaj kohe, ata që kanë mbetur trushpëlarë dhe shpirttharë”.

E njëjta problematikë, për të cilën 10 vite më parë Lubonja shprehej me shqetësim, vazhdon të reflektohet në kinematografinë shqiptare. Nostalgjia që shtyn konsumin e filmave të komunizmit përkthehet në qarkullim parash, qarkullim i cili i bën të paineresuar institucionet, aktorët, regjisorët, apo edhe vetë transmetuesit, për të patur një qëndrim kritik kundrejt së shkuarës komuniste, përdorimit të artit për propagandë dhe manipulim historik. “Ata shprehen se është audienca që i kërkon. Për shembull (ne si “DigitAlb”) kemi pasur kërkesa me e-mail dhe mesazhe: ej, pse s’e jepni më atë filmin?! Kjo tregon që njerëzit i duan akoma (filmat e ish-Kinostudios)...”³

Në debatin publik mbi filmat e ish-Kinostudios në vitin 2017, ish-drejtori i Arkivit të Ministrisë së Brendshme, Kastriot Dervishi, njëherësh studiues i periudhës së komunizmit, përpiloi një listë me 82 filma që, sipas tij, “duhet të mos transmetoheshin më”, sepse “janë manipulues dhe propagandistikë”⁴. Në analizën e tij Dervishi shprehej se „në thelb të këtyre filmave është propaganda dhe përmbysja historike në funksion të paraqitjes së rendit socialist si shpëtues, të përparuar dhe njerëzor”. Ndërsa ai pranonte nga ana tjetër se një pjesë e prodhimit kinematografikë të diktaturës ka gjithsesi “vlera artistike”.

Në vendimin nr. 499, datë 26.12.1952 të Byrosë Politike: “Tematika e re që përfaqëson frymën e partisë, përshkon pothuajse të gjitha prodhime letraro-artistike. Heroi i saj është njeriu i ri, që punon e lufton për

3. Bisedë me drejtorin e programacionit në “DigitAlb”, Agim Poçarin, rreth debatit për mostransmetimin e filmave të ish-Kinostudios.

4. Kastriot Dervishi, “Propaganda në filmat e komunizmit: Ekonomati te filmi ‘Lulëkuqet mbi mure’, babai i Nexhmijes” postim në Facebook, i botuar në Panorama, 23 Mars 2017. <https://bit.ly/2rwJYlc>

të ardhmen”⁵. Sipas Dervishit, falë ish-Kinostudios “Shqipëria e Re”, regjimi komunist arriti të propagandojë *“frymën e partisë, kultin e individit, luftën e klasave, manipulimet historike sidomos nga koha e luftës, mitin e Sigurimit të Shtetit etj.”*

Në tërësi nuk ka të dhëna për shikueshmërinë e filmave të komunizmit. Agjencitë që mbrojnë të drejtat e autorit i shmangen transparencës në këtë drejtim, edhe pse pranojnë që merren edhe me monitorimin e transmetimeve të veprave të tyre.

Prodhimtaria e ish-Kinostudios gjendet lehtësisht e piratuar edhe në internet. Shikueshmëria aty është e matshme dhe prej saj mund të krijohet një perceptim. Nga një monitorim i platformës së përmbajtjes së vetëgjeneruar nga “YouTube” (*Tabela 6, në fund*)⁶ u vu re se vetëm filmat e listuar nga Dervishi si produksione që nuk duhen transmetuar në kanalet publike (gjithsej 82 filma), kishin së bashku 6.5 milionë (6,580,470) shikime. Kështu, në njëfarë mënyre, vërtetohet justifikimi i operatorëve të transmetimit se audiencia mbetet në kërkim të kësaj prodhimtarie.

Por *“filmat e vjetër ambalazhohen dhe i prezantohen publikut në një mënyrë të tillë që thjesht të shiten sa më mirë dhe nuk përdoren për të kuptuar një periudhë të gjatë të historisë së këtij vendi, siç ka qenë periudha e komunizmit”*⁷. Në këtë pikë, sipas Lubonjës, qëndron *“një pafuqi intelektuale për t’i analizuar gjërat”*⁸, ndërsa shoqërisë shqiptare, në tërësi, i ka munguar reflektimi mbi të shkuarën.

5. Kastriot Dervishi, po aty.

6. Monitorimi në “YouTube” i 82 filmave të patransmetueshëm sipas Kastriot Dervishit, datë 8 korrik 2018 <https://bit.ly/2MWKgf1>

7. Artan Puto dhe Eldon Gjika: “Kinematografia shqiptare midis nostalgjisë, groteskut dhe të ardhmes. Një histori e treguar nga kineastët”, 2008, Revista “Përpjekja”. Nr. 25, fq. 27.

8. Fatos Lubonja: “Biznesi banal me nostalgjinë e komunizmit”; Korrieri, 16 dhjetor 2009 <https://bit.ly/2teqtz2>

Rreth 10 vite më vonë, çështja e mënyrës së transmetimit të materialeve artistike që propaganduan komunizmin do të rikthehej në një diskutim shumë më përfshirës se ai që Lubonja nisi në vitet 2008–2009, por që sërish nuk pati rezultat konkret.

1.1 Debati për mostransmetimin

Më 10 janar 2017, Instituti i Integritimit të ish-të Përndjekurve Politikë (IIPP) i drejtoi një shkresë zyrtare Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku i kërkoi ndalimin e transmetimeve të filmave të ish-Kinostudios “Shqipëria e Re”. Në kërkesën me numër protokolli 12, drejtuar kryetarit të AMA-s, drejtori i IIPP-së, Bilal Kola, përcillte shqetësimin për shfaqjen në televizione të ndryshme (TVSH; TV “Report”; “T” në “DigitAlb”; “Tring Shqip”) të filmave të prodhuar gjatë regjimit komunist. Duke përmendur këtu nenin 3 të parimeve themelore të Kushtetutës së Shqipërisë, Kola kërkoi qartësisht ndalimin e transmetimeve, me argumentin se ato *“diskriminojnë dhe cenojnë dinjitetin e ish-të përndjekurve nga regjimi komunist”*.

Shkresa në fjalë u bë publike nga mediet disa muaj më pas, në mars 2017, kur debati në opinionin publik ishte nxehur nga deklarata të ndryshme. Ndërkohë, drejtori ekzekutiv i Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK), Agron Tufa, kishte nxitur edhe më tej debat duke dalë hapur kundër mënyrës se si transmetoheshin këta filma, sidomos dokumentarët. Ai madje kishte edhe propozime konkrete, të cilat më pas do ia përcillte edhe Kuvendit të Shqipërisë.

Nga ana tjetër, me të marrë kërkesën nga IPP-ja, AMA sugjeroi një takim zyrtar mes përfaqësuesve të të dyja institucioneve. Sipas zyrës

për shtyp të AMA-s⁹, takimi kishte qenë “i dobishëm, me shkëmbim të lirshëm të mendimeve dhe propozimeve”, duke u dakordësuar se kjo çështje kërkon dy aspekte thelbësore në trajtimin e saj: “së pari, të bëhej një vlerësim i krijimtarisë filmike dhe dokumentare të periudhës para viteve '90, dhe së dyti, një vendimmarrje për mënyrën e transmetimit publik”. AMA, në fakt, e shfrytëzoi këtë takim për të sqaruar menjëherë pozicionin e saj. Ajo bëri me dije se vlerësimi dhe vendimmarrja në këtë çështje “janë dy procese që e tejkalojnë kompetencën ligjore dhe rregullative të saj”.

Në fund të muajit shkurt, Tufa i drejtoi AMA-s, përmes një letre të hapur, ide më konkrete krahasuar me kërkesën që Kola i kishte bërë Autoritetit në janar. Drejtori ekzekutiv i ISKK-së ishte më i moderuar. Ai e cilësonte idenë e tij “ndërhyrje në kinematografinë komuniste” dhe nuk kërkonte kurrësi ndalesë të plotë për të tërë prodhimtarinë e ish-Kinostudios. Tufa propozoi “kalimin në një filtër të të gjithë trashëgimisë së kinematografisë komuniste”, duke i ndarë prodhimet në shkallë të ndryshme të propagandës që ato ushtrojnë. Drejtori i ISKK-së sugjeroi një shënim, “që shpjegon kontekstin ideologjik e politik të kohës kur janë krijuar” ose të një logoje “PPSH” apo “Kujdes!” të vendosur anës materialit filmik gjatë transmetimit.

Debati u mbështet hapur nga drejtoresha e Institutit për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC), Jonila Godole, e cila tërhoqi vëmendjen drejt qasjes që po i bëhej debatit. Sipas saj, histeria dhe agresiviteti, të cilat kryesisht shoqëria po i shfaqte si reagime në rrjetet sociale, tregonin “pikërisht mosnjohjen e thellë të atij regjimi, krimet, persekutimet dhe aq më shumë strukturën e propagandës që kishte diktatura”¹⁰.

9. Përgjigje me e-mail e datës 8 mars 2018 për kërkesën për informim dërguar Autoritetit të Mediave Audiovizive, datë 27 shkurt 2018.

10. Jonila Godole, “Debati për kujtesën, përtej Kinostudios”; Gazeta Panorama, 27 mars 2017.

Ndërkohë edhe pse vazhdimisht nëpër media publikoheshin editoriale dhe komente të ndryshme, në disa raste ato amplifikuan keqkuptimet dhe keqinterpretimet duke nxitur reagime të zellshme nga audienca, por sidomos nga regjisorët apo aktorët.

Piro Milkani, Mevlan Shanaj, Reshat Arbana, Luftar Paja, Saimir Kumbaro, Elvira Diamanti, Agim Bajko, ishin disa nga artistët që reaguan. Duke përmendur “pultin”, regjisori Piro Milkani, në një intervistë për “Gazetën Shqiptare” do të shprehej: “Ata (që janë kundër) e kanë shumë të thjeshtë, mund ta ndryshojnë kanalën”¹¹. Sipas Milkanit, filmat e ish-Kinostudios janë “pasuri kombëtare” që “nuk çojnë ujë në mullirin e nostalgjisë së komunizmit”. Mevlan Shanaj do i cilësonte idetë për shpjegime kontekstuale përpara filmave, “idiotësi”. Sipas tij, “shpjegimi fyen inteligjencën e shikuesit” dhe “ato vepra që kanë probleme janë skualifikuar tashmë nga koha”. Aktori Reshat Arbana, do të ishte edhe më emotiv. Në reagimin e tij, ironikisht pyeste se “çfarë duhet të shohim tani në televizor, se si bëhet seks?”¹² Aktori Luftar Paja, pozicionohej gjithashtu kundër ideve të propozuara, duke mbrojtur “vlerat artistike” të prodhimit të asaj kohe. Regjisori Saimir Kumbaro, i cili edhe pse e pranonte idenë e seleksionimit dhe faktin se në atë periudhë “ka prodhime 100% propagandistike”, do të ndikohej nga rrjedha agresive e debatit dhe do të thoshte: “Censurimi i filmave është një budallallëk, kthehet revolucioni kinez”. Aktorja Elvira Diamanti, gjithashtu e ndikuar nga rrjedha agresive dhe keqinterpretuese që pati marrë debate, do ta cilësonte idenë “të padrejtë për krijuesit, artistët që nën diktaturë na kanë dhënë edhe kënaqësi estetike dhe shpirtërore”.

11. Intervistë e Fatmira Nikollit me Piro Milkani, “Ndalimi i filmave të komunizmit: Çdokush e ka pultin në dorë”; “Gazeta Shqiptare”, 14 mars 2017.

12. Artikull, “Ndalimi i filmave? Reshat Arbana: Ç’të shohim, si bëhet seks tresh?!”; Panorama, 23 mars 2017.

Në fund të muajit mars, drejtori i ISKK-së, Tufa, iu drejtua me një letër Kuvendit, ku i kërkoi mbështetje për nismën për filtrimin e filmave të kohës së komunizmit. *“Nisur nga ky shqetësim, në kushtet kur në mbi 70 kanale televizive, qendrore dhe lokale, ekranet transmetojnë papushim filma e dokumentarë që provokojnë e tallen me plagët e pjesës më të martirizuar të shoqërisë sonë nga regjimi komunist, që cenojnë rëndë dinjitetin dhe integritetin moral të tyre, ne i bëjmë apel institucional Kuvendit të Shqipërisë, si institucioni më i lartë ligjor e ligjvënës, të ndërhyjë me instrumentet e tij ligjorë në mbrojtje të kësaj shtrese të gjakosur dje dhe të provokuar e të nëpërkëmbur sot”* – shkruante në letrën e tij, Tufa, por që nuk gjeti reagimin e kërkuar nga pushteti legjislativ.

“Ne nuk jemi për ndalimin, censurimin apo zhdukjen e filmave të kohës së komunizmit. Ata mund të shërbejnë për studime. Ata mund të shfaqen në një orë të caktuar me një paralajmërim, p.sh.: “Kujdes, ky film përmban aspekte propagandistike të kohës së komunizmit”; mund të shoqërohen me një logo, p.sh.: “PPSH”, gjatë gjithë kohës së transmetimit, ndërsa për filmat që kanë një shkallë të lartë propagande denigruese e përçarëse, ata duhet të ndalohen nga ekranet, njëlloj siç ndalohen transmetimet e filmave propagandistike të diktaturave naziste e komuniste në gjithë Europën”
– propozonte në letrën e tij drejtori i ISKK-së.

Si përfundim, ky debat mbi ndalimin apo jo të transmetimit të filmave propagandistike të regjimit komunist u venit pa e zgjidhur problemin.

Sipas përgjigjes së kërkesës për informim të AMA-s, *“vendimmarrja për këtë çështje i takon Kuvendit të Shqipërisë”* dhe për sa kohë nuk ka një ligj apo vendimmarrje që e ndalon (apo filtron) transmetimin e filmave të ish-Kinostudios, AMA nuk mund të ndërhyjë, pasi *“ajo kujdeset vetëm për të monitoruar dhe ndjekur me rigorozitet performancën e subjekteve audiovizive, se sa ato i respektojnë vendimet e Kuvendit të Shqipërisë”*.

Disa pyetje mbeten ende aktuale pas këtij debati: Si bëhet vlerësimi profesional i krijimtarisë së ish-Kinostudios; Cilët filma duhen dhe cilët nuk duhen transmetuar; Cili autoritet do ta bëjë vlerësimin, Kuvendi, organizatat e ish-të përndjekurve, ISKK-ja, apo institucionet e kulturës, dhe mbi bazë të cilave kritere?

2. ADMINISTRIMI DHE TRANSMETIMI I FILMAVE TË ISH-KINOSTUDIOS

2.1. Historiku i administrimit të prodhimit të filmike

Deri në vitin 1991, para se të merrte emrin “Albafilm Studio”, Kinostudio “Shqipëria e Re” realizoi në total 227 filma artistikë, 1.145 dokumentarë, 1.006 kronika dhe 122 filma vizatimorë. Gjatë punës së saj 39-vjeçare – që prej themelimit më 10 korrik 1952 – Kinostudioja pati një aktivitet mesatar prej 74 prodhimesh në vit, ku 7 prej tyre do të ishin medoemos filma¹³.

Periodha më aktive ishte ajo e viteve '80, ku “norma e filmave” që vendoste regjimi komunist pothuajse u dyfishua. Roli kryesor pas prodhimit dhe aktivitetit të Kinostudios do të ishte ai propagandues. Ky funksion do të justifikonte edhe kostot e mëdha që duheshin asokohe për të prodhuar filma, kosto që do të mbuloreshin tërësisht nga shteti. Të dhëna arkivore tregojnë se që në fillimet e veprimtarisë së saj, Kinostudios iu kërkua që të bëhej pjesë e mekanizmit të “Partisë-Shtet” dhe filmat nisën të dubloreshin edhe në gjuhë të huaj, kjo sipas kërkesave të vazhdueshme të “Ndërmarrjes Shtetërore të Turizmit” (1961) që “të organizoheshin shfaqje filmike për turistët e huaj të cilët vijnë në Shqipëri”¹⁴. Dokumentarë si “Vallëzimi i shqipeve” (1960, me regji të Endri Kekos, skenar të Kin Dushit, muzika e Çesk Zadesë), “Lulëzo Shqipërinë” (1959, me regji të Ilia Kopalinit dhe Endri Kekos, skenar të Llazar Siliqit dhe Ilia Kopalinit) apo filma si “Skënderbeu” (1953, me regji të Sergei Ytkeviçit dhe skenar të Mikhail Papavas) ishin më tipikët.

13. Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, përgjigje kërkesë për informim, datë 27/02/2018.

14. Arkivi Qendror Shtetëror; Dosja 71, viti 1961, “N.Sh Turizmit, Dega e Propagandës dhe Kulturës, relacion drejtuar Komitetit Qendror mbi punën e Albaturizmit”.

Roli propagandistik i Kinostudios mori vlerësime të shpeshta nga regjimi. Dokumente arkivore tregojnë se në vitin 1989, me rastin e 45-vjetorit të Çlirimit, pushteti komunist diskutonte “të nderonte” edhe më tepër “bashkëpunëtorët” e tij, dhe mes organeve qendrore, krahas propozimeve të ndryshme, ishte edhe propozimi për të dekoruar “objektet socialkulturore” si Pallati i Kulturës, Muzeu Kombëtar etj. U diskutua gjithashtu që edhe Kinostudioja të nderohej me “Urdhërin e Flamurit” “për rolin e shquar që ka dhënë në zhvillimin e artit kinematografik në gjinitë e filmit artistik, dokumentar dhe vizatimor. Si art militant dhe i dashur për masat, si armë e fuqishme për edukimin komunist të tyre, nëpërmjet përmbajtjes socialiste, karakterit kombëtar e popullor, ka transmetuar tek shikuesit mesazhe historike nëpër të cilat kalojnë njerëzit dhe vendi ynë, ka pasqyruar gjallërisht epokën e ndritur të Partisë”.

Më tej teksa përmendeshin dekoratat që Kinostudioja mbante: “Urdhër Pune” Klasi i parë (1962); “Urdhëri Flamur i Kuq i Punës” (1976); “Urdhëri i Flamurit” (1987)” – përfundohej se Kinostudioja “nuk mund të vlerësohej më shumë”¹⁵. Dhe Kinostudioja nuk u dekorua më tej.

Pas rrëzimit të sistemit, ajo ndryshoi rrënjësisht. U çlirua nga përfshirja direkte në propagandën ideologjike-shtetërore, por nuk u mbështet më aq financiarisht për prodhimtarinë e saj. Kinostudioja u nda në “Albafilm Studio”, e cila trashëgoi inventarin teknik, “Albafilm Animacion”, që do të merrej me filmat vizatimorë, “Albafilm Distribucion”, që do të merrej me distribucionin e filmave, dhe në “Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit” (AQSHF), që do të kishte si synim arkivimin e prodhimtarisë filmike.

15. Arkivi Qendror Shtetëror; 489, Presidiumi i Kuvendit Popullor, viti 1989; 6, Drejtorja e Dekorimeve; Dosja 213, Ceremonia e dekorimit për dhënien e titullit “Hero i Punës Socialiste” e dekoratave të tjera të larta disa kuadrove të Luftës Nacionalçlirimtare e të ndërtimit socialist me rastin e 45-vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

Nga viti 1991 deri në fillim të vitit 1997, prodhimin kinematografik e vazhdoi “Albafilm Studio”, deri në kohën kur u krijua dhe filloi funksionimin “Qendra Kombëtare e Kinematografisë” (QKK)¹⁶. Ligji që u miratua asokohe mundësoi jo vetëm këtë ndryshim, por edhe krijimin e shtëpive kinematografike private, të cilat për projektet e tyre filmike do të mbështeteshin financiarisht nga QKK-ja dhe nga kompani filmike të huaja, me të cilat shtëpitë kinematografike private do të mund të krijonin bashkëpunime për bashkëprodhime. Gjithashtu, ligji i hapte rrugë edhe krijimit të shoqatave të producentëve.

Por këta hapa pozitivë për sa i përket legjislacionit nuk u shoqëruan me të tjerë hapa në luftën ndaj piraterisë dhe vjedhjes së prodhimeve kinematografike, pasi në periudhën kur u konceptua ligji nuk ishte zhvilluar ende tregu mediatik. Zhvillimi i medias private pas vitit 1997 do të sillte krijimin e televizioneve si TV “Shijak”, “Telenorba”, TV “Klan” apo TV “Arbëria” (TVA). Kjo periudhë, duke përfutur edhe nga hendeku ligjor, nxiti njëherësh përpos konkurrencës, edhe piraterinë. Kostoja zero për të piratuar prodhimtari të huaja kinematografike i dha një shuplakë të rëndë prodhimit vendas. Ndërkohë po në këto rrethana, krahas prodhimeve të huaja, për herë të parë u shënuan raste të transmetimeve pirate edhe të materialeve filmike të periudhës së komunizmit. TVA-ja ishte një nga televizionet që transmetuan të parat fragmente apo dhe filma të ish-Kinostudios. Kryesisht ata merreshin dorazi përmes “Albafilmit”, AQSHF-së, ose Radiotelevizionit publik Shqiptar (RTSH). Sidoqoftë në këto vite vazhdoi përmirësimi ligjor për sa i përket formësimit të QKK-së si një institucion më i përgjegjshëm të filmit.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë u krijua me Ligjin nr. 8096, datë 21.3.1996, “Për kinematografinë”.

16. Qendra Kombëtare e Kinematografisë u krijua me Ligjin nr. 8096, datë 21.3.1996, “Për kinematografinë”.

Kështu u përcaktuan edhe të ardhurat “*jobuxhetore*” që do të siguronte Qendra¹⁷. QKK-ja, krahas fondit buxhetor, do të siguronte edhe “*50 për qind të të ardhurave*” që realizoheshin nga shitja dhe qarkullimi i veprave filmike të prodhuara deri më 1 qershor 1997 me fonde buxhetore ose pjesërisht buxhetore. Pjesa tjetër i mbetej “Albafilm Studios”. Pra, në njëfarë mënyre, që në vitin 1998 qe parashikuar shpërndarja e produkteve filmike dhe ndarja e të ardhurave që do të mund të përfitoheshin prej tyre. Kjo gjë gjente vështirësi në zbatim, për faktin se asokohe pirateria ishte trend i televizioneve dhe shteti e kishte të vështirë – *ose nuk kishte vullnet* – ta luftonte.

Ndryshimet ligjore vazhduan edhe në fillimvitet 2000. Në këtë periudhë Shqipëria bëri hapa konkrete duke aderuar në disa konventa ndërkombëtare¹⁸, si Konventa e Bernës. Kjo nënkuptonte edhe harmonizimin e legjislacionit sipas ligjeve që diktonin ato. Prandaj, duke marrë shkas nga kjo frymë, artistët nisën të organizoheshin më mirë duke formuar forume apo organe për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Një prej tyre do të ishte “Forumi i Mbrojtjes së Autorëve të Audiovizualit” (FMAA) themeluar si organizatë jofitimprurëse në vitin 2003 nga një grup regjisorësh dhe skenaristësh.

Në kuadër të nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA), u përforcua legjislacioni mbi të drejtat e autorit, pronës intelektuale dhe ekonomike. Neni 73 parashikonte se “*Shqipëria duhej*

17. Të ardhurat e QKK-së u mirëpërcaktuan me vendimin nr. 796, datë 24.12.1998, të Këshillit të Ministrave.

18. Shqipëria aderoi në Konventën ndërkombëtare “Për mbrojtjen e artistëve interpretues dhe ekzekutues, të prodhuesve të fonogrameve dhe të organizmave të radiodifuzionit” me dekretin nr. 2565, datë 28 shkurt 2000, të Presidentit Rexhep Meidani. Një vit më vonë, me dekretin nr. 3173, datë 10 dhjetor 2001, të Presidentit Rexhep Meidani, Shqipëria aderoi në traktatin e “Organizatës Botërore të Pronësive Intelektuale” (OBPI) për “të drejtat e autorit”. Anëtarësimi do të konkretizohej në vitin 2003 me dekretin nr. 3684 të Presidentit Alfred Moisiu.

të harmonizonte ligjet me ato të vendeve anëtare ose së paku sikurse parashikojnë konventat e Bernës (1991) apo Romës (1961)".

Nën këtë dinamikë, ligji i kinematografisë ndryshoi sërish në vitin 2005, 9 vjet pasi që miratuar ligji i mëparshëm. Ndryshimet i dhanë mundësinë QKK-së që t'i "marrë" "Albafilm Studios" administrimin e prodhimit kinematografik të ish-Kinostudios "Shqipëria e re" deri në vitin 1990¹⁹. Nga ana tjetër, "Albafilm Studio" u kthye në shoqërinë "Albafilm", e cila më pas do të ishte vetëm administruese e logjistikës së ish-Kinostudios dhe vlerave të saj historike: veshjeve, skenografive, automjeteve, pajisjeve dhe objekteve të tjera të shumëllojshme, të cilat i patën shërbyer prodhimitarisë kinematografike. Sipas ligjit, nenit 27²⁰, shoqërisë i lejohej përfshirja në marrëdhënie kontraktuale me producentë filmash, televizione apo persona fizikë ose juridikë. AQSHF-ja u ngarkua të merrej me administrimin fizik të kësaj prodhimitarie të ish-Kinostudios.

Krahas ndryshimeve në ligjin e kinematografisë sipas direktivave të BE-së, u ndërморën hapa pozitivë edhe në fushën e "*të drejtave të autorit*"²¹. Përmes i këtij ligji përcaktohej qartë e drejta mbi një vepër kinematografike dhe po kështu iu dha mundësia organizatave jofitimprurëse që *pas licensimit nga ana e Ministrisë së Kulturës – të funksiononin si "agjenci të administrimit kolektiv"*.

Një vit pas miratimit të ligjit të parë "*Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të*", u formua Zyra Shqiptare e të Drejtës së Autorit (ZSHDA)²². Kjo zyrë do të kishte si objektivat të veprimtarisë mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të

19. Neni 23 i Ligjit nr. 9353, datë 3.3.2005 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8096 datë 21.3.1996 Për kinematografinë".

20. Po aty, Neni 27 i Ligjit nr. 9353, datë 3.3.2005.

21. Ligji nr. 9380, datë 28.4.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të" (LDA).

22. VKM nr. 232, dt. 19.4.2006 "Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit".

drejtave të autorëve dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, nga subjektet, personat fizikë/juridikë, privatë ose publikë, të cilët janë përdorues të pronësisë letrare, artistike apo dhe shkencore. ZSHDA-ja funksionon konform ligjit për të drejtat e autorit dhe në varësi të Ministrisë së Kulturës.

Këto ndryshime i dhanë rrugë idesë për një administrim “*më të rregullt*” të transmetimit të filmave të ish-Kinostudios. Në këtë mënyrë luftohej më direkt pirateria. Që prej asaj kohe (pas vitit 2006) u krijuan shumë agjenci të administrimit kolektiv, katër prej të cilave vazhdojnë të jenë aktive edhe sot ²³ :

- “Albautor”²⁴, organizata për mbrojtjen të drejtave të autorëve, kompozitorëve dhe botuesve të veprave artistike, letrare, muzikore e audiovizuale me president Elton Dedën, drejtor ekzekutiv Erlir Puton (albautor.net)
- FMAA²⁵, Forumi i Mbrojtjes për Autorë të Audiovizualit me drejtor ekzekutiv Esat Musliun (fmaa-alb.com)
- AKDIE²⁶, Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Artistëve Interpretues/Ekzekutues me drejtor ekzekutiv Naim Aliajn (akdie.org)

23. Aktualisht (viti 2018), të katërta agjencitë janë në fazën e rilicensimit, duke qenë se periudha trevjeçare e licensës së fundit ka përfunduar.

24. ALBAUTOR, Agjenci e Administrimit Kolektiv për Muzikën dhe të gjitha të drejtat e regjistrimeve mekanike të pronësisë artistike. Licensë Nr. 1, datë 5.7.2007, Urdhër Nr. 448, datë 5.7.2007, FZ nr. 89, korrik 2007.

25. FMAA, Agjenci e Administrimit Kolektiv për të Drejtën e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera të audiovizualit. Licensë Nr. 2 datë 1.4.2008, Urdhër Nr. 301, datë 1.4.2008, FZ nr. 50, dt 11.4.2008.

26. AKDIE, Agjencia e administrimit kolektiv për të drejtën e artistëve interpretues dhe/ ose ekzekutues të veprave me të gjitha format e përcjelljes së interpretimit/ ekzekutimit të tyre në publik. Licensë Nr. 3, Dt. 9.7.2008, Urdhër Nr. 669, datë 22.5.2008, FZ 119, dt. 30.7.2008.

- AMP²⁷, Agjencia për Mbrojtjen e Producentëve me president Zamir Sukniqin (amp.org.al)

Në këtë periudhë, kineastët rihapën diskutimet në opinionin publik rreth pretendimeve të tyre për të drejtat mbi filmat e ish-Kinostudios, si të drejta “*jo vetëm morale apo intelektuale, por edhe ekonomike*”. Rreth dy vite më vonë (2007), u propozua që fondi i filmave t’i kalonte për “*vetadministrim*” autorëve. Në këtë pikë kishte qëndrime të ndryshme. Xhevdet Ferri, si kryetar i QKK-së, atë kohë do të shprehej skeptik ndaj përmbushjes së pretendimeve të ngritura, megjithëse ishte një përkrahës i tyre.

*“Është një handicap, sepse autorët nuk kanë pasur kontratë me shtetin kur i kanë bërë këta filma... Ka një pretendim të kineastëve, por kjo do vullnet politik. Unë vetë anoj nga ana e kineastëve, edhe pse më duket një ide shumë e vështirë për t’u realizuar, pasi në fund të fundit ai është edhe një pronë publike, dhe ekonomike, nuk është vetëm intelektuale. Është bërë me paratë e shtetit, kështu që ekonomikisht nuk e di nëse mund të realizohet. Nëse ka vullnet politik në Parlament, le ta kalojnë. Le ta gëzojnë, përse jo?!”*²⁸

Ferri do të bënte thirrje që së pari kineastëve t’u njihej e drejta intelektuale dhe të shpërbleheshin së paku për këtë pjesë. Ndërkohë në QKK (2008) u diskutua ideja e strukturimit në një “*paketë*” me prodhimet e ish-Kinostudios, e cila do t’i ofrohej më pas mediave të ndryshme, të cilat po tregoheshin tejet të interesuara për këto prodhime. Për këtë u dakordësua një bashkëpunim me AQSHF-në. Përballë kërkesave të televizioneve për të transmetuar

27. AMP, Agjencia e administrimit kolektiv të të drejtave të producentëve. Licensuar me urdhër Nr. 18, datë 23.1.2012 të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve, FZ nr. 5, dt. 16.2.2012.

28. Intervistë e gazetares Alma Mile me Xhevdet Ferrin, kryetar i QKK-së. “Ferri: Filmat e para ‘90-ës, pronë publike” Gazeta Panorama 4.11.2007.

filmat, u diskutuan ide për mënyrat e transmetimit. Fillimisht u mendua paraprirja e tyre me material shpjegues. Materiali u mendua të ishte kryesisht i aspektit artistik, që të tregonte rreth situatës kur qe prodhuar filmi (Rozeta Ferri)²⁹. Pas diskutimeve të shumta për mënyrën e transmetimit, punonjësit e Arkivit në bashkëpunim me QKK-në përpiluan edhe një listë me titujt që do i përcilleshin stacioneve televizive. Sipas drejtoreshës së programacionit në RTSH, Rozeta Ferrit, në nisje të këtij procesi, artistët nuk patën asnjë ide apo qëllim të paracaktuar se çfarë do të provokonin apo çfarë ndikimi do të kishin këta filma po të ritransmetoheshin.

Platforma “DigitAlb”, që ishte krijuar katër vjet përpara këtyre zhvillimeve (2004), nënshkroi e para një kontratë për të transmetuar materiale të ish-Kinostudios (2008). Më vonë do të nënshkruanin televizionet e tjera dhe platforma konkurruese “Tring-Digital” (krijuar më 2008-n).

Prej këtyre zhvillimeve, agjencitë e administrimit kolektiv të të drejtave filluan të kërkonin respektimin e kontratave që lidheshin mes QKK-së dhe operatorëve transmetues. Artistët kërkonin lëvrimin e shpërblimeve që parashikonin këto kontrata. Ishte e vështirë të gjendej një “*feedback*” pozitiv. Shpesh pati procese gjyqësore për mosrespektim detyrimesh kontraktuale, por me kalimin e kohës, për artistët, gjërat u përmirësuan. Agjencitë e panë me optimizëm rrugën drejt strukturimit të tregut mediatik në një treg më formal.

Sipas procedurave (të miratuara) të administrimit të transmetimit, 30% e vlerës kontraktuale derdhet në arkën e shtetit, 70% ndahet më pas midis 3 agjencive, ku dominon FMAA-ja (57%) që mbron të drejtat e regjisorit, skenaristit dhe drejtorit të fotografisë. Kompozitorin e mbron “Albautori” dhe më tej një agjenci tjetër

29. Bisedë me drejtoreshën e programacionit në RTSH, Rozeta Ferrin, për filmat e ish-Kinostudios dhe debatin e nxitur në vitin 2017.

më e vogël, AKDIE-ja, mban një përqindje të vogël rreth 3% për interpretuesit³⁰. Agjencia për Mbrojtjen e Producentëve nuk përfshihet në këtë llogari, pasi ka qenë shteti në rolin e producentit në filmat e ish-Kinostudios.

Por skema kishte vend për kritika. Agjencitë kolektive për mbrojtjen e të drejtave të autorit rrallë bënin transparencën e operatorëve të transmetimit, por edhe të AMA-s. Në raportin e vitit 2017, AMA do të theksonte se *“agjencitë nuk informonin si duhej për veprat që mbrohen nga to”*. Televizionet ankoreshin për caktimin dhe mënyrën e mbledhjes së tarifave në formën e *“aforfeve që në fillim të vitit”*, apo edhe gjobave. Gjithashtu, pikëpyetje ngriheshin për shpërndarjen e të ardhurave.

Në raportin e vitit 2017, AMA tregon se në një takim në Bruksel ku qe folur për problemet e tregut të brendshëm dhe konkurrencës *“shtetit shqiptar iu theksua se nga agjencitë nuk ishte shpërndarë asnjë honorar për autorët, pavarësisht se subjektet kishin paguar rregullisht tarifat e vendosura njëanshmërisht dhe pa asnjë kriter nga agjencitë”*³¹. Nga ana tjetër, ZSHDA-ja gjobiste shpesh operatorët duke shkaktuar një *“klime të trazuar dhe aspak bashkëpunuese”*.

Kjo problematikë nxiti ndryshime. Prej ligjit të ri *“Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”* (2016), Ministria e Kulturës krijoi *“Drejtorinë e së Drejtës së Autorit”* (DDA), duke reformuar kështu ZSHDA-në. Ndryshimet nuk u ndalën këtu. Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit pranë Ministrisë së Kulturës, një vit më vonë (2017) i dha jetë një agjencie të re të quajtur *“Sporteli Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit”* (SUADA)³².

30. Bisedë me Esat Musliun për filmat e ish-Kinostudios dhe debatin e nxitur në vitin 2017.

31. AMA, Raport vjetor 2017; fq. 41 <https://bit.ly/2DYNnAr>

32. Vendim Nr. 4, dt. 10.10.2017, Ministria e Kulturës; Këshilli Kombëtar për të Drejtat e Autorit.

Kjo agjenci u ngarkua me të gjitha kompetencat e kontaktimit, informimit dhe mbledhjen e të ardhurave nga subjektet përdorues të veprave që mbrohen nga ligji për të drejtat e autorit. SUADA tashmë përfaqëson të gjitha agjencitë e licensuara nga Ministria e Kulturës. Përdoruesit e veprave artistike, muzikore apo kinematografike i drejtohen asaj për t'u pajisur me leje/autorizim për përdorimin. Agjencitë e mbrojtjes së autorit i drejtohen gjithashtu SUADA-s për të lëvruar shpërblimet. Sipas idesë së këtyre ndryshimeve arrihet një lloj centralizimi i kontakteve dhe i marrëdhënieve ekonomike mes operatorëve dhe artistëve, duke mënjanuar kështu problemet me transparencën apo me qarkullimin e të ardhurave të krijuara nga tarifat.

2.2 Transmetimi i materialeve propagandistike në televizionin publik

Procesi i kalimit nga transmetimi analog në atë digjital (digjitalizimi) që nisi në vitin 2013, i dha mundësinë Radiotelevizionit Shqiptar (RTSH) që të zhvillonte kapacitetet. Tashmë kur kanë kaluar më shumë se 5 vite, RTSH nuk i drejtohet më publikut me 1 kanal televiziv kombëtar, por me një paketë programesh prej 10 kanalesh: 3 kanale gjeneraliste (RTSH 1, RTSH 2 dhe RTSH 3) dhe 7 kanale tematike (RTSH Sport, RTSH Film, RTSH Muzikë, RTSH Shqip, RTSH Fëmijë, RTSH 24 dhe RTSH Kuvend). Gjithashtu pjesë e paketës janë edhe RTSH Korça dhe RTSH Gjirokastra.

Nga paketa e programeve, RTSH 1 dhe RTSH Shqip janë kanalet që transmetojnë prodhimtari filmike shqiptare. RTSH 1, përveçse kanal gjeneralist ku transmetohen emisione dhe dokumentarë, përcjell edhe filma, dokumentarë, apo reportazhe të cilat zakonisht transmetohen në RTSH Shqip. Në vitin 2017, RTSH 1 transmetonte mesatarisht “5–7 filma shqiptarë (para dhe pas viteve

'90) në javë”³³. Të njëjtën praktikë të transmetimit të të njëjtave materiale filmike të RTSH Shqip përdorin edhe kanalet RTSH Korça dhe RTSH Gjirokastra, por për këto të fundit në raport nuk ka të dhëna se sa filma shqiptarë transmetojnë në javë.

Kanali RTSH Shqip, pas 2 javëve “kanal eksperimental”, nisi transmetimet më 14 dhjetor 2016. RTSH Shqip është tematik dhe “transmeton 24/7 vetëm prodhime kinematografike dhe televizive shqiptare”³⁴. Sipas përshkrimit të ndërtimit të strukturës së RTSH Shqip në raportin vjetor të vitit 2017,

“qëllimi i kanalit ka qenë jo vetëm të prezantojë prodhimet artistike shqiptare të shtrira në zhanre të ndryshme të filmit, telekomedisë, doku-filmave, dokumentarëve, reportazheve, serialeve, teatrove dhe emisioneve të ndërtuara mbi historinë apo ikonat e kinematografisë shqiptare, por gjithashtu të pasqyrojë edhe krijimet më të fundit”.

Por, prodhimtaria kinematografike e RTSH Shqip është kryesisht e ish-Kinostudios, pasi RTSH-ja ka pasur probleme me fondin arkivor. Sipas raportit të ecursionit për vitin 2017, përcjellë Kuvendit të Shqipërisë, RTSH Shqip transmetoi mesatarisht çdo javë 80 filma (10–12 filma artistikë shqiptarë në ditë), 40 dokumentarë shqiptarë (4–6 dokumentarë dhe reportazhe në ditë), 12 telekomedi shqiptarë (1–2 telekomedi në ditë), 7 teatro shqiptarë (1 në ditë). Në raport nuk saktësohet sa për qind e këtij programacioni vinte prej prodhimtarisë së RTSH-së dhe sa prej fondeve të tjera. Vlen të thuhet se një pjesë e prodhimtarisë së RTSH-së nuk është e transmetueshme për shkaqe teknike dhe të keqmenaxhimit të arkivës.

33. RTSH; “Raport vjetor mbi ecursionin e RTSH” (2017), fq. 78 <https://bit.ly/2t7m-MuW>

34. RTSH; “Raport vjetor mbi ecursionin e RTSH” (2017), fq. 89 <https://bit.ly/2t7m-MuW>

Auditimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) konkludoi në vitin 2014 se “në arkivën e RTSH-së janë shkaktuar dëme të mëdha, si nga përdorimi i saj pa kriter nga dy përdoruesit e tij kryesorë (TVSH & RT), ashtu edhe nga keqmbajtja thuajse abuzive e fondit”³⁵. Duke analizuar situatën, KLSH-ja tha në raportin e vet se “ndërhyrjet në materialin master kanë shkaktuar dëme të pariparueshme dhe deformime të shiritave magnetike”. Duke e cilësuar situatën e arkivit të RTSH-së si tejet të rënduar dhe kritike, KLSH-ja tregoi se gjatë kontrollit “grupit të auditit nuk iu dorëzua zyrtarisht asnjë plan tekniko-financiar i dokumentuar për shpëtimin dhe digjitalizimin e arkivës 50-vjeçare”. Për shkak të keqmenaxhimit të fondit arkivor dhe problemeve teknike (mungesë konvertuesi të përshtatshëm) “një pjesë e mirë e arkivës është ende e padigjitalizuar dhe sot (2018) nuk mund të transmetohen”³⁶ as në RTSH Shqip dhe në asnjë kanal tjetër të paketës së RTSH-së.

Drejtoresha e programacionit, Rozeta Ferri, thotë se RTSH-ja transmeton të gjithë paketën e filmave të ish-Kinostudios që administrohet nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë.

Megjithatë në televizionin publik bëhet një seleksionim për sa i përket transmetimit. Përzgjedhja e filmave bëhet në raport me fashën orare. Përgjithësisht paraditeve shfaqen komeditë dhe filmat për fëmijë. Në mesditë dhe pasdite biografite, dramat etj. Mbrëmja ka kryesisht pjesë teatrale, por nuk përjashtohen as filmat premierë, realizime të viteve të fundit nga kineastë të ndryshëm shqiptarë. Në vitin 2017, RTSH Shqip transmetoi vetëm 16 filma premierë: “Amanet”, “Sex”, “Përrallë dhe celular”, “Amnistia”, “Krom”, “Një burrë, një udhë”, “Një ciceron për historinë”, “Hekur dhe Zot”, “Tuneli”, “Ti mund të më quash Xhon”, “Ndërkombëtarët (4 seri)”, “Të thyer”, “Dita zë fill”, “Engjëjt janë larg”, “Vëthi i munguar”, “Përtej detit”.

35. Kontrolli i Lartë i Shtetit; Auditim i performancës së Radiotelevizionit Shqiptar: “Projekti i digjitalizimit”; 2014 <https://bit.ly/2MV2E8f>

36. Bisedë me drejtoreshën e programacionit në RTSH, Rozeta Ferrin, për filmat e ish-Kinostudios dhe debatin e nxitur në vitin 2017.

3. AUTORËSIA E FILMAVE DHE DEBATI I VITIT 2017

Çështja e të drejtave mbi filmat e kohës së komunizmit mbart plot diskutime. Pretendimi i “autorësisë” ka qenë një prej debateve fillestare për arsye se prodhimi kinematografik i Kinostudios “Shqipëria e Re” apo dhe RTSH ka qenë tërësisht shtetëror. Nëse do të flisnim në terma juridike, atëherë do të thoshim se këto vepra janë “vepra të krijuara në bazë të një kontrate pune”, pra, “autorët/bashkautorët” kanë qenë të angazhuar si punëmarrës dhe për rrjedhojë çështja e të drejtave pasurore është e vështirë të zgjidhet. Gjatë debatit për mostransmetimin e filmave (2017), ky fakt u risoll sërish në vëmendjen e publikut.

Gjithsesi në ligjin e ndryshuar (2016) për të drejtat e autorit³⁷, çështja është zgjidhur për rastet në vijim. “Neni 69” që flet për veprat e krijuara në bazë të kontratave të punës (në pikën “1”) thotë se **“kur veprat krijohen nga një punëmarrës në kushtet e kontratës së punës, gjatë ekzekutimit të detyrave e të udhëzimeve të dhëna nga punëdhënësi i tij, do të konsiderohet se të drejtat pasurore dhe të drejtat e tjera për këtë vepër kanë kaluar ekskluzivisht për punëdhënësin, për një periudhë kohore prej 3 vjetësh nga data kur vepra i është dorëzuar punëdhënësit, përveç kur parashikohet ndryshe në kontratë”**. Pra, autorët fitojnë të drejta pasurore për filmat e tyre vetëm 3 vjet pasi i kanë dorëzuar porositesit/producentit/punëdhënësit një film (apo dokumentar). Fakti se ligji nuk ka fuqi prapavepruese – dhe që gjithashtu artistët e kohës nuk kanë pasur kontrata pune që saktësonin të drejta pasurore – bën që në situatën e filmave të kohës së komunizmit, pavarësisht harkut kohor, të drejtat do të mbeten në diskutim dhe të ndara mes palëve. Nga ana tjetër, materialet filmike janë edhe nën zotërimin e shtetit.

37. Ligji nr. 35/2016, dt. 31.3.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

Ndërkohë, kur kanë kaluar 28 vite nga “reformimi” i Kinostudios, apo dhe vetë RTSH, ende nuk ka një proces “privatizimi” apo kalimi të kësaj prodhimitarë nën zotërimi private. Sërisht administrimi fizik dhe ligjor i filmave të kohës së komunizmit i përket shtetit, institucioneve publike: ASHF, QKK dhe RTSH. Megjithatë, njohja e së drejtës morale mbi veprën kinematografike ka qenë nyja kyç për t’i dhënë zgjidhje këtij debati që, me ndryshimet e herëpashershme ligjore, ka ardhur në formën e ditëve të sotme ku autorët kanë përfituar edhe “të drejta ekonomike”, duke fituar kështu një lloj dinjiteti profesional pas një faze të vështirë tranzicioni.

Vende të huaja e kanë bërë këtë proces “privatizimi” – gjithmonë nëse mund të konsiderohet si i tillë – por në rastin shqiptar, kineastët duken të dyzuar. Përvoja jo dhe aq pozitive me privatizimet në tërësi ka bërë që personalitete të kinematografisë shqiptare, sikurse Esat Musliu, ta shohin me skepticizëm këtë pjesë. Në bindjen e tij, duke marrë në konsideratë periudhën e viteve të fundit me koncesionet, filmat mund t’i administrojë më mirë shteti.³⁸

Diskutimi i “pretendimit të autorësisë” ka gjetur një zgjidhje edhe në ligjin e ndryshuar të së drejtës së autorit (2016). Në nenin 16 të ligjit flitet mbi “Prezumimet ligjore mbi autorësinë”, ku (në pikën “1”) thuhet: **“Në mungesë të provave për të kundërtën, çdo individ ose grup individësh, emri i të cilit shfaqet mbi një vepër, cilado qoftë mënyra e shfaqjes, prezumohet autor i veprës.”**

Më tej, neni 97 e përcakton qartë edhe “bashkautorësinë në veprën audiovizuale”: a) regjisorin kryesor, i cili do të konsiderohet autori i veprës ose një ndër autorët e saj; b) autori i skenarit (skenaristi); c) autori i dialogëve; ç) kompozitori i veprës muzikore (me ose pa tekst), e krijuar posaçërisht për veprën audiovizuale; d) autori i përshatjes së veprës; dh) drejtori i fotografisë.

38. Bisedë me Esat Musliun për filmat e ish-Kinostudios dhe debatin e nxitur në vitin 2017.

Në rastin e diskutimit të vitit 2017, në lidhje me kufizimin, rregullimin ose ndalimin e transmetimit të filmave të kohës së komunizmit, çështja ndezi debat, pasi ashtu sikurse drejtori i IIPP-së, Bilal Kola, cilësoi Kushtetutën, nenin 3, për të argumentuar ndalimin e filmave, edhe kineastët cituan Kushtetutën për të argumentuar të kundërtën.

Neni 3, të cilit i referohej Kola, thotë se *“pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë.”* Kineastët argumentuan gjatë debatit se e drejtë e njeriut është edhe *“liria e shprehjes”* që sanksionohet gjithashtu në Kushtetutë në nenin 21. Kinematografia, pra filmi, është një formë shprehjeje dhe si e tillë nuk mund të shkelet. Po Kushtetuta flet edhe për të drejtat e autorit. Ato i trajton në nenin 58, që përcakton se *“liria e krijimit artistik dhe e kërkimit shkencor, vënia në përdorim si dhe përfitimi prej arritjeve të tyre janë të garantuara për të gjithë”*. Po në këtë nen thuhet se *“e drejta e autorit mbrohet me ligj”*.

Kështu, nëse Parlamenti do t’i përgjigjej pozitivisht kërkesës së IIPP-së dhe ISKK-së për të ndaluar filmat e kohës së komunizmit, kineastët mund t’i drejtoheshin Gjykatës Kushtetuese, duke e kthyer këtë çështje në një kauzë sa politike, aq edhe *“themelore për tiparet shqiptare të demokracisë”*.

3.1 Tarifafat – Sa vlejné filmat e “komunizmit”?

Në kulmin e debatit mbi filmat në vitin 2017, për opinionin publik nuk u kuptua qartë se – *pothuajse gjithmonë* – transmetimi i filmave të ish-Kinostudios bëhet përmes kontratash të lidhura me televizionet apo operatorët e tjerë transmetues. Pra, është një aktivitet ekonomik dhe të parët që nuk do kishin interes ta prishnin këtë aktivitet janë ata që përfitojnë prej saj: (pjesërisht shteti dhe) kineastët.

Nga të gjithë personat që u përfshinë në debat, i vetmi që ishte i hapur për të prekur këtë temë ishte regjisori Saimir Kumbaro. Ky i fundit deklaroi se për 12 filma të tij, të cilët transmetohen vazhdimisht, ai paguhet “*vetëm 1 milionë lekë (të vjetër) në vit*”³⁹. Sipas Kumbaros, si regjisor ai duhej të shpërblehej me 50 mijë lekë (të vjetër) për çdo transmetim të filmit, por kjo pagesë nuk i ishte kurrë me përpikmëri.

Agjencitë që mbrojnë të drejtat e autorëve nuk pranojnë të shprehen për kuotat që marrin anëtarët e tyre. Duke u fshehur pas konfidencialitetit, ata rezervohen duke treguar vetëm skemën e përlllogaritjes së tarifave, gjë që është bërë publike edhe nga Ministria e Kulturës. Pra, pretendimi i regjisorit Kumbaro është vështirë të konfirmohet, megjithatë ai mund të përlllogaritet: “*Saimiri dhe të tjerë, marrin në raport me aq sa filma kanë krijuar... ta them me shifra, nuk mundem, se sa para i takojnë, sepse kjo është diçka konfidenciale*”⁴⁰.

Në raport me shpërblimet, për agjenci si FMAA-ja ka më shumë peshë cilësia e prodhimit sesa sasia, kjo në mënyrë që “*ndarja e*

39. Intervistë me Alma Milen, “Ndalimi i filmave, shpërthen regjisori Saimir Kumbaro: Po na trajtojnë si kriminelë”; Panorama, 20 Mars 2017.

40. Bisedë me Esat Musliun për filmat e ish-Kinostudios dhe debatin e nxitur në vitin 2017-të.

kuotave të shpërblimeve të jetë sa më e drejtë, sepse ka raste që televizionet i për zgjedhin filmat dhe mund të mos marrin asnjë nga 'x' regjisor".⁴¹

Për të mënjeluar kësi rastesh ndodh që të jenë pikërisht regjisorët ata që interesohen më shumë për filmat e tyre dhe krijojnë kontakte me departamentet e programacionit në televizione të ndryshme. Disa regjisorë shpesh kanë mundur të marrin përsipër edhe kostot e ripërpunimit të filmave të tyre dhe t'ua ofrojnë më pas televizioneve, për një përfitim kontraktual prej transmetimit. Përmes kësaj strategjie janë shtuar mundësitë që filma si p.sh. "Zonja nga qyteti" dhe "Një shoqe nga fshati" të regjisorit Piro Milkani, të për zgjidhen vazhdimisht nga operatorët e transmetimit.

Për prodhimet e reja në kontratat me të tretët (jo me QKK-në), pra me prodhuesit, kontratat janë të mirëpërcaktuara si në kohë (një apo tri vite), ashtu edhe në shpeshhtësi transmetimi (projeksione). Këtu kostoja është më e lartë, sepse përgjithësisht çmimi është i përcaktuar nga producenti dhe jo agjencitë për mbrojtjen e të drejtave të autorit apo akoma më shumë Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit.

Sipas informacioneve "jozyrtare" nga një prej paketave digjitale "deri përpara ndryshimeve të metodologjisë së tarifimit, për një film të ish-Kinostudios paguhej nga 25 mijë deri në 40 mijë lekë në varësi të cilësisë filmike (me ngjyra ose pamje e pastër) ose edhe artistike, temë sociale dhe jo lufte".⁴²

Pra, nëse marrim për bazë këtë shifër dhe gjithashtu faktin se operatorët lidhin kontratë për komplet prodhimtarinë me rreth 250 filma, atëherë na rezultojnë se televizionet, ose paketat digjitale

41. Bisedë me Esat Musliun për filmat e ish-Kinostudios dhe debatin e nxitur në vitin 2017-të.

42. Bisedë me Fatos Riston për filmat e ish-Kinostudios dhe mënyrën e transmetimit të tyre në Tring.

paguajnë për filmat e ish-Kinostudios nga 6,25 milionë deri në 11,25 milionë lekë. Për të krijuar një ide, nëse i shkojmë linjës përlllogaritëse duke marrë çdo shifër si të mirëqenë, atëherë na rezultojnë⁴³ se **nga 3,56 milionë deri në 6,41 milionë mund t'i kalojnë artistëve/autorëve nga një kontratë e plotë me transmetimet e rreth 250 filmave për një vit.** FMAA-ja ka në radhët e saj 70 anëtarë. **Nëse këtë shpërblim do ta shpërndante në mënyrë të barabartë, një anëtar i saj do të përfitonte⁴⁴ afërsisht nga 50.900 lekë deri në 91.600 lekë në vit,** pra, afërsisht sa ç'pretendon edhe regjisori Kumbaro në deklaratat e tij.

Por duhet të kemi parasysh se kjo llogaritje hamendësuese vlen për vetëm 1 kontratë të mundshme dhe aq më shumë që tarifat e lëvruara i llogaritem të ndara në mënyrë të barabartë mes të gjithë anëtarëve. Në realitet nuk ndodh kjo, pasi gjatë një viti lidhen disa kontrata me shumë operatorë transmetues dhe jo të gjithë filmat përzgjidhen nga këta të fundit, çka do të thotë se kuotizimi është i ndryshëm dhe gjithashtu të ardhurat për artistët janë të ndryshme në varësi nga prodhimtaria që ata kanë pasur, dhe nga numri i kontratave që QKK-ja ka lidhur me operatorët e transmetimit.

Pasi kësaj llogarie, nuk duhet anashkaluar fakti se çmimi dhe kostoja e transmetimit të materialeve të ish-Kinostudios mbetet e pakrahasueshme me koston që marrin përsipër disa prej operatorëve më të mëdhenj në vend. Kjo vlen të thuhet sidomos për rastin e transmetimit të filmave/serieleve/produksioneve të huaja. Shifrat në këto raste mund të shkojnë deri dhjetëfishin, apo edhe më shumë, të hamendësimeve të bëra më lart. Fakti që këta filma kanë një kosto të ulët transmetimi bën që operatorët t'i konsiderojnë si “mbushje” të programacionit të tyre.

43. 57% e vlerës kontraktuale shkon në llogaritë e FMAA-së. Kështu që:

57% e 6.250.000 = 3.562.500; 57% e 11.250.000 = 6.412.500.

44. FMAA-ja ka 70 anëtarë. Kështu që: 3.562.500 / 70 = 50.892,85...; 6.412.500 / 70 = 91.607,14...

Vlen të thuhet se në kontratat me QKK-në nuk është saktësuar “sa herë” mund të transmetohet një material filmik nga operatorët e transmetimit, “*por ata s’mund ta bëjnë blozë, apo baltë*”⁴⁵. RTSH-ja, për shembull, në programacionin e vet ka një sistem që kontrollon dhe tregon se sa herë janë transmetuar filmat. Në bazë të këtij kontrolli, merret më pas vendimi nëse mundet apo jo të transmetohet një film i caktuar. “*Ne kemi një sistem programacioni të tillë që, kur është transmetuar, për shembull, filmi “Çifti i lumtur”, na del periudha dhe themi: Ok, është koha që ta rikthejmë. Kjo sepse nga pikëpamja profesionale një film transmetohet një herë në tre muaj, të paktën*”⁴⁶.

Në transmetimet publike, tranzicioni në teknologjinë digjitale ka bërë që tashmë TVSH-ja të zgjerojë transmetimin duke krijuar një platformë me më shumë se 12 kanale, por duke zgjeruar transmetimin ka shtuar edhe problematikën e shfaqjes së filmave propagandistikë të diktaturës. Në bazë të kontratës së shërbimit të transmetimit publik të nënshkruar me AMA-n (2016), RTSH-ja u ngarkua⁴⁷ të krijonte së paku 12 kanale me programacion të saj. Por ndërkohë, siç deklaroi në raportin e treguesve ekonomiko-financiarë të vitit 2017, RTSH-ja shpenzoi vetëm 225 milionë lekë⁴⁸ “*për blerjen e të drejtave të transmetimit, dokumentarë, filma, programe sportive, artistike etj.*”. Në vitin 2015, kur RTSH-ja nuk ishte e ngarkuar ende të shtonte programacionin për më shumë kanale, ky shpenzim ishte 199.2 milionë⁴⁹. Pra, me rreth 25 milionë lekë më shumë nga fondi i zakonshëm është menduar që të mbushet programacioni,

45. Bisedë me drejtoreshën e programacionit në RTSH, Rozeta Ferrin, për filmat e ish-Kinostudios dhe debatin e nxitur në vitin 2017.

46. Bisedë me drejtoreshën e programacionit në RTSH, Rozeta Ferrin, për filmat e ish-Kinostudios dhe debatin e nxitur në vitin 2017.

47. Kontratë e Shërbimit të Transmetimit Publik, AMA-RTSH, Neni 6 “Katalogu i Programeve”: “RTSH do të bëjë të mundur që brenda afatit 5 vjeçar të kontratës të ofrojë 2 programe HD dhe 10 programe SD, prodhime të vetë RTSH” <https://bit.ly/2BmV55F>

48. RTSH, Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve të RTSH gjatë vitit 2017 [https:// bit.ly/2I3vSTw](https://bit.ly/2I3vSTw).

49. RTSH, Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve të RTSH gjatë vitit 2015 <https://bit.ly/2SAM82N>

përveçse për kanalet e sportit, edhe për kanalet tematike si RTSH-Shqip apo RTSH-Film. Pikërisht për “*të mbushur*” programacionin, RTSH ka vendosur të shfrytëzojë edhe fondin filmik të QKK-së me filma të ish-Kinostudios, shpesh madje duke i transmetuar ata në më shumë se 1 kanal. RTSH tashmë e transmeton prodhimtarinë e ish-Kinostudios në RTSH 1, RTSH 2, RTSH 3 dhe RTSH Shqip. Kështu, problematika e debatit të vitit 2017 mbi propagandën e kinematografisë së ish-Kinostudios është amplifikuar më tej.

3.2 Metodologjia e tarifimit

Sipas metodologjisë së dakordësuar dhe të miratuar nga Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA) pranë Ministrisë së Kulturës, masën e tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit, operatorët e transmetimit do të duhet ta paguajnë në varësi të “*kohëzgjatjes së komunikimit në publik të veprës së mbrojtur gjatë një programacioni 24-orësh*”⁵⁰ (2017). E ndarë në katër kategori përqindjesh (deri në 10%; 11%–35%; 36%–65%; mbi 65%), shpeshësia e transmetimit dikton edhe tarifën, e cila, sipas vendimit të KKDA-së, është në raport me “*të ardhurat bruto vjetore*” që deklarojnë subjektet transmetuese.

KKDA-ja bazohet te Neni 8 i “Ligjit 35/2016 Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, ku thuhet se “*objekt i së drejtës së autorit është çdo krijim intelektual origjinal në fushën e letërsisë, artit dhe shkencës, i cili mbart karakteristika individuale, pavarësisht nga mënyra ose forma e shprehjes së tyre, objektivi, rëndësia, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj*”. Në pikën “d” saktësohet se objekt i së drejtës së autorit janë edhe “*krijimet audiovizuale në të cilat përfshihen krijimet kinematografike*”. Prandaj metodologjia e tarifimit, miratuar nga KKDA-ja vlen edhe për filmat e ish-Kinostudios.

50. Vendim Nr. 3, dt. 4.8.2017, Ministria e Kulturës; Këshilli Kombëtar për të Drejtat e Autorit.

Sipas metodologjisë së miratuar, “**televizioni kombëtar publik/privat**”, në kohëzgjatjen prej 24 orësh, paguan 1% të “**të ardhurave bruto vjetore**”⁵¹ për transmetimin e një vepre të mbrojtur deri në 10%; nga 11% deri në 35% paguan 2%; nga 36%–65% paguan 3% dhe për kohëzgjatjen mbi 65% paguan 4%.

Kohëzgjatja e komunikimit në publik të veprës së mbrojtur në programacionin 24 orësh	(deri në 10%)	(11% deri në 35%)	(36% deri në 65%)	(mbi 65%)
Tarifa në përqindje mbi të ardhurat bruto vjetore	1%	2%	3%	4%

Tabela 1. Përlllogaritja e tarifës për televizionet kombëtare sipas vendimit nr. 3, dt. 4.8.2017, Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar për të Drejtat e Autorit.

Për ta kuptuar më qartë, marrim si shembull TV “Klan” që është televizion kombëtar privat. Le të supozojmë se ky televizion transmeton filma të ish-Kinostudios dhe këtë po themi se e bën në një kohëzgjatje më pak se 10% të programacionit. Sipas formulës së tarifimit, për këto vepra kinematografike duhet të paguajë 1% të të ardhurave bruto vjetore. Në pasqyrat financiare të vitit 2017 të deklaruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), TV “Klan” ka deklaruar si të ardhura totale rreth 1,3 miliardë lekë (1.305.774.629 lekë). Sipas metodologjisë së pagesave për të drejtat e autorit, nëse TV “Klan” do të transmetonte filma të ish-Kinostudios, për to do të paguante 1% të të ardhurave totale që i takon rreth 13 milionë lekë (13.057.746 lekë).

51. Me “të ardhura bruto”, sipas përkufizimit të shtjelluar në vendimin Nr. 3 dt. 4.8.2017 të Ministrisë së Kulturës, “nënkuptohen të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit të deklaruara në pasqyrën financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit”.

Duhet theksuar se televizionet kombëtare private në Shqipëri, përgjithësisht nuk transmetojnë filma të ish-Kinostudios, pasi programacionin e tyre preferojnë ta mbulojnë me prodhimtari të huaj kinematografike apo me prodhimtari të vetë televizionit. Kjo bëhet në mënyrë që të tërhiqet më shumë audiencë dhe që koha televizive të jetë më e shtrenjtë për reklamuesit.

Në rastet kur operatorët e transmetimit nuk i deklarojnë të ardhurat bruto vjetore, tarifa e pagueshme është sa vlera më e lartë e paguar në Sportelin Unik (SUADA) prej së njëjtës kategori (për shembull televizion kombëtar) gjatë tre viteve të fundit. KKDA-ja përfshin në kategorinë “televizione” edhe subjektet që operojnë në rrjet me shërbim “*online-streaming*” (Web-TV), për shembull: Zjarr TV, TEMA-TV etj.

Për “*televizionet lokale*” përlllogaritja e tarifës është ndryshe. Ajo bëhet në varësi të të ardhurave dhe shtrirjes së popullatës që kanë zonat që mbulojnë. Televizionet lokale që deklarojnë të ardhura bruto vjetore mbi 5 milionë lekë paguajnë tarifë në përqindje (me katër kategorizime si për televizionet kombëtare: deri në 10%; 11%–35%; 36%–65%; mbi 65%) mbi kufirin prej 5 milionë plus edhe tarifën fikse sipas numrit të popullatës, kjo e përcaktuar në licensën e tyre. Për televizionet lokale që nuk i kalojnë 5 milionë të ardhura bruto vjetore, tarifa për t’u paguar është sa “niveli i tarifës fikse të përcaktuar sipas numrit të popullsisë”.

Kohëzgjatja e komunikimit në publik të veprës së mbrojtur në programacionin 24 orësh	(deri në 10%)	(11% deri në 35%)	(36% deri në 65%)	(mbi 65%)
Tarifa në përqindje aplikuar mbi të ardhurat bruto vjetore mbi kufirin prej 5 milionë lekë	1%	2%	3%	4%
Formula e llogaritjes së tarifës	1% * të ardhurat bruto mbi 5 milionë + tarifën fikse	2% * të ardhurat bruto mbi 5 milionë + tarifën fikse	3% * të ardhurat bruto mbi 5 milionë + tarifën fikse	4% * të ardhurat bruto mbi 5 milionë + tarifën fikse

Tabela 2. Përlllogaritja e tarifës për televizionet lokale sipas vendimit nr. 3 dt. 4.8.2017, Ministria e Kulturës; Këshilli Kombëtar për të Drejtat e Autorit.

Tarifë fikse sipas numrit të popullsisë të përcaktuar në licencë	Banorë '000	(deri në 10%)/ Lekë	(11% deri në 35%)/ Lekë	(36% deri në 65%)/ Lekë	(mbi 65%)/ Lekë
	Nën 20	40,000	60,000	85,000	120,000
	20-60	60,000	95,000	140,000	200,000
	60- 100	160,000	240,000	360,000	480,000
	100- 150	200,000	320,000	440,000	600,000
	150-200	240,000	360,000	520,000	720,000
	200-300	280,000	480,000	680,000	880,000
	300-500	320,000	520,000	720,000	1,000,000
	500-700	360,000	600,000	840,000	1,080,000
Mbi 700	400,000	680,000	960,000	1,200,000	

Tabela 3. Përlllogaritja e tarifës fikse për televizionet lokale sipas vendimit nr. 3 dt. 4/08/2017 Ministria e Kulturë, Këshilli Kombëtar për të Drejtat e Autorit.

Shembulli 1

Për ta kuptuar më qartë skemën, le të marrim si shembull televizionin lokal TV “Berati”, i cili nuk ka të dhëna në QKB për pasqyrat financiare. Le të supozojmë se televizioni nuk e kalon kufirin e 5 milionë lekëve të ardhura në vit. Dimë se popullsia e qarkut të Beratit, sipas Institutit të Statistikave, është 127.431 banorë⁵². Duke u konsultuar me Tabelën 3, kuptojmë kategorizimin e tarifës fikse që i përket këtij televizioni prej popullsisë që mbulon (100 mijë deri në 150 mijë banorë). Kështu “TV Berati” nëse do të transmetonte, për shembull, filma të ish-Kinostudios, do të duhej të

52. Sipas të dhënave të INSTAT-it për popullsinë në qarqe, 1 janar 2018.

paguante si tarifë fikse: 200 mijë lekë (për kohëzgjatje deri në 10%); 320 mijë lekë (për kohëzgjatje 11% deri në 35%); 440 mijë lekë (për kohëzgjatje 36% deri në 65%) ose 600 mijë lekë (për kohëzgjatje mbi 65%).

Nëse të ardhurat e TV “Berati” do të ishin më shumë se 5 milionë lekë, për shembull 6 milionë, shifrës së tarifës fikse i shtohen dhe vlerat e përfutuara prej përqindjes në raport me shifrën mbi 5 milionë, që në këtë rast është 1 milion lekë.

Duke u konsultuar me Tabelën 2 dhe përqindjet që i takojnë në kategorizimet e kohëzgjatjes së transmetimit, llogarisim dhe vlerën shtesë të tarifës fikse. Kështu për kohëzgjatjen deri në 10% i takon 1% e vlerës mbi 5 milionë. TV Berati do të paguante 1 mijë lekë shtesë mbi tarifën fikse (200 mijë tarifë fikse + 1 mijë tarifë mbi të ardhurat) e kështu me radhë për të gjitha kategorizimet.

Për sa i përket **“televizioneve kabllore”, “IPTV”** apo **“platformave digjitale”**, përlllogaritja e tarifave bëhet gjithashtu me dy ndarje për sa i përket të ardhurave bruto (mbi dhe nën 5 milionë). Në rastin kur operatorët e transmetimit kanë të ardhura mbi 5 milionë lekë atëherë përqindja e aplikuar do jetë mbi kufirin prej 5 milionë shto këtu edhe tarifën fikse të përcaktuar në licensë (shih Tabelën 3).

Kohëzgjatja e komunikimit në publik të veprës së mbrojtur në programacionin 24 orësh	(deri në 35%)	(36% deri në 65%)	(mbi 65%)
Tarifa në përqindje aplikuar mbi të ardhurat bruto vjetore mbi kufirin prej 5 milionë lekësh	2%	3%	4%
Formula e llogaritjes së tarifës	2% * të ardhurat bruto mbi 5 milionë + tarifën fikse	3% të ardhurat bruto mbi 5 milionë + tarifën fikse	4% të ardhurat bruto mbi 5 milionë + tarifën fikse

Tabela 4. Përlllogaritja e tarifës për televizionet kabllore sipas vendimit Nr. 3 dt. 4.8.2017, Ministria e Kulturës; Këshilli Kombëtar për të Drejtat e Autorit.

Kohëzgjatja e komunikimit në publik të veprës së mbrojtur në programacionin 24 orësh	Nr. abonentëve	(deri në 35%)	(36% deri në 65%)	(mbi 65%)
Tarifa fikse përlllogaritur sipas numrit të abonentëve	Nën 250	100,000	150,000	200,000
	251-350	150,000	200,000	250,000
	351 -500	200,000	250,000	300,000
	501 -650	250,000	300,000	350,000
	651-850	300,000	350,000	400,000

Tabela 5. Përlllogaritja e tarifës sipas vendimit Nr. 3 dt. 4.8.2017, Ministria e Kulturës; Këshilli Kombëtar për të Drejtat e Autorit.

Shembull 2

Për ta kuptuar më qartë këtë skemë, le të marrim si shembull platformën digjitale, “DigitAlb” e cila nga pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve të paraqitura në QKB, ka deklaruar si të ardhura për vitin 2017 rreth 5,3 miliardë lekë (5.323.153.369 lekë). “DigitAlb” ka një shtrirje përtej territorit shqiptar dhe për këtë hamendësojmë se ka një licensë (shih Tabelën 3) për mbi 700 mijë banorë. Gjithashtu kjo platformë ka një kanal kushtuar tërësisht filmit shqiptar. Supozojmë se filmat e ish-Kinostudios i transmeton me një kohëzgjatje 36% deri në 65%, që do të thotë se tarifa për këtë prodhimtari do të llogaritet sipas formulës përkatëse në Tabelën 4.

$$3\% (5.323.153.369 - 5.000.000) + 960.000 = 160.504.601$$

Sipas llogarisë tonë, me të ardhurat mbi 5 miliardë, “DigitAlb” do të duhej të paguante rreth 160 milionë lekë për prodhimet kinematografike të ish-Kinostudios.

Me shembujt dhe analizën e tarifimit të miratuar nga KKDA-ja mund të kuptojmë raportet dhe se deri ku mund të shkojnë shumat e pagesave që mund të paguajnë operatorët e transmetimit në varësi të të ardhurave të tyre në momentet kur shfrytëzojnë vepra që janë të mbrojtura me të drejtat e autorit.

3.3 Modele për një transmetim të denjë të filmave

Gjatë debatit të vitit 2017, shumë nga folësit publikë të cilët mbajtën qëndrimin kundër një transmetimi “*të lirë*” të prodhimit të ish-Kinostudios, ofruan gjithashtu edhe ide se si ky transmetim mund të ishte më i rregulluar.

Kërkesat për ndalim të plotë të prodhimit të ish-Kinostudios duken të porealizueshme, pasi në Shqipëri ende nuk ka një ligj të dekomunistizimit që i dënon dhe ndalon simbolet komuniste. Gjithashtu nuk ka asnjë ligj që ndalon Partinë Komuniste dhe ideologjinë e saj. Prandaj ideja për “*ndërhyrje në kinematografi*” pas një seleksionimi të filmave më propagandues duket më e moderuar. Një tjetër ide që u hodh gjatë debatit ishte pajisja me tekst shpjegues (përmes titrave) në hyrje ose përfundim të filmave. Por, përveç problemeve të tjera, kjo ndërhyrje ka kosto. Shumë prej operatorëve transmetues refuzojnë të shpenzojnë para apo dhe kohë për të përpunuar materiale që nuk janë prodhimi i tyre. Nga ana tjetër, AMA, apo edhe QKK-ja nuk kanë tagrin ligjor të ndërhyjnë apo dhe të krijojnë fonde për këtë pjesë. Kështu që zgjidhja e kësaj pike do të kërkonte vullnetin politik të Ministrisë së Kulturës, Komisionit të Medias dhe vetë Parlamentit.

Tjetër ide është digjitalizimi i të gjitha materialeve të ish-Kinostudios dhe krijimi i një muzeu virtual të prodhimit të kinematografike të komunizmit. Kështu, gjithkush që ka nevojë për informacion, mundet ta gjejë të shpjeguar thellësisht qoftë kontekstin, qoftë vetë filmin. Në këtë mënyrë të interesuarit për këto produkte filmike mundet t'i konsumojnë ato në mënyrë vetjake dhe të shmanget imponimi i një programacioni me filma të diskutueshëm të kësaj kategorie si nga transmetuesi publik ashtu edhe nga televizionet private. Por edhe kjo do të kishte kosto. Përveç kostove ekonomike për të mundur procesin dhe krijimin e muzeut virtual, nevojitet medoemos pëlqimi

dhe dakordësimi me regjisorët që gëzojnë gjithashtu të drejta mbi prodhimtarinë. Sigurisht në rrjet (internet) ka mënyra për të krijuar edhe “*feedback*” ekonomik përmes shikueshmërisë (reklamimi), por kjo me gjasë do të krijonte një hallkë shtesë burokratike apo do të shtonte polemikat se kujt do i takonte kjo pjesë e të ardhurave.

Nga idetë e tjera të përmendura në debatin publik, pjesa e titrimit ka gjithashtu kosto dhe duket disi e paarritshme, pasi ka kundërshti nga regjisorët, të cilët nuk lejojnë që të ndërhyhet në materialet e tyre. Megjithatë ka një ide tjetër që mund ta arrijë qëllimin e propozuar pa shtuar kostot dhe pa ndërhyrë te regjisorët: EPG.

Digjitalizimi i televizioneve ka bërë të mundur që programacioni tashmë t’u përcillet teleshikuesve në mënyrë të shpejtë dhe tejet komode përmes guidës elektronike. E ashtuquajtur EPG (Electronic-Program-Guide), tashmë ajo është funksionale për të gjitha kanalet dhe mundësohet vetë nga operatorët e transmetimit. Editorët, përgjegjësit e kanaleve kanë për detyrë t’u shpjegojnë teleshikuesve çdo programacion që televizioni transmeton. Kështu, në rastin konkret, ideja e ish-të përndjekurve për të shtjelluar kontekstin propagandistik të çdo filmi, mund të përfshihet në EPG-të e kanaleve dhe në këtë mënyrë as materiali filmik nuk preket, as dinjiteti i regjisorëve nuk fyhet. Sigurisht për të diktuar një model të njëjtë për EPG-të, do të ishte e nevojshme që një grup pune (përbërë nga historianë, regjisorë dhe studiues) të ndërtonte kategori analizuuese për të filtruar gjithë prodhimtarinë filmike.

Në guidën elektronike të RTSH-Shqip përdoret si përshkrim për filmat e ish-Kinostudios i njëjti përshkrim i bërë nga AQSHF-ja në kohën kur ai ka arkivuar filmat. Pra, RTSH-ja i transmeton këto materiale pa e aktualizuar përshkrimin.

4. PERSPEKTIVA NDËRKOMBËTARE PËR FILMAT E DIKTATURËS

Debati i vitit 2017 mbi filmat e ish-Kinostudios u fokusua vetëm te realiteti shqiptar, dhe nuk arriti të sillte modele nga përvoja ndërkombëtare në lidhje me këtë çështje. Duke dashur të kontribuonte në mënyrë sa më konstruktive në këtë debat, IDMC kontaktoi me institucionet e saj partnere në Europë, si Platforma Europiane për Kujtesën dhe Ndërgjegjësimin – Platform of European Memory and Conscience (PEMC) – për t'u njohur me përvojën e tyre. Më poshtë janë renditur informacione mbi politikat rregulluese të transmetimeve të kinematografisë komuniste (propagandistike) në Rumani, Letoni, Estoni, Sllovaki dhe Ukrainë. PEMC-ja ka anëtare 55 agjenci shtetërore dhe organizata joqeveritare nga 13 shtete të Bashkimit Evropian⁵³.

IDMC u dërgoi përfaqësuesve të organizatave partnere këto pyetje:

- a) *Ka pasur ndonjë debat në vendin tuaj rreth mostransmetimit të filmave të kohës së komunizmit dhe të materialeve propagandistike pas vitit 1990?*
- b) *Nëse po, si u zgjidh kjo çështje? U vendos ndonjë njoftim, apo ndonjë logo në figurë përpara ose/dhe gjatë filmit?*
- c) *Sa shpesh shfaqen filmat propagandistikë të kohës së diktaturës në vendin tuaj?*
- d) *A ka filma që ndalohen së transmetuari në televizion?*

53. PEMC, <http://www.memoryandconscience.eu/>

Shembulli i Letonisë⁵⁴

Sipas prof. Nollendorfs, situata e përgjithshme në Letoni gjatë pushtimit sovjetik mund të konsiderohet e dyfishtë. Nga njëra anë ishte një diktaturë komuniste me të gjitha atributet që i përkasin ideologjisë komuniste dhe propagandës së saj. Nga ana tjetër, ishte një diktaturë e huaj, e dominuar nga Moska, e cila rezultoi në një rezistencë, apo ndryshe, në një protestë subkoshience nga regjisorët të filmave, të cilët u përpoqën të afirmonin elemente nacionale në veprat e tyre.

Disa filma, ndoshta çuditërisht, ishin vërtet artistikë pa asnjë dozë ideologjike. Të tjerët, veçanërisht ata që merreshin me historinë e kohëve të fundit apo dhe me jetën e përditshme, do t'u duhej t'i bënin disa nderime asaj (ideologjisë). Kështu krijuesit e filmave dhe artistët shpesh u përpoqën të balanconin mes asaj që u kërkohesh nga ideologjia komuniste dhe asaj që audienca e tyre e kuptoi si nëntekst apo midis rreshtave, njëfarë rezistence kombëtare. Gjatë pushtimit, audienca mund ta filtronte shumë mirë dhe në mënyrë të arsyeshme pjesën ideologjike dhe të ndiqte linjën artistike të filmave. Në ditët e sotme, natyrisht, problemi është mungesa e një filtri të tillë.

Prof. Valters Nollendorfs thotë se në dijeninë e tij në Letoni “*nuk ka pasur ndonjë debat zyrtar ose publik dhe nuk ekziston ndonjë politikë zyrtare rreth transmetimit të filmave artistikë të prodhuar gjatë periudhës sovjetike*”. Ndërkohë propaganda e pastër sovjetike dhe naziste si dhe atributet e të dyja regjimeve janë të ndaluara, kështu që edhe filmat propagandistikë nuk transmetohen përveçse në kontekstin e dokumentarëve historikë. Filma artistikë që përmbajnë si element të ideologjisë, edhe të propagandës sovjetike, nuk janë ndaluar të transmetohen, por kur jepen, përcillen në kontekstin historik dhe

54. Valters Nollendorfs, profesor emeritus i gjuhës dhe i letërsisë gjermane.

minimalisht shfaqen me disa komente sqaruese. Vitet e fundit, shfaqja e dy filmave të tillë në televizionet publike shkaktoi një diskutim të zjarrtë mediatik.

Prof. Nollendorfs thotë se ka një listë filmash, përfshirë “dokumentarë” të periudhës së pushtimit sovjetik, të cilët janë të disponueshëm në internet dhe që nuk janë censuruar. Sidoqoftë, ai shton se nuk ka vënë re shënime apo paralajmërime për ata filma që janë dukshëm propagandistikë, as për filmat sovjetikë të përkthyer dhe që i vihen në dispozicion publikut.

Shembulli i Estonisë

Situata në Shqipëri ndoshta është mjaft e ndryshme nga ajo në Estoni. Rivendosja e shtetit estonez gëzonte mbështetjen e shumicës absolute të qytetarëve (estonezët etnikë). Prandaj filmat e propagandës sovjetike, madje ata të prodhuar nga regjisorët sovjetiko-estonezë, u njohën si të vjetruar nga shumica e estonezëve dhe thjesht nuk u shfaqën më. Më vonë disa prej tyre u shfaqën si një lloj kurioziteti, për shembull seritë polake “*Katër tankistët dhe qeni*” (Cztery pancerni i pies) apo filma të tjerë. Jeta përditshme e estonezëve është tashmë kaq e pangjashme saqë propaganda në këta filma thjesht nuk funksionon më.

Në vitin 2012, atje u festua 100-vjetori i kinematografisë. Në këtë kontekst, kanali i dytë i televizionit kombëtar shfaqti filmat e vjetër estonezë, një pjesë e të cilëve ishin prodhuar nga regjisorët estonezë gjatë kohës së Bashkimit Sovjetik. Kjo u bë duke u shoqëruar me prezantimin e disa historianëve të kinematografisë. Tjetër gjë janë filmat “*fiction*”. Për shembull filmi “*Relikti i fundit*” (Poslednyaya relikviya) i vitit 1969 në Estoni është filmi më i njohur nga të gjithë (janë të shumtë njerëzit që mund të citojnë fjali prej tij, që janë bërë proverba) dhe shumë popullor.

U ripunua dhe u bë me ngjyra disa vjet më parë – versioni i plotë gjendet në <https://youtu.be/ycW11A0nvqU>. Ky film është shfaqur të paktën dy herë në vit në televizionin kombëtar, në netët e mesverës si dhe natën e vitit të ri. Filmi “*Foleja e erës*” i cili flet mbi rezistencën kombëtare të armatosur, por edhe nga pikëpamja sovjetike (1979) është po ashtu popullor. Në “YouTube” janë të disponueshëm “*Lulet e egra*” (Metskannikesed) si edhe filmi i parë sovjetik estonez me ngjyra, “*Valgus Koordis*”, mbi kolektivizmin e bujqësisë (1951). Secili vend gjen metodën e vet për të arritur te një marrëveshje mbi filmat e epokës komuniste. Varet fort nga niveli i përgjithshëm i edukimit të popullsisë, niveli i nostalgjisë në shoqëri dhe standardi i jetesës së momentit. Paradoksalisht, është paksa më e lehtë në ish-vendet e pushtuara – filmat sovjetikë nuk janë tyret, por vijnë nga epoka të ndryshme. Përveç kësaj, shumica janë thjesht të një cilësie aq të ulët, saqë askush nuk do i shikonte nga fillimi deri në fund.

Shembulli i Holandës⁵⁵

Sipas ekspertit holandez Klaas van der Horst, Holanda vërtet nuk ka ndonjë eksperiencë të kohëve të fundit me trysninë komuniste, por edhe atje, disa e kanë të vështirë të bien në paqe me të kaluarën. Një shembull i kohëve të fundit është mënyra e redaktimit të librave të historisë. Në vitin 2016, një shtëpi botuese e specializuar në librat shkollorë, u kritikua për mënyrën se si e përshkruante ende situatën në Evropën Lindore pas Luftës së Dytë Botërore. Për shembull, thuhej se Polonia u “çlirua” prej Gjermanisë naziste nga Bashkimi Sovjetik. Kjo ofendoi polakët që jetonin në Holandë. Instituti SGTRS bëri një ankesë ndaj shtëpisë botuese, por nuk pati korrigjim.

55. Klaas van der Horst, sekretari i Institutit “Historia, regjimet totalitare dhe viktimat e tyre”; *Geschiedenis Totalitaire Regimes en hun Slachtoffers – SGTRS, Hollandë*.

Shembulli i Sllovakisë⁵⁶

Në Sllovaki nuk ka pasur një debat të mirëfilltë rreth transmetimit apo mostransmetimit të filmave të kohës së komunizmit. Megjithatë ka pasur konsultime në televizione rreth vlerësimit të materialeve të cilat do të transmetoheshin. Ky vlerësim është kryer nga regjisorë dhe skenaristë. Edhe pse me ideologji, disa nga filmat kanë vlera artistike dhe në të njëjtën kohë paraqesin një përshkrim të gjendjes sociale të kohës. Shumica e kësaj prodhimtarie është shfaqur në televizione. Nuk ka pasur asnjë problem të kontekstit të urrejtjes etnike, diskriminimit apo të ksenofobisë. Andrea Púčiková nga Instituti i Kujtesës së Kombit Sllovak është e mendimit se filmat që kanë pasur karakteristika të tilla janë hequr nga programacionet e televizioneve.

Në Sllovaki filmat e përzgjedhur për transmetim nuk kanë pasur logo apo tekst shpjegues shtesë. Ata janë transmetuar në formën e tyre origjinale. Për rastin shqiptar, Púčiková është e mendimit se zgjidhja mund të ishte transmetimi i disa filmave të caktuar pas një debati në studio mes historianësh apo ekspertësh që mund ta vendosin filmin në kontekstin e duhur dhe kështu të mund të balancojnë materialin filmik.

Në Sllovaki zyrtarisht nuk ka filma të ndaluar. Por shumica e filmave nuk transmetohen më në televizione, pasi regjisorët dhe skenaristët kanë vendosur vetë se ata nuk janë më të përshtatshëm për publikun. Filmat e krijuar në kohën e komunizmit me propagandë të theksuar, si për shembull revolta kombëtare sllovaqe dhe filmat e tjerë me kontekst nacionalist por të ndërthurur me ideologji, nuk transmetohen pasi në këtë mënyrë mund të përhapin pikëpamje komuniste, naziste apo ekstremiste të kohës së shkuar dhe të rindezin tensione në shoqëri.

56. Andrea Púčiková, Zyra e Kryetarit të Bordit të Drejtorëve, të Institutit të Memories së Kombit (Nation's Memory Institute) Sllovaki.

Shembulli i Rumanisë⁵⁷

Në Rumani që pas vitit 1990, në televizionin publik nuk është transmetuar asnjë video apo material që përmban propagandë komuniste. Gjatë periudhës së fillimviteve '90, sidomos në fushatat elektorale, pati shpesh fjalime me përmbajtje të caktuar nostalgjie apo dhe me implikime të caktuara ideologjike të epokës komuniste. Ka pasur kritika apo dhe sulme ndaj historisë së paraluftës apo ndërmjet partive, por kurrësi transmetim të materialeve propagandistike të regjimit komunist. Për t'u përmendur është fakti se kjo periudhë ka qenë shumë e ashpër dhe televizioni publik ende është i pareformuar nga gazetarët komunistë që bënin pjesë në të. Nëse i referohemi filmave dokumentarë, gjatë këtyre 27 viteve nuk ka pasur asnjë transmetim të propagandës komuniste, qoftë në televizionin publik, po ashtu edhe në televizionet private.

Duhet thënë se historia e Rumanisë së pasrevolucionit është tejet specifike. Si fillim atje ndodhi revolucioni me mjaft të vdekur dhe me plot dhunë nëpër rrugë. Më pas erdhi sulmi i minatorëve, thirrur nga pushteti i ri neokomunist për të mbrojtur minierat, por edhe asokohe u mbajt, gjithsesi, një sens i demokracisë së pretenduar. Në Rumani nuk thuhet nëse heqja e beftë e propagandës filmike të komunizmit u bë me detyrim apo ishte thjesht një vazhdimësi e natyrshme e shkëputjes me të shkuarën komuniste.

Pushteti që u ngrit menjëherë pas Revolucionit (22 dhjetor 1989) ishte i formuar nga komunistë të rangut të dytë, të cilët nuk e quanin kurrë veten si të tillë. Në fakt ata deklaroheshin antikomunistë dhe demokratë, edhe pse në mënyrë hipokrite. Por zyrtarisht, shteti rumun u bë shtet jokomunist menjëherë pas Revolucionit dhe të gjitha institucionet vepruan në sintoni.

57. Opinion nga Alexandra Razvan, Florian Mihalcea dhe pjesëtarë të tjerë të shoqërisë "Timișoara", themeluar pas vitit 1990, në revolucionin që solli rrëzimin e regjimit të Nikola Çausheskut.

Për sa i përket filmave artistikë të prodhuar gjatë epokës komuniste, po, ata vazhduan të transmetoheshin nëpër kinema për një kohë të shkurtër ndërsa në televizion vazhdojnë të jepen edhe ditët e sotme. Por kanë qenë gjithmonë në konkurrencë të fortë me prodhimtarinë amerikane, prandaj, nëse flitet në aspektin komercial, filmat e vjetër komunistë konsiderohen (si mesazhe, jo si vlera artistike) thjesht modë e vjetër dhe e tejkaluar. Nga ana tjetër, artistët që i krijuan ata (aktorët, regjisorët, specialistët e kamerave, kompozitorët) konsiderohen si vlera të kulturës. Pjesa më e madhe vazhduan të bëjnë filma edhe pas dhjetorit 1989 dhe disa prej tyre realisht janë vlerësuar nga kritika dhe publiku.

Situata në Ukrainë⁵⁸

Në Ukrainë, debati për dënimin e krimeve të kryera gjatë komunizmit dhe për ndalimin e simboleve të formave të ndryshme të regjimit, u zhvillua pas vitit 1991. Si pjesë e simboleve të komunizmit shpesh janë konsideruar filmat dhe materialet e tjera të transmetimeve, të prodhuara gjatë periudhës sovjetike. Por deri në vitin 2014 nuk ka pasur ligj apo vendim parlamentar a qeveritar që ta merrte në shqyrtim çështjen.

Situata ndryshoi në mënyrë drastike pas tensioneve dhe luftës civile në Ukrainë, pas shpëputjes së Krimesë dhe nisjes së agresionit kundër Ukrainës në Donbas.

Simbolet komuniste dhe filmat e asaj periudhe të kohës sovjetike u përdorën gjerësisht nga propaganda proruse dhe nga elementë qeveritarë për të justifikuar qasjen e Rusisë ndaj Ukrainës. Kjo u vërejt në fillim të vitit 2015 dhe në këtë periudhë Parlamenti i Ukrainës ndryshoi ligjin 9/98-VR të kinematografisë, me ligjin special 159-VIII për “mbrojtjen në fushën e informacionit”⁵⁹.

58. Opinion nga Sergii Riabenko, Instituti Ukrainas i Kujtesës Kombëtare

59. Ligji ukrainas për kinematografinë: <https://zakon.rada.gov.ua/laws/show/9/98->

Sipas Nenit 15 të këtij ndryshimi, është e ndaluar në çfarëdolloj forme përhapja dhe shfaqja e këtyre materialeve filmike, që popullarizon apo bën propagandë të agjencurës sovjetike, apo që justifikon pushtimin e territoreve të Ukrainës. Në ligj thuhet qartë se në kinematografi është e ndaluar që agjencura sovjetike të paraqitet “pozitivisht”.

Përgjegjësitë ligjore për shkeljen e normativave të këtij ligji janë të formës së penaliteteve, të cilat paguhen nga kompanitë televizive apo radiofonike.

Në prill të vitit 2015, Parlamenti i Ukrainës miratoi Ligjin nr. 317 VIII që dënonte regjimet totalitare naziste dhe komuniste, dhe ndalonte përdorimin e simboleve të tyre⁶⁰.

Në bazë të ligjit, në Ukrainë tashmë është e ndaluar propaganda e regjimit komunist dhe simbolet e tij. Ndalohet, sidomos në medie, propagandimi i natyrës së regjimeve totalitare të viteve 1917–1991, sikurse nazizmi, komunizmi, regjimi sovjetik në territorin ukrainas etj. Ligji nr. 317 ndryshoi gjithashtu nene të ligjit për radiotelevizionin, duke ndaluar transmetimin e çfarëdolloj përmbajtjeje audiovizive të punuar gjatë kohës së shkuar që mohon apo justifikon natyrën kriminale të regjimeve totalitare të periudhës 1917–1991 në Ukrainë.

Që prej miratimit të legjislacionit, disa raste të televizioneve kombëtare ukrainase që i kanë thyer normat dhe kanë transmetuar filma sovjetikë apo episode të tjera, kanë marrë paralajmërime si edhe janë ndëshkuar nga autoriteti i medieve.

%D0%B2%D1%80

60. Ligji ukrainas që dënon dhe ndalon propagandën komuniste dhe naziste: <https://bit.ly/397PY7E>

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Një pjesë e ish-vendeve komuniste në Evropë, të cilat e vuajtën regjimin totalitar, prej kohësh e kanë trajtuar çështjen e menaxhimit të veprave propagandistike që prodhoi diktatura në art. Në shumicë, këta filma nuk transmetohen më në televizionet publike e tyre, ndërkohë që ka pasur një qasje kritike ndaj propagandës që ata përcjellin.

Edhe pse kanë kaluar 30 vjet nga rrëzimi i komunizmit, Shqipëria i transmeton pa mbajtur një qëndrim kritik ndaj veprave kinematografike që prodhoi sistemi i kaluar. Ekspertë të komunikimit, por edhe vetë kineastët, pranojnë se pjesa më e madhe e filmave të ish-Kinostudios kanë një nivel të lartë propagandistik. Mungesa e një këndvështrimi kritik dhe mosfiltrimi i fondit filmik nga realizimet më propaganduese vazhdon të nxisë nostalgjinë dhe konsumin e këtyre filmave, duke shqetësuar ish-të përndjekurit dhe institucionet që përkrahin rehabilitimin e tyre. Shqetësimi kryesor i këtyre të fundit është edukimi i cekët që i ofrohet brezave të rinj rreth së shkuarës totalitare të Shqipërisë.

Ky studim tregoi se transmetimi i veprave filmike të ish-Kinostudios është rregulluar me ligj dhe prej tij përfitohen të ardhura financiare si për Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, edhe për kineastët e artistët. Aktualisht filmat transmetohen në platformën e Radiotelevizionit publik Shqiptar, në dy platformat digjitale private, “DigitAlb” dhe “Tring”, si dhe në disa kanale lokale. Transmetimi i tyre është i njëjtë, pa asnjë nënshkrim/mbishkrim apo logo që paralajmëron nivelin e propagandës dhe deformimet historike.

Duke pasur parasysh disa aspekte tejet ndikuese, si për shembull kostot ekonomike dhe burokracitë institucionale dhe politike,

studimi rekomandon që institucionet dhe shoqatat që përkrahin rehabilitimin e ish-të përndjekurve apo reflektimin mbi të shkuarën të rikthejnë diskutimin për një transmetim më të kujdesshëm të veprave filmike që propagandojnë diktaturën dhe regjimin komunist.

Nga ana tjetër rekomandohet që diskutimi i ri të krijojë një frymë bashkëpunimi me QKK-në dhe kineastët, në mënyrë që të rregullohet ndërhyrja në produksionin filmik të Kinostudios, por pa bllokuar tërësisht transmetimin e tyre.

Në mënyrë specifike ftohet t'i bashkohet këtij debati RTSH-ja, që për vetë statusin si transmetues publik që ka nuk duhet të lejonte në asnjë mënyrë transmetimin e materialeve filmike të prodhuara gjatë diktaturës komuniste. Në mungesë të një vendimi për të mbishkruar tekste njoftuese në materialet filmike, redaksitë e programacionit duhet të vihen nën trysni për të rishikuar së paku përmbajtjen shpjeguese të veprave në guidën elektronike të kanaleve. Do të ishte e mirëpritur që grupet e interesit t'i paraprinin debatit duke propozuar një manual apo përmbledhje shpjegimesh adekuate për guidën e kanaleve.

SHTOJCË I: INTERVISTA

1) Intervistë me **JONID JORGJIN**, regjisor, Shoqata e Kineastëve të Rinj “Belmond”, më 5 shkurt 2018, Tiranë.

EV: Si ju duket gjendja e kinematografisë shqiptare, ka prodhime?

JJ: Gjendja nuk është dhe aq e mirë. Sigurisht ka pasur zhvillime dhe herë pas here ka edhe cilësi në produktet kinematografike, por buxheti që ofrohet kryesisht nga QKK-ja dhe mbështetja për një film me metrazh të gjatë nuk janë kurrsesi të mjaftueshme. Për rrjedhojë regjisorët duhet të gjejnë vetë mbështetje financiare dhe shpesh u duhet t’i ndajnë projektet e tyre me të huaj, kjo për të shtuar mundësitë e realizimit. Kur dëgjon për filma të huaj dhe buxhetet e tyre, e më pas i krahason me ato të Shqipërisë, e kupton më qartë se përse nuk ka shumë cilësi.

EV: Mos ndoshta kjo është arsyeja kryesore se pse filmat shqiptarë u mungojnë kinemave dhe kryesisht atje ndiqen vetëm prodhimet e huaja?

JJ: Po, kjo është arsyeja kryesore. Krahas kësaj, në Shqipëri nuk është lëvruar ende praktika e shoqërive që distribuojnë filmat, pra që të merren vetëm me këtë gjë dhe të kenë shtrirje, akses dhe mbulim edhe përtej vendit. Fakti që ka shumë hendek në këtë pjesë, i ngarkon regjisorët që të merren edhe me shpërndarjen e filmit të tyre. Shpesh koha, kontaktet jo dhe aq të shumta, por edhe mungesa e njohjes me vendet e huaja, i dënon regjisorët që produktin e tyre të mos kenë mundësi ta promovojnë si duhet.

EV: Po për filmat e vjetër të periudhës komuniste, si veprohet me to? I hasim edhe më shumë se filmat e pasviteve '90. Pse?

JJ: E para sepse sikurse thamë, për filmat e tyre janë kryesisht vetë regjisorët që merren me distribuimin. Pra për filmat e pasviteve '90 janë vetë regjisorët që hyjnë në marrëdhënie me transmetuesit, duke qenë vetë ata që fiksojnë edhe çmimet për produktet e tyre. Këtu kam përshtypjen se televizioneve apo dhe paketave digjitale nuk u intereson shumë të diskutojnë vetëm për 1 produkt kinematografik. Ata interesohen për një paketë me shumë filma, kjo në mënyrë që kostoja të jetë më e lirë dhe mbulimi i fashës orare të jetë më i plotë në kanalet respektive. Për filmat e paraviteve 90, të realizuar nga Kinostudioja, pronare, si të thuash, e atyre produkteve kinematografike që realizoi sistemi, është Shteti. Cilësia e atyre filmave, në aspektin e realizimit, ka qenë e lartë pasi kostoja e punës nuk llogaritej, po kështu edhe e mjeteve të transmetimit, që mbulohej tërësisht nga Shteti, prandaj në këtë sens ata filma vazhdojnë t'i rezistojnë kohës, pasi nëse do të doje të realizoje një film të atillë sot, buxheti do ishte i vështirë për t'u përballuar. Në shpërndarjen e filmave pastaj janë vetë ata të QKK-së që hyjnë në bisedime me të interesuarit dhe këtu flasin për paketa të tërë filmash që negociohen.

EV: Ju me shoqatën tuaj jeni pjesë e hallkave vendimmarrëse të QKK-së. Çfarë mund të thoni për të si organizëm?

JJ: Po, krahas Shoqatës së Kineastëve të Rinj "Belmond" ka edhe 6 shoqata të tjera që, sikurse parashikon statuti, propozojnë dhe zgjedhin këshillat miratues të projekteve në QKK, për afat 2-vjeçar. Synimi është mbrojtja e interesave artistike dhe ekonomike të kineastëve, por edhe nxitja për të prodhuar filma. Kjo strukturë e tillë operon që prej vitit 1997 dhe sigurisht nuk është perfekte, por as e keqe.

EV: Flasim pak për vizionimin, kontrollin dhe si të thuash filtrimin që mund t'u bëhen filmave. QKK-ja ka edhe komisionin e vizionimit. Si vepron ai?

JJ: Po, ky komision kryesisht u jep, ose nuk u jep, dritën jeshile distributorëve për qarkullimin ose jo të filmave të tyre. Ka një lloj klasifikimi, në bazë të disa kriterëve që përcaktohen me ligj, si grupmosha, lloji i filmit, që absolutisht nuk duhet të jetë diskriminues, fyes ndaj komuniteteve të caktuara apo racist.

EV: Po për të drejtat e autorit, ka shumë filma që transmetohen lirshëm online, por sidomos edhe në televizione. Si veprohet?

JJ: QKK-ja, për ashtu si e shoh unë, e ka të pamundur të kryejë një monitorim të plotë për këtë pikë. Kryesisht veprohet me ankesa kur ka thyerje të të drejtave të autorit për transmetime pirate. Nuk është se pritet shumë nga QKK-ja për këtë pjesë.

EV: Filmat e kohës së komunizmit transmetohen krejt lirshëm në këtë drejtim.

JJ: Po, sepse sipas mendimit tim nuk ka shumë interes te kjo pjesë. Siç thashë, për to përgjigjet QKK-ja, plus është e vështirë të kontrollohen të gjitha mediet. Dakord, në Tiranë dhe ato mediet me të cilat ka kontrata, po, por për mediet lokale në zona rurale që i përdorin këta filma për të mbushur programacionin, them se është e pamundur për t'i bllokuar.

EV: Po ju si mendoni, si duhet të jetë transmetimi i këtyre filmave, duke pasur parasysh se vitin që shkoi kishte edhe një debat në lidhje me faktin se pjesa më e madhe e atyre prodhimeve kanë qenë propagandistike?

JJ: Është një diskutim i gjerë. Si regjisor, në aspektin artistik, them se për atë kohë ka plot produkte me cilësi, sikurse dhe të tjera pa cilësi. Në këtë pjesë them se duhet një diskutim më gjithëpërfshirës, pasi normalisht nuk mund të pretendosh që regjisorët e asaj kohe të bien dakord që filmat e tyre të mos transmetohen, por këtu them se duhet të flasin edhe historianët, të flasë edhe publiku. Është komplekse sigurisht, por që do vëmendje kjo pjesë, do.

2) Intervistë me **FATOS RISTON**, drejtor programacioni në “Tring Digital”, më 10 shkurt 2018, Tiranë.

EV: Si veprohet me transmetimin e filmave shqiptarë në “Tring”?

FR: Në kanalën “Shqip” transmetohen filmat e ish-Kinostudios “Shqipëria e Re”. Në dijeninë time janë rreth 250 filma dhe janë vetëm të Kinostudios, pra jo prodhimet televizive të RTSH-së, se kryesisht publiku që ka pasur raste edhe është interesuar, nuk i dallon këto dhe pyet se përse nuk transmetohen edhe disa filma të tjerë.

EV: Pse është vepruar kështu, pse nuk transmetoni edhe filma të pasviteve 90?

FR: Është një zgjedhje si rezultat i kostos. Distributorët e filmave të pasviteve 90 janë disa herë më të kushtueshëm dhe, plus kësaj, shpesh të ofrojnë më pak produkte që nuk mundësojnë dot një paketë specifike për një kanal. Ka raste që ofrohen edhe regjisorët që prodhojnë filmat e tyre, por kostoja është e lartë dhe nuk ka shumë interes për ne si operatorë transmetimi.

EV: Sa është kostoja për filmat e kohës së komunizmit?

FR: Me dijeninë time është te 250 deri në 400 mijë lekë (të vjetër) për film. Për këtë pjesë, televizionet dhe ne si paketë digjitale lidhim kontrata me QKK-në. Kontratat janë një-, dy- ose katërvjeçare. Mbaj mend se në fillim (vitet 2008–2010) kostoja ishte disa herë më e lirë, rreth 70–75 mijë lekë.

EV: Si veprohet me pagesat. Shkojnë te regjisorët e atyre filmave apo ku?

FR: Nuk di ta them këtë pjesë, por kam përshtypjen se këto pagesa kontraktuale, QKK-ja i shpërndan më pas te ata regjisorë që kanë kontribute në këta filma për të cilët po flasim. Diçka mund t’u shkojë edhe atyre.

EV: Hidhini një sy kësaj listës me 82 filma që kam këtu, mund të më konfirmoni se cilët nga këta transmetohen në kanalën “Shqip” që ka paketa juaj?

FR: Po, të gjithë këta filma transmetohen në “Tring”.

EV: Si veprohet me transmetimin e tyre, ka ndonjë kategorizim në “playlist”, një lloj seleksionimi?

FR: Jo, nuk është se ka ndonjë përzgjedhje. Nëse mund ta konsiderojmë kështu, gjatë fundjavëve transmetohen kryesisht ata filma që janë me ngjyra dhe komedi, dhe në ditë festive, si për shembull në festat kombëtare, si ato të nëntorit, transmetohen filma të dedikuar si për shembull “Skënderbeu”, apo “Nëntori i Dytë” dhe filma me partizanë.

EV: Në listën e filmave që ju tregova, bëjnë pjesë filma të cilët transmetohen lehtësisht në rrjet dhe vetëm në “YouTube”

kanë gjeneruar rreth 6 milionë shikime së bashku. Si e shihni këtë pjesë që ju paguani për një produkt që piratohet lehtë?

FR: Kjo është pjesë që normalisht duhet të na shtyjë ne të platformave televizive apo dhe vetë televizioneve që të kërkojmë ose kosto më të lirë për këto produkte kinematografike, ose që vetë QKK-ja të ngarkojë kompani të cilat t'i luftojnë fort të drejtat e filmave, sepse në kontratat tona parashikohen edhe platformat, pra kanalet e transmetimit, ndërsa këtu po flasim që në rrjet ato transmetohen pa fre.

EV: Për këtë pjesë ka pasur diskutime, sidomos për sa i përket çështjes së transmetimit të filmave propagandistikë të asaj periudhe, ju si e shihni? Ka në “Tring” një lloj filtri?

FR: Jo, nuk është se kemi ndonjë filtër që “shiko se ky film s’do të transmetohet, sepse është me partizanë”. Si operatorë transmetues, përmbajtja na përcillet nga distributorët, në këtë rast QKK-ja. Pastaj sikurse e keni vënë re nga shikueshmëria në rrjet, interesi për t'i parë këta filma mbetet i madh, kështu që për ne në aspektin thjesht si konsum nuk ka asnjë problematikë.

3) Intervistë me **ERALD KAPRIN**, anëtar i Këshillit të Ankesave, Autoriteti Mediave Audiovizive (AMA), më 17 shkurt 2018, Tiranë.

EV: Kush ishte thelbi i diskutimit që u hap vitin e kaluar (2017) për çështjen e filmave të ish-Kinostudios?

EK: Së pari, thelbi ka qenë te raporti apo qëndrimi që mbajmë ne me të kaluarën. Së dyti, respekti mbi realitetin në të cilin kemi jetuar,

sepse nuk është vetëm e drejta dhe liria e shprehjes... Më përpara, transmetimi i këtyre filmave nuk ka qenë dhe aq problem, pasi ka pasur pak medime ku të shfaqeshin. Tani që po bëhet edhe digjitalizimi, ka një mori ekranesh pa fund. Nevoja për të shtuar programacionin është e lartë dhe për shkak të buxheteve dhe të ardhurave të vogla, gjendet kjo mënyrë e tillë, pra me këta filma. E gjitha kjo nisur edhe nga një kërkesë e tregut, po ta themi, sepse në audiencë ka njëfarë nostalgjie. Brezi i kaluar, por edhe brezi i dytë që e jetoi disi atë periudhë, i shohin këta filma me kërshtëri sepse u duket sikur shohin jetën e tyre në të kaluarën.

EV: Por pse ai reagim, pse pati mjaft komente negative sipas jush?

EK: Në raport me diskutimin etik dhe qasjen kritike mbi të kaluarën, unë mendoj se çalojmë si shoqëri dhe kjo është e frikshme. Po ta shohim, reagimin më pozitiv në raport me të kaluarën e kanë pasur njerëzit më të formuar dhe ata të cilët kanë kontribute reale për shoqërinë. Edhe në komunitetin e aktorëve dhe artistëve, ata që kanë pasur një sukses të konsiderueshëm gjatë tranzicionit, pra ata që kanë më tepër vlera, patën qëndrim më pozitiv ndaj idesë për të pasur filtra të filmave të ish-Kinostudios. Njerëz të nivelit të Ndriçim Xhepës apo Ismail Kadaresë folën hapur dhe e cilësuan si të pamoralshme dhënien e këtyre filmave, ndërsa njerëz që kanë dy-tre interesa të vegjël dhe që nuk dallohen për ndonjë gjë, bënë atë reagim që bënë.

EV: U fol se ka cilësi artistike për këta filma...

EK: Filmat nga pikëpamja profesionale janë të një cilësie skandaloze. Po ta krahasojmë në raport me Evropën Lindore, filmat çekë, në mes të viteve 60 fitonin Oskar, pra ata kishin një prodhimtari të një niveli krejt tjetër që vlerësohej edhe ndërkombëtarisht. Po te ne

kush është vlerësuar ndërkombëtarisht? Mos harrojmë pastaj që e gjithë gama e filmave ishte e gjitha një skemë bazuar në një sistem krejtësisht të gabuar vlerash dhe që përdorej për të mbajtur njerëzit nën kontroll, pra në sistem diktatorial. Sistem që impononte një mori të caktuar vlerash në moral, në raport me qëndrimet politike, besimin, të drejtat dhe kështu me radhë.

EV: Një argument kundër ishte se edhe në Hollivud janë bërë filma denigrues për disa kategori të shoqërisë...

EK: Po, u tha edhe kjo, por Hollivudi ka dashur shpesh të japë mesazhe që lidheshin me aktualitetin, por kurrsesi nuk ka pasur qëllime denigruese në masë dhe aspak nuk ka qenë një trend kjo gjë, atje. Plus, ka ndryshim të madh mes të pasurit qëllim dhe të bërit dy-tre filma denigrues. Nëse ka dalë një problem me figurën e priftit, për shembull, me rastet e pedofilisë, kjo gjë pasqyrohet te një film si pjesë e aktualitetit, por nuk është se bëhen 20 apo të gjithë filmat ku figura e priftit paraqitet e tillë.

EV: U fol gjithashtu edhe për censurë...

EK: Ideja është për ato kanale tradicionale, të cilat ne i konsiderojmë hapësirë publike. Nuk bëhet fjalë për censurë, pasi nuk ka vlerë. Sepse mendoj se duke vepruar kështu do ta rrisnim interesin ndaj tyre. Ideja thelbësore ishte propozimi për disa filtra, orare të përcaktuara, përzgjedhje, seleksionim filmash...

EV: Filtrat kush mund t'i aplikonte? AMA apo QKK-ja?

EK: Mendoj të dyja, edhe AMA, edhe QKK-ja në bashkëpunim me njëra-tjetrën, kjo duke pasur nevojën, pse jo, edhe një amendim të ligjit. Por unë mendoj se me një vullnet të mirë institucional dhe me bashkëpunimin e operatorëve mund të arrihet diçka. Por

operatorët janë kundër, sepse kanë interesin e tyre për të mbushur kohët e transmetimit me kosto sa më të ulët.

EV: A mund të garantonte kjo luftë ndaj piraterisë dhe një produkt më cilësor për operatorët?

EK: Pirateria s'ka qenë problem për këta filma, kjo për shkak të çmimit qesharak me të cilët sigurohen kontratat si paketë. Për të qenë në rregull, operatorët i blejnë. Kontratat për blerjen e të drejtave të tyre dorëzohen te AMA dhe më pas verifikohen.

EV: Çfarë thotë ligji për filmat?

EK: Ligji për kinematografinë është i mirë, por nuk është shumë i zbatueshëm në praktikë. Neni 9 i ligjit parashikon Komisionin e Vizionimit, i cili duhet të japë një mendim për çdo prodhim kinematografik. Por që nga miratimi i ligjit në vitet '97-98 nuk ka funksionuar kurrë... nuk është formuar, që sikurse e përcakton ligji duhet të formohet me një grup kineastësh.

EV: Pse nuk është formuar?

EK: Nuk është formuar sepse gama e prodhimeve është kaq e madhe sa ata nuk e bëjnë dot. Unë mendoj se për rastin që po flasim, pra për filmat e ish-Kinostudios, që disa prej tyre janë problematikë me të kaluarën, kjo gjë mund të funksiononte... duke pasur parasysh se aty ne do të çonim vetëm një kampion filmash, pra vetëm ata që ne mendojmë se kanë problem. "Ore na jepni një mendim për këtë film, ta shfaqim apo mos ta shfaqim?" Kjo pyetje ngrihet pasi disa filma janë edhe për të mos u shfaqur fare dhe për këtë duhet një mendim i profesionistëve, pra mendim i specializuar, gjë që ligji e ka parashikuar.

EV: Jozyrtarisht nga QKK-ja justifikohen se vizionimi nuk

kryhet për shkak të mungesës në burime ekonomike dhe njerëzore, dhe se vizionimin në këtë rast pse mos ta bëjë AMA?

EK: Jo! Është e gabuar diçka e tillë, pasi AMA është një strukturë vetëm monitoruese dhe jo vlerësuese. Ajo është përgjegjëse vetëm për transmetimin. Sigurisht edhe e përmbajtjes por konform ligjit që e formëson punën e Autoritetit. Nuk mund t’ia ngarkosh edhe këtë gjë AMA-s, pasi gjithçka është e parashikuar në Ligjin për Kinemanë. Komisioni i Vizionimit funksionon edhe në vende të tjera të botës. Edhe këtu mendoj se Komisioni mund të ngrihej me vullnet të madh... Të gjendej mundësia, sigurisht në bashkëpunim me kineastët, për të ngritur një projekt me një fond të vogël, që përpara çdo filmi të mundësohej një shpjegim ndërgjegjësues prej disa sekondash dhe më pas të tjera titra që të rrinin të shfaqura përgjatë filmit. Kjo për të paralajmëruar apo sinjalizuar kontekstin që ka ai film.

EV: U përmend gjithashtu rasti çek, ku zhvillohet enkas një festival që i shfaq këto filma...

EK: Dakord, le ta bëjmë një festival nostalgjie, pse jo ... Por jo “*free-to-air*”. Me aq sa kam parë unë, në asnjë vend të Lindjes nuk jepen në këtë lloj masiviteti filmat e periudhës së komunizmit. Ok, kjo lidhet edhe me faktin se jemi vend i vogël, nuk prodhojmë sa duhet, dhe kemi një numër të lartë operatorësh në raport me popullatën, çka nxit nevojën për mbushjen e transmetimit. Në këto kushte atëherë... do t’i japim?! Dakord, i japim, fundja-fundit nuk i censurojmë dot, por hajde bëjmë një politikë filtrash, në mënyrë që t’u japim dinjitet edhe atyre që kanë vuajtur, edhe atyre që kërkojnë të ushqejnë nostalgjinë. Sepse nuk i kushton asgjë askujt, të jetë një titër gjatë gjithë kohës apo një shpjegim përpara filmit.

EV: A mos është kjo kosto shtesë? Kush mund ta marrë përsipër këtë gjë që propozoni ju?

EK: Absolutisht nuk kushton gjë. Mund ta marrë përsipër vetë QKK-ja, mund të gjendet bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile. Normalisht që mund të bëhet.

EV: Po kodi aktual i transmetimit, çfarë parashikon?

EK: Për përmbajtjen, kodi kërkon tre kategori: pullën e kuqe, pullën e verdhë dhe atë jeshile. Për filmat e kohës së komunizmit, nuk respektohet, kjo sepse nuk ka një mendim të specializuar për ta. Për filmat e huaj është disi më e lehtë, pasi ata vijnë së bashku me një shpjegim dhe vlerësim, konform disa standardeve ndërkombëtare.

EV: Në Shqipëri nuk ka një sistem kategorizimi të tillë?

EK: Jo, për filmat e huaj ne e marrim të gatshëm nga jashtë.

EV: Pas debatit të vjetshëm, a pati ndonjë reagim, ndonjë ankesë?

EK: Jo, fare! Përveç reagimeve negative, në thelb, duke kundërshtuar nismën... duke u bombarduar në një lloj sensi, pa kuptim, pa debatuar siç duhet, nuk pati një reagim, as institucional...

EV: Si u ndjetë ju nga kjo gjendje?

EK: Rëndë shumë. Zhgënjyese! Madje mora edhe një lloj kritike të përgjithshme... “Ç’ të duhet ty kjo punë, pse merresh me këtë çështje”. Ka një lloj perceptimi sikur duan të ruajnë statukuonë, sikur kjo gjë u sjell probleme...

EV: Kush do të ishte zgjidhja më e mirë sipas jush?

EK: Ngritja e Komisionit të Vizionimit dhe më pas shqyrtimi rast

pas rasti. Sepse nga ajo gamë prej më shumë se 250 filmash, rreth 50–60 prej tyre janë krejt të transmetueshëm, por gjysma janë tejet problematikë. Le të fillojmë me këta si fillim. Transmetimi i këtyre filmave është aq barbar dhe i frikshëm, sepse shpesh jepen filma që vetë diktatura i ka censuruar, apo kinoditare. Vetë diktatura i ka ndaluar sepse propaganda e tyre ka qenë lustër fare, dhe këta i marrin e i japin sepse janë pjesë e listës. Nëse do më pyesje për zgjidhje me ide personale, unë jam kundër transmetimit të tyre në platformat televizive, pra për mua ata të mos jepeshin fare. Ndërkohë të krijohet një platformë *online*, një muze *online*... QKK-ja mund t'i hedhë, për shembull, në një kanal në "YouTube", pse jo mund ta bëjë edhe fitimprurëse këtë gjë. *Online* pastaj, për audiencën, do jetë thjesht çështje dëshire.

EV: Çfarë mund të thoni për cilësinë artistike të këtyre filmave?

EK: Më duket një hipokrizi e madhe. Sepse kjo gjeneratë e artë aktorësh, filmat e të cilëve nuk duhet të ndalohen për t'u parë, është keqpërdorur dhe fyer në mënyrë çnjerëzore nga diktatura. Unë mendoj se duke i shfaqur këta filma sërish, ne i fyejmë edhe njëherë këta aktorë. Ata janë keqpërdorur për të bërë propagandë, nga një regjim që ka shkelur liritë dhe të drejtat e njeriut, ka kryer krime. Pra kjo propagandë i ka shërbyer kësaj makine kriminale dhe kjo do i skuqte faqen asaj gjenerate. Procesi i filtrave apo i ndalimit të këtyre filmave them se do ishte një zgjidhje dinjitoze edhe për ta.

4) Intervistë me **AGIM POÇARIN**, drejtor programacioni në “DigitAlb”, më 22 shkurt 2018, Tiranë.

EV: Sa e vështirë është të prodhosh një film sot?

AP: Nëse flasim për filma të arrirë, financiarisht është shumë e vështirë, pasi buxhetet janë të pamjaftueshme. Flas financiarisht, sepse artistikisht ka forca sa të duash. Kemi të rinj dhe të reja që kanë studiuar jashtë dhe që kthehen. Ka shenja të mira. Për shembull, filmi i fundit i Gent Koçit, “*Dita zë fill*” është përzgjedhur për në Çmimet Oskar dhe është një film i mirë. Për mua pak therrës, por i mirë. Kështu shenjat janë pozitive, çështja shtrohet për çështjen financiare. Në këtë pjesë, ne si “DigitAlb” kemi qenë prezent në shumë filma që janë prodhuar pas viteve 90, si bashkëproducentë, si sponsorizim apo si diçka që mund t’i vlejë produktit. Kuptohet me shifra që nuk janë të larta, por jam i mendimit se po të bënin të gjitha mediet këtë punë që bën “DigitAlb-i”, jam i sigurt se prodhimi të paktën do të ishte më i madh.

EV: Ku e kanë problemin buxhetet?

AP: Problemi është te efektet speciale, sidomos kur flasim për filmat historikë. Nëse themi se “*Skënderbeu*” mbetet një nga filmat me më tepër përfshirje, projekti më i madh i realizuar, dhe nga ana tjetër ende nuk kemi një prodhim tjetër historik të këtij niveli, kuptojmë se buxhetet këtu e kanë problemin, te gjetja e vendeve dhe e efekteve speciale.

EV: Si mendoni, në debatin e vitit të kaluar në lidhje me transmetimin ose mostransmetimin e filmave të ish-Kinostudios, u tha se “nëse do kishte prodhim më të madh pas viteve 90, publiku do të ngjitej më tepër me to sesa me filmat e komunizmit”...

AP: Për mua nuk është ky problemi. Këtu një përqindje e popullsisë është ende e asaj periudhe, pra që e ka jetuar atë kohë. Dhe ajo lloj nostalgjie apo dëshire për ta kujtuar jetën e kaluar, ndoshta i mban afër me këtë lloj arti. Goca ime, për shembull, që është 16-vjeçe dhe që i them “shihë këtë, babi”... nuk ka fare interes. Mbase ky brezi i ri, kur të arrijë moshën tonë, do ta injorojë edhe më shumë atë kohë.

EV: Po në lidhje me debatin që u hap edhe vitin që shkoi... Si e shihni?

AP: Ne në “DigitAlb” kemi një kanal që quhet “T”. Ky kanal ka qenë ide e drejtorit Dritan Hoxha dhe imja. Pas ndarjes nga jeta të Tanit, ne na lindi si detyrim që të krijonim diçka për nder të tij, prandaj dhe kanali ka emrin “T” si Tani. Që në fillim, kur u prezantua ky kanal, ideja ishte që t’u vinte në ndihmë talenteve të reja. “Kush ka filma të shkurtër, dokumentarë, le të vijë, t’i transmetojmë”. I gjithë arti shqiptar që ekziston sot, koncerte të ndryshme, teatro të ndryshme... për shembull, ne transmetojmë edhe pjesë teatri, pavarësisht se teatri nuk është një zhanër televiziv. Kemi rënë dakord me aktorë dhe regjisorë të teatrit për të bërë të mundur transmetimin e tyre.

EV: Po për filmat?

AP: Jemi munduar që të hyjmë në bashkëpunim, ose u kemi blerë të drejtat e transmetimit, sepse ka disa lloje të drejtash. Në rastet kur ti hyn si bashkëproducent, atëherë ke dhe të drejtën e transmetimit për dy-tri vite. Ideja tjetër për kanalin “T” ishte që edhe ajo arkivë prodhimesh që ka qenë përpara viteve 90, të ishte pjesë e transmetimit. Në vitet e para kur u hap kanali, ne kemi pasur një tabelë që e nxirrnim përpara filmit, ku shpjegonim se “këta filma apo dokumentarë janë të periudhës së komunizmit. Ne i

transmetojmë të plotë për të mos fyer apo cenuar regjisorët dhe aktorët”.

EV: Ka pasur probleme gjatë transmetimit të këtyre materialeve?

AP: Po, ka pasur, për shembull, kur është transmetuar një dokumentar i vdekjes së Enver Hoxhës... kam pasur shumë telefonata, shumë presione, “jo, pse e transmetove se dal dhe unë aty”, gjëra të kësaj natyre. Megjithatë, tabelën shoqëruese ne e mbajtëm për rreth dy vite. Më pas krijuam përshtypjen se ky proces transmetimi u kuptua dhe e hoqëm.

EV: Ky ishte një vendim që e morët ju si redaksi apo si të thuash paketë digjitale?

AP: Unë jam i ndjeshëm karshi kësaj periudhe sepse e kam jetuar atë kohë dhe e di se çfarë është diktatura... Sepse po të jetë për mendimin tim personal, mund të them se ata nuk kanë asnjë vlerë, pavarësisht se unë e dua filmin, them se do të vijë një moment që nuk do të transmetohen më. Por si drejtor programacioni, flas nga kërkesat e shumta që ka, pra prej faktit se është audiencia që e kërkon. Për shembull, kemi pasur kërkesa me imejle dhe me mesazhe, “ej, pse s’e jepni më atë filmin”. Kjo tregon që njerëzit i duan akoma. Nuk mund të gjykoj, i shohin se kanë nostalgji, se kanë kërshëri, apo i shohin se brumosen me këtë punë. Saktësoj se në misionin tim nuk kam dashur kurrë të brumos, por thjesht të përcjell. Ka pasur raste që i kemi dhënë edhe për mbushje të kanalit, por edhe për të treguar se ky art ka qenë... Por ndërkohë kjo është dilema, edhe pse i dinë përmendësh, prapë ka raste që kur nuk i transmetojmë, vijnë imejle.

EV: Në lidhje me debatin, u fol shumë për ndërhyrjen, filtrat dhe procesin që duhej aplikuar për këtë prodhim. Ju si e gjykoni,

kush duhet ta kryejë këtë proces, QKK-ja? AMA? Operatorët? Duhet një bashkëpunim i gjerë apo duhet ndërhyrë me ligj?

AP: Unë gjykoj se për filtra, nëse do t'i vësh, asnjë nga ata filma nuk shpëton. Kjo për arsyet politike...

EV: Po thoni se të gjithë filmat janë si të thuash “të ngjyer” me propagandë?

AP: Po, janë ngjyer të gjithë. Nuk e di, pak filma mund të jenë që shpëtojnë. Për arsye cilësore dhe artistike, në fakt, ne e bëjmë dhe vetë një lloj filtri. Ka shumë filma të viteve 1960–65 që ne nuk i transmetojmë. Mund të kemi transmetuar edhe ndonjë që për atë kohë janë censuruar, por janë dhënë për të kuptuar qartë se përse ka ndodhur kjo gjë... dhe del që atë e kanë censuruar për një gjë banale. Por dua të them se aktualisht, përveç filtrit që mund të bëjë QKK-ja, bëhet edhe filtri nga vetë ne. Për shembull te kontrata aktuale, mos gaboj, janë rreth 180 filma...

EV: Kontratat janë të përvitshme?

AP: Po, po, vit për vit rinovohen.

EV: Çmimi ka ndryshuar apo ka qenë i njëjtë gjithmonë?

AP: Nuk është se ka qenë gjithmonë njësoj. Një herë kemi paguar më shumë, një herë më pak. Ka ndryshuar në bazë të tarifave që janë vendosur nga grupet që i administrojnë të drejtat. Por ndërkohë duhet ta them se ne, si të thuash, edhe kemi investuar në prodhimet e ish-Kinostudios. Kemi ndihmuar në një pjesë të arkivës, disi edhe financiarisht. Për shembull, te filmi “Skënderbeu” kemi kontribuar që ai të rinovohej, dhe janë shumë të shtrenjta proceset për t’u kthyer në “*high-definition*” (HD)... Sepse ka problem sot, pasi ne transmetojmë në HD dhe këta filma dalin përgjithësisht me cilësi të dobët.

EV: Si ndiheni ju si operator?... Duke qenë se gjysmat e filmave gjenden edhe online, pra piratohen.

AP: Ky është problem tjetër pastaj... sepse ka edhe raste ku televizionet lidhin kontratë për 10 filma dhe në fund i japin të gjithë. Nga kjo, “DigitAlb”, si operatori më i madh në treg për sa i përket transmetimit me pagesë, goditet nga të gjitha anët. Për të qenë në rregull, ne gjithmonë lidhim kontrata dhe i depozitojmë në AMA. Ndërkohë, me sa di unë, në fund shoqatat e autorëve çdo vit ndajnë dhe shpërblimet që u takon. Me sa na kanë thënë, “DigitAlb” është ndër ata që kontribuon më tepër.

EV: Kastriot Dervishi vitin e kaluar përpiloi një listë me 82 filma që sipas tij nuk duheshin transmetuar. Ndërkohë sipas një hulumtimi të thjeshtë vetëm në “YouTube”, këta filma kishin gjeneruar 6 milionë shikime. A i dëmton operatorët kjo situatë?

AP: Sigurisht. Nuk diskutohet që është problem. Televizioni sot ka marrë peshë tjetër, tashmë jemi në kohën kur audiencia kërkon ta konsumojë produktin atëherë kur do vetë. Prandaj edhe “YouTube” është aty ku është. Nuk po them se televizioni është në krizë, por këto platformat *online* bëjnë që gjërat më të mira të konsumohen në rrjet. Por duhet kuptuar diçka që në këtë drejtim, dëmi në fund të fundit nuk është direkt, është indirekt, sepse ne, për shembull, nuk është se ua kemi blerë të drejtat këtyre filmave në mënyrë ekskluzive.

EV: Ka raste që pirateria bëhet duke regjistruar përmbajtjen përmes kanaleve digjitale, për shembull duke regjistruar kanal tuaj e më pas duke e hedhur atë në një kanal të zakonshëm në “YouTube”. Si keni vepruar për këto raste?

AP: Problemi për mua është i tatimorëve, në kuptimin se ata duhet të gjëmojnë sidomos ata që vjedhin tërësisht përmbajtjen, pra jo vetëm një film të një kanali. Tashmë të ndodh që të marrin krejt transmetimin, përmes disa pajisjeve apo dekoderëve pirat.

EV: Për t’iu rikthyer temës së filmave...

AP: Për t’iu rikthyer temës, për mua është një ide që qëndron dhe bën shumë mirë që hapet për diskutim. Në kanalin “T”, për shembull, ndër programet më të mira na kanë rezultuar dokumentarët e periudhës antikomuniste, pra ata për të përndjekurit. Cikli i realizuar nga Fabian Kati ka qenë mjaft i suksesshëm, një dokumentar me Spartak Ngjelën, “*Të zhdukurit*” nga Esat Musliu, dokumentar tjetër nga Saimir Kumbaro... Me këta, si të thuash, përveç filmave të asaj periudhe kemi dhënë edhe anën tjetër. Edhe nga vetë audienca kanë rezultuar të suksesshme. Domethënë unë jam i hapur për këtë diskutim.

EV: Pra në lidhje me debatin, nëse do të ngrihej një frymë e përbashkët, për shembull nga vetë QKK-ja, që këta filma të mos transmetoheshin më... Ju si do të vepronit, do të ishit dakord?

AP: Padyshim që po.

5) Intervistë me **ROZETA FERRIN**, drejtoreshë e programacionit në RTSH, më 13 mars 2018, Tiranë.

EV: Vitin e kaluar pati debat rreth transmetimit ose jo të filmave të paraviteve 90. Ju keni qenë aktore dhe nga ana tjetër jeni drejtoreshë programacioni në RTSH. Si e gjykoni debatin në tërësi? Pati mjaft qëndrime të ndryshme, qoftë edhe ekstreme..

RF: Në bindjen time, mendoj se e gjitha duhej të niste që me fillimin, kur ka qenë dhe hapi i parë i transmetimit të filmave të ish- Kinostudios “Shqipëria e Re” (viti 2007–08), kur me kërkesë të televizioneve, QKK-ja dhe AQSHF-ja nënshkruan një marrëveshje dhe bënë një kontratë për transmetimin e një sërë titujve pjesë të një liste të përpiluar nga teknikienët e AQSHF-së dhe QKK-së. Absolutisht nuk mendoj se në partencë [nisje], ka pasur ide apo qëllime të paracaktuara se çfarë do të provokojë, se si do të ndikojë. Madje është diskutuar që përpara çdo filmi të mundësohej një si lloj prezantimi apo pasaporte “kush ishte autori, regjisori, skenaristi, kush ishin aktorët”, sepse atëherë ishte e vështirë edhe për të bërë fotografi, s’ka pasur shumë gjëra nga prapaskena. Në këtë mënyrë do të mund të tregohet se “ky ekip e ka bërë këtë film, kanë punuar në të tilla kushte”, dhe kështu, që në fillim prapaskena ta tregon situatën me probleme dhe vështirësi. Pastaj, në bindjen time të thellë, çdo qytetar që ka një ekran përpara, mendoj se është në gjendje që ta bëjë diferencën, ku ndahet dhe ku bashkohet me atë çka konsumon, sepse njeriu reflekton...

EV: Aktualisht në RTVSH vazhdon të transmetohet e njëjta paketë filmash, pra ajo e fillimit, apo ka pasur ndryshime?

RF: Titujt lëvizin për shkak se kanë dhe një kosto. RTSH-ja s’i merr falas ata filma. Kjo më pas u përket titullarëve të cilët i negociojnë dhe i përcaktojnë. Personalisht kam një ndjeshmëri që nuk rri dot pa e shprehur, ose edhe pa e fshehur, se edhe mamaja ime, që është 80 vjeçe, di të bëjë dallimin. Këtu flas për atë popullsi që është e formuar, se sigurisht çdo popullsi ka edhe një kategori më vulnerabel.

EV: A ka vetë RTSH-ja një lloj filtri, pasi e merr paketën e gatshme?

RF: Përpiqemi të bëjmë këtë seleksionim, të vëmë (në transmetim) ata filma që janë komedi dhe pa të keq, që të përdorim ndonjë film

tematik sikurse është “Skënderbeu” apo filma të tjerë për fëmijë, komedi. Duhet pasur parasysh se shumica e këtyre filmave janë bërë me zor, sepse skenarët kanë qenë të filtruar dhe të kontrolluar. Mos harrojmë sloganin që sistemi kishte: “artistët janë ndihmës të Partisë në edukimin komunist të masave”, dhe nga kjo nuk dilje dot. Sigurisht ka pasur tendenca asokohe, por nuk ishte aq e kollajshme. Në një nga filmat që kam luajtur unë, një pjesë njerëzore mes lidhjes së personazheve u hoq sepse u gjykua se shoqëria nuk ishte ende gati.

EV: Në gjykimin tuaj, a është gati, a është e aftë shoqëria shqiptare që t’i marrë këta filma dhe t’i mirëseleksionojë, duke e bërë paketën, e cila përcillet aktualisht, objektivisht jashtë propagandës dhe realisht drejt artistikes dhe vlerës filmike?

RF: Mund të flas të paktën për atë çfarë bëjmë ne, këtu ku jam... kryesisht komedi, janë dhe disa filma, të themi, ku tematika është e fortë, sepse është sociale. Ata janë pjesë e transmetimeve. Ama prej verës 2017, ne kemi një kanal të dedikuar, që është kanali “Shqip”, që pavarësisht kapacitetit aktual që ka, të shtrirjes (disi të reduktuar, çështje teknike) megjithatë është 24 orë në 24, dhe ai do i rreshtojë të gjithë (filmat). Është konsum televizioni!

EV: Pra në kanalën “Shqip” është e gjithë paketa që ofrohet nga QKK-ja?

RF: Është e gjithë paketa, që në bindjen time dhe në informacionin që kam, ka një sitë nga vetë QKK-ja.

EV: Duke qenë se jeni njëkohësisht edhe artiste, si e gjykoni, kush mendoni se duhet ta bënte diskutimin vitin e kaluar, sepse pati edhe një lloj paragjykimi ndaj atyre që e nisën debatin...

RF: E di pse ndodhi kjo? Edhe unë... përtej profesionit tim, punës që bëj, lidhjes dhe afeksionit për të gjithë ata njerëz që bënë kinematografinë... ta lëmë mënjane këtë. Ajo çka unë personalisht paragjykova, atë që e nisi... Agroni (Tufa). Kam një raport shumë të mirë me të, sepse përfaqëson dhe një institucion, dhe pikërisht pse përfaqëson një institucion ai duhej të ishte si në “back” të kësaj gjëse. Le të ishin mbledhur... ka specialistë, burra, gra, vajza dhe djem të mençur që të artikulojnë, kanë forcën e analizës dhe të gjykimit për të dalë në publik. Por ai atakoi direkt me pozicionin që kishte. Në opinionin tim si qytetare, kam bindjen se ish-të përndjekurit nuk i prek dhe aq shumë filmi sesa fakti se janë ende të parehabilituar dhe të privuar nga shumë të drejta. Shiko, unë i shoh filmat dhe qesh. Qesh nëna ime që është pjesë e asaj kulture, që është formuar dhe ka punuar në atë pjesë të kohës. Unë jam krejtësisht dakord që të ketë një filtër të gjërave...

EV: Një shënim në film për shembull...

RF: Nuk e di. Kur unë fillova punën këtu dhe nisa të transmetoja filmat shqiptarë, shumë pak i jepnin për hir të së vërtetës, sepse nuk ishte finalizuar një kontratë. Mendova që me një gazetar të bëja një si tip sfondi ose shpjegimi për filmin, të shkonim në Arkivin e Filmit dhe të gjenim materiale se çfarë ka ndodhur në sheshxhirim. Sekuenca kishte shumë pak për këtë pjesë. Për shembull ishte interesante po të nxirrnim se çfarë kishte hequr Anagnosti teksa xhironte filmin “Lulëkuqet mbi mure”. Sepse atëherë niseshe për një ekspeditë filmi për 1 muaj dhe rrije 3 muaj, sepse prishej koha, për shembull, dhe atëherë shteti për aq të paguante. Kështu që, nëse (debati) do të ngrihej në nivel profesionistësh dhe nuk do të ishte përballje “se ne ja ku jemi, çfarë ke bërë gjithë këto vite?” Prit se ke plot gjëra pa bërë pa të vish te kjo...

EV: Në debat, Erald Kapri i AMA-s, duke marrë shkas nga emisione, si për shembull, “Histori me zhurmues”, mbante qëndrimin se nga përmbajtja, sidomos kinoditaret, duhej të mos transmetoheshin ose të kishte kontekstualizim dhe shpjegim për çdo material...

RF: Mirë, atje ishte formati i konceptuar ashtu, ndërsa për sa i përket filmave, kjo është situata. Tani, unë kur shoh filmat e tim shoqi (Xhevdet Ferri)... për shembull, pashë së fundmi “*Hijet që mbetën pas*” (regji nga Esat Musliu) qesh, them me vete “o Zot, çfarë tmerrri”, që ahëre filmi bëri bujë. Unë qesh sot me ata, ama kam dhe një si gjë tjetër, kupton... është puna, talenti, mundi, është investim i asaj kohe, por jo në komoditet, në strapacim. Ka qenë tmerr, megjithatë ata filma janë bërë dhe disa prej tyre janë të mirë, sepse ne sot po prodhojmë, por janë aq pak sa na vjen turp. Unë jam dakord që “hajde të mbajmë një qëndrim”, apo “të ngrihet një forum i cili të vendosë disa shtylla”, por i gjithë ai produkt nuk mund të mohohet, sepse i bie që të bëjmë të njëjtën gjë sikurse ata bënë. Në vështrimin tim, ata që e kanë marrë përsipër këtë diskutim (ISKK) nuk duhet të kenë as agresivitet, as tendencë, sepse i prek të gjitha palët. Sepse përtej të gjitha... flas profesionalisht, si medie, përveç kontentit interesohemi edhe për minutazhin. Personalisht përpiqem që fasha orare të përkojë me përmbajtjen dhe që filmi të mos bëjë shumë propagandë.

EV: Si e bëni dallimin? Në gjykimin tuaj, kë përfshini te një film me shumë propagandë, qoftë edhe pa përmendur tituj konkretë...

RF: Filmat që flasin për kohën kur u krijua partia, për grupet që intervenonin, që u deklaruan armiq e të tjerë. Filma të tillë nuk kanë çfarë të japin më. Ata janë konsumuar, le të mbeten thjesht vepra dhe kaq. Filmi “*Vendimi*” (nga Kristaq Dhamo 1984, luan

edhe Xhevdet Ferri), për shembull, është një i tillë...

EV: Filmat ku del në pah roli i vigjilencës së Sigurimit, si ju duken, për shembull?

RF: Dizastër janë edhe ata. Është qesharake fare ta shikosh sot. Nëse do që të tallesh (me sistemin), vëre të tallesh. Sepse tingëllon naiv, kaq pa vlerë sa më s'ka. *"Fije që priten"* (regji nga Muharrem Fejzo, 1976) është një nga ata, për shembull. Se ç'janë edhe disa të tjerë që janë transmetuar edhe te ne pa e menduar mirë, siç është *"Gëzhoja e vjetër"* (regji e Saimir Kumbaros, 1980). Personalisht, për shkak të dijes, veçoj disa filma nga skenari, për shkak të skenaristit tejet të politizuar, agresiv. Por të gjithë nuk i dinë, nuk i njohin.

EV: Ju ngaqë keni qenë vetë aktore, plus dhe e periudhës...

RF: Po, mbase disa më të reja se unë nuk i dinë. Por ne kemi pasur dhe rrethin e ngushtë të shoqërisë, të të njohurve (në Kinostudio). Por më vjen shumë gjynah që filmat e atyre që kanë interpretuar dhe kanë dhënë shpirtin, të mos jepen. Ne jemi përpjekur t'i shmangim ata lloj filmash që mund të konsiderohen flagrantë. Për filmat më pas, përpara rreth një muaji (shkurt ose janar) ne (të redaksisë) kemi konfirmuar transmetimin e disa titujve me shoqatën që mbron të drejtat e autorëve.

EV: Në dijeninë tuaj, sa mund të jetë prodhimi në total, i pasviteve 90, sepse dimë që ka rreth 270 filma të ish-Kinostudios, por a i është afruar këtij numri prodhimitaria e pasviteve 90?

RF: Absolutisht jo. Me gjithë seleksionimin që ka bërë QKK-ja, atëherë bëheshin 14 filma në vit, dhe nëse nuk realizoje dot planin, të merrte lumi. Në kanalën "T" ("DigitAlb") kemi parë filma që as e dinim se ekzistonin. Të dobët. Filma të cilët kanë qenë nga ato që

bëheshin për të mbushur planin, sepse futeshe në burg po mos ta realizoje. Kështu që kemi parë tituj, filma koti aq sa thoshim: “O, pa shiko njëherë te informacionet mos e kanë vënë vitin” ose “këtë film e ka bërë filani”. Pra ka edhe të tillë kontingjentë të titujve, por harroje që qaset ajo shifër. Unë s’e di a janë apo jo 60 filma. Janë shumë pak, sepse nuk ka buxhet.

EV: Filma pati bërë edhe RTSH-ja. Në gjykimin tuaj a ishin me të njëjtin nivel propagande si ata të Kinostudios?

RF: Mendoj se në thelb, po, por televizioni publik ka pasur energji krijuese dhe personalitete shumë të talentuara, shumë të zotë, shumë të mençur, që i janë shmangur me sa mundën. Sigurisht, në ata filma mund të shohësh edhe portretin e Enverit apo politikën e kohës, por që filmi (i RTSH-së) ka qenë më i lehtë (nga propaganda), më i çliruar se sa i Kinostudios.

Por RTSH-ja ka një problem tjetër. Sado që është shpërbërë dhe janë marrë disa nga materialet, një pjesë e mirë e arkivës është ende e pahedhur (në sistem), e padigitalizuar, dhe sot ne nuk mund ta transmetojmë dot.

EV: Pse?

RF: Sepse janë në një format të pakonvertuar për t’u transmetuar. Ndërkohë, siç ndodh rëndom, filma të prodhimit të RTSH-së i transmetojnë platforma me pagesë dhe RTSH-ja nuk i ka. Autorët, duket, i kanë marrë filmat nga burime të tjera dhe ua kanë dhënë.

EV: Po për sa i përket ligjit? Nuk është e qartë: filmat i administron QKK-ja, por edhe gjatë debatit të vjetshëm u nxor në pah që disa regjisorë përfitonin të ardhura... Saimir Kumburo, për shembull, e tha hapur se përfitonte një shumë...

RF: Është një përqindje. Ajo që Saimir Kumbaro ka thënë se merr, është kjo: transmetimet që ne u bëjmë titujve të cilët i mbron shoqata e të drejtave të autorëve, kësaj të fundit i është deleguar... Për shembull, e zëmë se filmat e mi ia jap shoqatës dhe më pas nga monitorimet e transmetimit ajo lëvron përqindjet. Por edhe përqindjet nuk i kanë korrekte...

EV: Pra monitorimin e bën vetë shoqata?

RF: Po, ata bëjnë monitorimin dhe në fund të vitit sjellin titujt e transmetuar. Ne i verifikojmë, i konfirmojmë dhe them se vetëm nga RTSH-ja marrin rregullisht pagesa, duke qenë se është institucion shtetëror.

EV: Sa mund të shkojë shuma?

RF: Nuk e di, ato kontrata bëhen dhe mbyllen nga Drejtoria e Përgjithshme, nga juristët, dhe s'më ka interesuar ndonjëherë.

EV: Fondi i shpenzuar për filmat, shkon më tepër për filmat e ish-Kinostudios apo për ata të pasviteve 90?

RF: Nuk mund ta them, sepse varet nga lista e titujve që seleksionon. Për shembull, te kontrata që rifilloi në janar, janë reduktuar disa tituj, sepse ishin disa që nuk ishin të cilësisë së mirë, nuk u kishim kopje të mira. Ishin pjesë e paketës, paguhej për to, por nuk transmetoheshin. Gjëra të kësaj natyre, por që janë teknike dhe nuk më kanë interesuar shumë.

EV: Pra lidhet edhe me cilësinë...

RF: Po, sepse ka regjisorë që janë të interesuar... Piro Milkani, për shembull, pasi ka prodhime me cilësi të filmave të tij, vjen, i

sjell dhe thotë: “Këta janë 10 tituj të filmave të mi që janë kopje e mirë dhe, ju lutem, mund t’i... Dhe ne i shkarkojmë dhe fshijmë ata që janë cilësi e keqe. Të njëjtën gjë bën Vladimir Prifti, Saimir Kumburo. Domethënë këta janë ata si të thuash më skrupulozët dhe që e ndjejnë më shumë, që interesohen për punët e tyre, që i dërgojnë filmat në studio të ndryshme.

EV: Si është për punën e transmetimit, mund të japësh një film sa herë të duash?

RF: Në kontratat me QKK-në s’është se detyrohesh sa herë transmetohet, por s’mund ta bësh blözë apo baltë me një film. Ne, për shembull, kemi një sistem programacioni që, e zëmë, kur është transmetuar filmi “Çifti i lumtur” dhe na del në tetor apo në gusht, themi “ok, është koha që ta rikthejmë”. Nga pikëpamja profesionale, një herë në tre muaj të paktën. Unë punoj me këtë standard.

Ndërsa në kontratat me të tretët, pra me prodhuesit, për shembull, janë tre-katër tituj të Vladimir Priftit, siç është “Dasma e Sakos” apo dhe të tjerë. Ai e ka kontratën 3-vjeçare me 3 transmetime në vit. Ama ne e kemi ndarë që për shembull një e jep RTSH-ja dhe dy le t’i kalojnë “Shqip”-it. Është disi keq sepse transmeton 24 orë filma dhe dokumentarë dhe na ka dalë që kemi probleme me cilësinë e dobët teknike, janë të patransmetueshëm. Por është e vështirë për programacionin e çdo medieje që të mos përfshijë filma shqiptarë. Personalisht, nëse do të më lejonin do të zgjidhja 5 ditë të javës për të dhënë nga një film shqiptar. Do ua gjeja orarin. Filmat e Khanfize Kekos janë pa të keq apo disa komedi si “Zonja nga fshati”, “Zonja nga qyteti”, se ç’janë ca alegro. Pse të mos jepen këta? Unë jam partizane e kësaj ideje, pra që të jepen. Sita, dhe një shënim apo një titër, apo dikush më përpara që ta thotë (kontekstin) ... le të jetë. Pra të gjendet mënyra e transmetimit, por që të jepen.

6) Bisedë me **ESAT MUSLIUN**, regjisor, kryetar i Forumit për Mbrojtjen e Autorëve të Audiovizualit (FMAA), më 7 prill 2018, Tiranë.

EV: Si ju duk debati që u hap vitin e kaluar për mostransmetimin ose, më saktë, ndryshimin e mënyrës së transmetimit të filmave të ish-Kinostudios?

EM: Problemi që u ngrit nga një grup i ish-të përndjekurve politikë, me Agron Tufën, kreun e ISKK, dhe nga një kastë, që pothuajse i përkasin kësaj kategorie, të cilët e ndejnë veten të fyer dhe të provokuar dhe të diskriminuar nga arti i periudhës së socializmit në Shqipëri... u ngritën dhe kërkuan me një lloj brutalizmi që e gjithë krijimtaria filmike e viteve para 90-ës të hiqet nga qarkullimi fare, dhe nëse mbetet ndonjë, të jetë i shoqëruar me komente, me titra, ku ta di unë. Për mendimin tim janë tepër fyese dhe skandaloze. E para, kjo kërkesë e tyre u interpretua nga ne kineastët dhe po kështu edhe nga ana ime dhe e artistëve të tjerë, si një kërkesë e karakterit fashist. Hitleri, Gëbelsi i famshëm (Joseph Goebbels, ministri i Propagandës në regjimin nazist) bëri një grusht kundër letërsisë botërore dhe dihen pamjet e famshme ku digjen veprat e gjithë shkrimtarëve përparimtarë botërorë. Ai i dogji dhe me to u vendos që çdo gjë përparimtare do të asgjësohej, dhe i asgjësoi. Mua, veprimi i vitit që shkoi më kujtoi pikërisht një gjë të tillë.

EV: Mos kjo përshtypje vjen nga fakti se shoqëria shqiptare nuk është shumë e edukuar për debat, diskutim apo përplasje idesh në kuptimin e shëndoshë të fjalës, dhe prandaj shpesh përfundohet në ekstremizma ...

EM: Unë personalisht e quaj një qëndrim naziskin, gjithë këtë goditje që u përgatit për filmin shqiptar. Filmin shqiptar

e administroj unë si vepër, sepse nëpërmjet meje qarkullon, unë mbledh të drejtën e autorit, dhe në tërësi për mënyrën se si qarkullon, jam unë ai që e ndjek. Kjo mua më kujton periudhat më të zeza të njerëzimit. Goditja kundër filmit pasonte goditjen kundër letërsisë. Pra të zhduket edhe Kadareja, edhe Agolli, të gjithë, dhe në fund të mbeteshim në kuotën zero siç filloi ekonomia shqiptare pas ndryshimeve, që u zerua dhe u shkatërrua çdo gjë e trashëguar. Sepse kështu u ngrit ideja e çmendur e çekut të bardhë. Kjo ishte katastrofa e ekonomisë shqiptare dhe këta kërkojnë një katastrofë edhe të artit shqiptar. Të godasësh artin në periudhën e sotme, ndërsa partitë komuniste janë të lira dhe kanë të drejtën e organizimit... janë 4 të tilla që marrin pjesë edhe në zgjedhje. Sot jetojmë në një shoqëri të ekonomisë së tregut dhe ligji që sundon është “kërkesë-oferta”. Nëse një mall mua nuk më pëlqen, nuk e blej! Ne kemi në televizion plot kanale, kemi telekomandën. E çoj ku të dua unë! Shoh filmat shqiptarë... s’me pëlqejnë filmat shqiptarë?! E çoj tjetërkund. Në Kushtetutë është i ndaluar vetëm propagandimi nazist, fashist dhe racist. Propaganda komuniste, fetare, gjithçka tjetër nuk është e ndaluar.

EV: Mund të flasim edhe për mënyrën se si transmetohen...

EM: Shiko, çdo sistem ka ideologjinë e tij. Këta filma (të komunizmit) sigurisht që janë të ideologjizuar, ose në një mënyrë ose në një tjetër, nuk janë. S’ke ç’i thua fare filmit “Përrallë nga e kaluara”, se për shembull, e gjithë krijimtaria e Kadaresë ka ideologji brenda, por arti i tij është aq i fuqishëm saqë e hedh mënjanë atë. Ç’do t’i thuash Dhimitër Anagnostit për “Lulëkuqet mbi mure”?! Arti ka mjetet e veta që e shmang, nuk e vë parësore (ideologjinë), por sigurisht që ka pasur dhe regjisorë të nivelit të ulët të cilët kanë prodhuar filma tejet ideologjikë. Por duhet ta them se kjo vinte më shumë nga planifikimet e filmave artistikë që ishin të tematizuar nga Kinostudioja. Sidoqoftë kjo shpërndarje

nuk e pengonte artistin që edhe me propagandë të realizonte dhe shprehte artin në të atillë mënyrë saqë ti nuk e hedh dot poshtë.

EV: Mund të flasim disi më konkretisht, sa është prodhimtaria e asaj periudhe, si transmetohet sot?

EM: Në kohën e komunizmit u realizuan 250 filma artistikë. Nga këta, siç thashë, kërkesë-oferta, televizionet i marrin për të shfaqur në ekranet e tyre sipas dëshirës. Mund të zgjedhin 30, 40, 50 dhe përzgjedhja gjithmonë përcakton atë mall që është i dobët, pra e lë mënjanë. Pra koha bën gjykimin e vet, seleksionimin e vet. Ata filma që janë të dobët, që operatorët gjykojnë se nuk shihen më, nuk i përzgjedhin. Unë mund të them se në fillim (viti 2008) e kemi nisur shpërndarjen e plotë me “DigitAlb-in” me 250 filma, pastaj vetvetiu, me kalimin e kohës, shumë filma kanë rënë. Tani janë piketuar rreth 190 filma. Pra janë mbi 50 filma të cilët janë ndoshta më të ideologjizuarit, më me pak vlera artistike, sepse janë me propagandë më direkte...

EV: Do të thotë se vetë ju dhe operatorët keni ardhur në një gjendje seleksionimi?

EM: Jo! Ne nuk kemi ardhur gjëkund, kanë ardhur ata! Unë ku ta gjej t’u shes të gjithë filmat (qesh). Ai (operatori transmetues) thotë nuk më pëlqejnë këta se s’m’i sheh njeri dhe merr ata (190) sepse mes filmave fut reklamat dhe një film i bukur dhe më i mirë ka më tepër vëmendje dhe shet më tepër kohën televizive, mbledh më tepër reklama... Pra filmat e dobët i ka shmangur vetë tregu, koha, i ka spostuar. Kështu që për filmat artistikë, gjendja, kategorikisht, absolutisht, është ashtu siç duhet të jetë! Filmi artistik nuk ka fare nevojë për ndokënd që të dalë e të flasë, jo kështu, jo ashtu. Këto janë idiotizma dhe këto nuk i bën as një amator për fëmijët. Fëmijët, bile, dinë të zgjedhin më mirë, dinë edhe të të tallin po

të dalësh e të thuash se koha e Enver Hoxhës ishte kështu e ishte ashtu. Shoqëria, rinia e sotme ka një përgatitje të atillë intelektuale sa që nuk indoktrinohet dot, edhe po të duam. Na thotë, “ikni e pirdhuni (nxehet, bërtet) me gjithë këto muhabetet që po doni të na thoni”. Kjo është për sa i përket zgjedhjes së filmit artistik. Pra koha po bën seleksionimin e vet. Ka hequr mënjanë shumë filma që kanë qenë të ideologjizuar, por kanë pasur vlera të dobëta artistike dhe nuk ngjallin më interes.

EV: Po për dokumentarët?

EM: Për filmat dokumentarë puna është shumë më ndryshe. Filmi dokumentar është shumë më tepër i ideologjizuar, bile quhet propagandë e mirëfilltë. Sepse ke filma për kongreset, parakalimet e 1 Majit, filma për klasën punëtore, për diktatorin. Për këta filma unë kam qenë udhëheqës artistik i QKK-së. Asokohe ka qenë Xhevdet Ferri dhe më angazhoi që të marr filmat e dokumentarëve që të seleksionojmë, të heqim të gjithë ata që janë propagandë e mirëfilltë, sepse ke filma dokumentarë që kanë karakter folklorik apo historik, portrete apo biografi të Fan Nolit, Mjedës, Topullit e të gjithë, portrete që janë bërë me materiale që mbeten; filma etnografikë që flasin për vallet popullore, qytetet muzeale; filma që mbeten, që kanë vlera të historisë pasi shumë prej këtyre (vendeve) janë shkatërruar sepse ka mbirë betoni dhe s’gjenden më. Pra unë i kam seleksionuar. Nga rreth 1 mijë filma kemi lënë rreth 150–200 filma që mund të shfaqeshin dhe që shfaqen. Ky seleksionim në fakt, u përdor dhe nuk u përdor. Për shembull, duke qenë se të gjithë këta filma administroheshin nga AQSHF-ja, shumë televizione shkonin direkt atje, i blinin atje dhe i shfaqnin. Kjo fatkeqësi – shumë përpara e deri vitin e kaluar – na ka rezultuar me “Tring”-un: blinte dokumentarë me lopatë dhe i shfaqte prej orës 12 të natës deri në 7 të mëngjesit. Pra mbushte programin dhe mendonte se nuk i sheh njeri, por të përndjekurit i panë dhe

i bënë problem. Unë, personalisht, pasi i verifikova, ndenja dhe unë natën domethënë (qesh), u çova edhe një shkresë se në mënyrë kategorike do projektoni vetëm këta filma, dhe tanimë e respekton atë listë. Kështu që filmi dokumentar është i disiplinuar. Filmat kronikalë dhe dokumentarë që u shërbejnë televizioneve për të bërë analiza, krahasime apo dokumentarë të tjerë, kjo pastaj është në dorë të lirë të vetë televizioneve. Këto minuta apo materiale blihen nga Arkivi dhe janë të shtrenjta. Është 100 mijë lekë një minutë. Sa më i vjetër, aq më i shtrenjtë. Ka dhe 200 mijë lekë. Por për çdo kërkesë filmike atje ata paraqesin edhe argumentimin se për çfarë u nevojitet materiali, siç bëri dikur Pandi Laço me emisionin e tij televiziv, “*Histori me zhurmues*”.

EV: Aktualisht si është procedura e transmetimit të filmave?

EM: Administrimin fizik dhe juridik të filmave të prodhuar përpara vitit 1990... Arkivi i Filmit i mban në arkivë, por administrimin e tyre e bën QKK-ja me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me vendim të Kuvendit. Ne, si agjenci, nuk kemi të drejtë të lidhim kontrata me askënd, sepse ata (filmat) janë pronë shtetërore, prandaj dhe këtë punë e bën Qendra. Nga ky administrim, 30% e vlerës derdhet në arkën e Shtetit. Kusuri, 70%, ndahet pastaj midis 3 agjencive, ku dominon agjencia jonë “Forumi për Mbrojtjen e Autorit të Audiovizualit”, sepse mbron të drejtat e regjisorit, skenaristit dhe drejtorit të fotografisë. Kompozitorin e mbron agjencia tjetër, “Albautor”-i, dhe më tej një agjenci tjetër më e vogël “AKDIE”-ja mban dhe një përqindje të vogël, rreth 3%, për interpretuesit.

EV: Me aq informacione sa kemi mbledhur, ky sektor, pra i filmit shqiptar, është ndër më të rregulluarit, me kontrata me procedura, të paktën krahasuar me aktivitetin e përgjithshëm që kanë operatorët e transmetimit.

EM: Agjencia jonë funksionon shumë normalisht në gjithë këtë krahurë që është bërë. Ministria bëri disa reforma, nxori një ligj të ri për të drejtën e autorit, bëri dhe një rindërtim. Për shembull, tani të katërta agjencive që operojmë, na e kanë pezulluar të drejtën e mbajtjes apo tërheqjes së produktit ekonomik, të tarifave nga televizionet. Kontratat prapë i bën Qendra, por tarifën e tërheq një Sportel Unik (i Administrimit të të Drejtave të Autorit) i cili quhet SUADA. Unë jam skeptik në këtë pjesë, pasi ne si agjenci e kryenim punën shumë mirë. Për mua është viti i shtatë që punoj në këtë detyrë. Përpara meje ka qenë Piro Milkani. Edhe ai ka punuar shumë mirë në këtë detyrë, por pastaj ai pati probleme shëndetësore dhe Forumi bëri një zgjedhje tjetër. Unë po e drejtoj deri më tani. Mundet që nesër kolegët e mi të gjykojnë ndryshe punën dhe të zgjedhin dikë tjetër.

EV: Ju si e gjykoni, a do të ishte mirë që një lloj procesi “privatizimi” të ishte bërë edhe për filmat e ish-Kinostudios?

EM: Bota e ka bërë, por ne nuk kemi bërë. Personalisht kam bindjen që më mirë t’i administrojë shteti sesa të bëhet siç po bëhet me rastet e tjera, tipi koncesione apo lloje të tilla. Është përpjekur të bëhet një gjë e tillë, por më pas ne si kineastë kemi thënë “duam të qëndrojmë kështu siç jemi”, pra administrimin ta bëjë shteti, kontratat t’i bëjë ai, dhe ne të marrim vetëm një pjesë të përfitimit tonë, rreth 60 për qind të vlerës.

EV: Duke respektuar konfidencialitetin dhe duke parë këtë treg mediatik që kemi sot, sa është vlera e një kontrate apo përfitimi që mund të marrë një regjisor?

EM: Përfitimi varet nga numri i filmave që ka bërë një autor. Ka regjisorë që kanë bërë 16 apo 18 filma, të tjerë që kanë vetëm 3 filma artistikë. Ne nxjerrim vlerën e një filmi artistik dhe në bazë të kësaj i përcjellim çka i takon autorit.

EV: Domethënë kuotizohet?

EM: Shkon sipas vlerave numerike të prodhimit. Ne nuk marrim për bazë vlerën artistike për të shpërndarë shpërblimet. Një gjë e tillë bëhet vetëm kur bëhet një kontratë e veçantë dhe ai (operatori) për zgjedh vetëm 10 filma, sigurisht duke u nisur nga një opinion apo e dhënë tjetër në lidhje me cilësinë që ka, dhe ne më pas veprojmë ndryshe.

EV: Duke e lidhur me diskutimin, Saimir Kumburo ishte ai që doli hapur duke nxjerrë në pah se të ardhurat që artistët merrnin nga shfaqja e filmave nuk ishte aq e madhe sa perceptohet në opinionin publik...

EM: Duhet të dish që përfitimet që kanë regjisorët, sidomos në vendet postkomuniste... Sepse në ato kohë edhe ata nuk janë paguar, sepse e drejta e autorit ka ekzistuar si fillim vetëm si e drejtë morale, si e drejtë ekonomike, jo. Një gjë e tillë ndodhi vetëm kur u kalua në ekonominë e tregut. Tani, Saimiri dhe të tjerë marrin në raport me aq filma sa kanë krijuar. Ta them me shifra, nuk mundem, se sa para i takojnë, sepse kjo është diçka konfidenciale. Pra në raport me shpërblimet, ka më shumë peshë sasia sesa cilësia, sepse dua të jem i drejtë me të tjerët. Ka raste që operatorët apo përdoruesit siç u themi ne, sepse në gjuhën kinematografike operator është ai që mban kamerën, pra ka raste që një televizion do vetëm filmat e këtij apo atij.

EV: Pra operatorët e kanë të lirë të zgjedhin produktin që duan?

EM: Po! Është sipas kërkesë-ofertës. Përdoruesit, kanë të drejtë absolute që t'i zgjedhin ato filma, të cilat i shikojnë të arsyeshme ata. Mund të kenë (drejtor) dikë me vlera artistike që zgjedh sipas

shijeve artistike, por mund të ketë edhe ndonjë nallban që do filma vetëm me luftë apo vetëm për të mbushur kohën televizive. Këta i drejtohen Qendrës Kinematografike dhe më pas QKK komunikon me ne. Na thotë “ka ardhur filani, do të marrë këto filma”...

EV: Dhe deri vitin e kaluar procesi i vjeljes së tarifës, ishte përmes QKK-së, apo ishit ju si agjenci që...

EM: Jo, ne i marrim përmes kontratës së QKK, ku aty është e specifikuar. Ku 30% e vlerës... aq e kaq, dhe shënon vlerën, këto shkojnë dhe derdhen në arkën e QKK që shkon në Thesar. Pjesa tjetër, që përkon sipas llogarive që thamë shkon për FMAA dhe derdhet në numrin e llogarisë së saj. Kaq para shkon për numrin e llogarisë së Albautor dhe aq për AKDIE. Tani çdo agjenci bën luftën e saj për t'i tërhequr ato në mënyrë që t'u mbrojë të drejtat artistëve.

EV: Përpara viteve 90-të ka pasur prodhimtari të gjerë edhe Radiotelevizioni Shqiptar, për punën e transmetimeve, si janë marrëdhëniet krahasuar me ato të ish-Kinostudios?

EM: Është një problem që ne kemi ngritur dhe ende nuk ka marrë zgjidhje. Aq sa kemi ne regjisorë, skenaristë, drejtorë fotografie, pothuajse aq ka pasur edhe Radiotelevizioni që ka qenë një institucion shtetëror. Edhe Radiotelevizioni ka bërë filma, seriale, dokumentarë, ka edhe bashkëprodhime... të gjithë këta autorë të televizionit, të cilët një pjesë ka dalë në pension, një pjesë kanë vdekur, një pjesë kanë ikur jashtë... ka një ligj i cili... për tre vite, vepra, qoftë film artistik, qoftë dokumentar, film i animuar apo çfarëdolloj gjëje... vepra e tyre shfrytëzohet nga televizioni për tre vite pa asnjë të drejtë autori dhe pas tre vitesh duhet të fillojë të paguhet... sidomos tani ku Radiotelevizioni ka hapur shumë kanale dhe ku nuk ka se me çfarë ta mbushë transmetimin dhe zgjedh kryesisht arkivën. Ne kemi kryer një takim me juristët e

Radiotelevizionit në prani me Zyrën Shqiptare të Mbrojtjes së Autorit... që këta autorë dhe sidomos regjisorët e teatrit, veprat e të cilëve janë regjistruar dhe jepen në televizion... këta duhet të marrin të drejtën e autorit për këtë gjë dhe më kanë ardhur shumë prej tyre që të më kërkojnë mbrojtjen e të drejtës së tyre... kanë ardhur që nga Albert Minga, Mevlan Shanaj, Vladimir Prifti e plot të tjerë. Kjo punë na është thënë se do të zgjidhet... se si, as që e besojmë... sepse kjo duhej zgjidhur në moment.(nxehet) Mirëpo shteti ynë, që është mbi 70 për qind të ekonomisë, informal... dhe pirateria më e madhe pikërisht këtu te veprat e artit bëhet, sepse më ka qëlluar që edhe në gjyqe që kemi pasur, gjykatësit e kalojnë me nënqeshje “po mirë shumë bukur ka bërë që e ka shfaqur filmin, çfarë të keqe ka bërë që ta ka shfaqur, ti çfarë do?” kur i thua se do që të të paguajnë, të thonë “po mirë ai të ka bërë nder se të ka bërë reklamë, që ti të kesh emrin, namin e gjithë këto”... pra merret në mënyrë qesharake kjo punë, nëpërkëmbemi dhe nuk ka fare idenë e një malli që i është plaçkitur tjetrit, madje t’ia vjedhësh është fine, sepse kur e vjedh përpiqesh ta fshehësh, por t’ia grabisësh dhe nga ana tjetër të thuash që s’kam bërë gjë është kryekëput pirateri... Kjo punë është kaq e koklavitur... unë jam regjisor dhe merrem tani me një punë që mbase s’më shkon aspak për shtat, por që me këto pensione që na kanë lidhur me këtë kohë, më duhet me patjetër të bëj një punë që të plotësoj ekonominë time.

EV: Ju personalisht por edhe regjisorët tjerë, keni prodhimitari edhe të pasviteve 90-të, pse nuk mund t’i shohim këto filma më tepër në televizion, por shohim më shumë produktet e ish-Kinostudios?

EM: Sepse televizionit që do t’i shfaqë, do t’i duhet të paguajë... atij i bie më lirë të paguajë për të shfaqur ato lloj filmash të vjetër se sa këtë produkt më të ri. Është çështje kërkesë-oferte e tregut. Ata këtë kërkojnë dhe atë marrin. Tregu është shumë i cekët dhe nuk

e konsumon dot filmin e ri, pasi një film kushton shumë shtrenjtë, shuma që mund të shkojnë deri në 1 milionë euro. Edhe nëse arrihen kontrata për transmetimin, ato para, ato shpenzime, zor se i arrin dot në këtë treg. Por duhet thënë se ligji aktual i kinemasë ka një favor të madh dhe kjo është gjëja më e bukur dhe më e mirë që kemi, që shtëpitë filmike e xhirojnë filmin me subvencion të shtetit dhe më pas fitimi që bëhet nga distribuimi i filmit nuk i kthehet shtetit. Por tregu nuk është i përqendruar shumë këtu.

EV: Po në lidhje me lëvizjet që është thënë se po bëhen për një ligj të ri të kinemasë, çfarë mendoni?

EM: Nuk mund të flas më për këtë pjesë, sepse unë kam hequr dorë nga krijimtaria dhe nuk jam në koherencë me këtë gjë. Mund të them se çdo ligj, me kalimin e kohës, kërkon ndryshime, abrogime dhe zëvendësime me gjëra më të avancuara. Sigurisht kjo është për të gjitha ligjet që veprojnë në Shqipëri.

SHTOJCË II: “FILMAT TE NDALUAR” DHE SHIKUESHMËRIA E TYRE

Tabela 6 – Lista me filmat e propozuar nga Kastriot Dervishi, ish-drejtor i Arkivit të Ministrisë së Brendshme, për të mos u transmetuar më për shkak të manipulimeve dhe nivelit të lartë të propagandës, si dhe shikueshmëria online sipas monitorimit të IDMC.

Filmi	Regjisori	Skenari	Shikimet on-line (YouTube)*
“Skënderbeu” (1953)	Sergei Yutkeviç	Mikhail Papava	296000
“Furtuna” (1959)	Kristaq Dhamo	Fatmir Gjata, Juri Ozerov	12000
“Debatik” (1961)	Hysen Hakani		67500
“Detyrë e posaçme” (1963)	Kristaq Dhamo	Safet Kurti	69500
“Toka jonë” (1964)	Hysen Hakani	Peçi Dado	12500
“Vitet e para” (1965)	Kristaq Dhamo	Fatmir Gjata	41600
“Komisari i dritës” (1966)	Dhimitër Anagnosti	Llazar Siliqi	81500
“Duel i heshtur” (1967)	Dhimitër Anagnosti	Nasho Jorgaqi	1900
“Ngadhënjim mbi vdekjen” (1967)	Gëzim Erebara, Piro Milkani	Gëzim Erebara, Piro Milkani, Peçi Dado	20500
“Horizonte të hapura” (1968)	Viktor Gjika	Dritëro Agolli	15000
“Prita” (1968)	Mithat Fagu	Xhevat Alibali	167500
“Njësi gueril” (1969)	Hysen Hakani	Hysen Hakani, Muharrem Skënderi	5400
“I teti në bronz” (1970)	Viktor Gjika	Dritëro Agolli, Viktor Gjika	87000
“Lugina e pushkatarëve” (1970)	Todi Bozo, Vitore Çeli	Todi Bozo	7600

“Gjurma” (1970)	Kristaq Dhamo	Peçi Dado	22,500
“Mëngjese lufte” (1971)	Kristaq Dhamo	Dhimitër Xhuvani	61900
“Kur zbardhi një ditë” (1971)	Piro Milkani	Piro Milkani, Anastas Kondo	77,400
“Malet me blerim mbuluar” (1971)	Dhimitër Anagnosti	Dhimitër Anagnosti	352,500
“Krevati i perandorit” (1973)	Endri Keko	Dritëro Agolli, Endri Keko	150
“Operacioni Zjarri” (1973)	Muharrem Fejzo	Mark Dodani, Enver Isufi, Muharrem Fejzo	50500
“Cuca e maleve” (1974)	Dhimitër Anagnosti	Loni Papa, Agron Aliaj	76500
“Shtigje lufte” (1974)	Piro Milkani	Safet Kurti, Skënder Plasari	176395
“Beni ecën vetë” (1975)	Xhanfise Keko	Kiço Blushi	172050
“Në fillim të verës” (1975)	Gëzim Erebara	Peçi Dado	211500
“Rrugicat që kërkonin diell” (1975)	Saimir Kumbaro, Rikard Ljarja	Dhimitër Xhuvani	38700
“Udhëtim në pranverë” (1975)	Qerim Mata	Gjergj Vlashi	27,650
“Dimri i fundit” (1976)	Ibrahim Muçaj, Kristaq Mitro	Nexhati Tafa	198000
“Fijet që priten” (1976)	Muharrem Fejzo	Neshat Tozaj	25000
“Ilegalët” (1976)	Saimir Kumbaro, Rikard Ljarja	Abaz Hoxha, Peçi Dado	61500
“Lulëkuqet mbi mure” (1976)	Dhimitër Anagnosti	Petraç Qafzezi	219300
“Përballimi” (1976)	Viktor Gjika	Teodor Laço	279000
“Pylli i lirisë” (1976)	Gëzim Erebara	Kiço Blushi	303000
“Tinguj lufte” (1976)	Xhamfise Keko	Flamur Topi	122100

“Tokë e përgjakur” (1976)	Ibrahim Muço, Kristaq Mitro	Kiço Blushi, Nexhati Tafa	1400
“Zonja nga qyteti” (1976)	Piro Milkani	Ruzhdi Pulaha	719000
“Thirrja” (1976)	Fehmi Hoshafi	Kujtim Gjonaj, Ilinden Spasse	93,600
“Njeriu me top” (1977)	Viktor Gjika	Viktor Gjika, Dritëro Agolli	176000
“Shembja e idhujve” (1977)	Piro Milkani	Skënder Drini	4700
“Tomka dhe shokët e tij” (1977)	Xhanfise Keko	Nasho Jorgaqi	334400
“Koncert në vitin 1936” (1978)	Saimir Kumbaro	Dhimitër Shuteriqi, Kiço Blushi	10,200
“Gjeneral gramafoni” (1978)	Viktor Gjika	Vath Koreshi	70500
“I treti” (1978)	Albert Minga	Neshat Tozaj	7800
“Kur hidheshin themelet” (1978)	Vladimir Prifti	Kolë Jakova	7250
“Në pyjet me borë ka jetë” (1978)	Rikard Ljarja	Zija Çela	62000
“Nusja dhe shtettrëthimi” (1978)	Ibrahim Muçaj, Kristaq Mitro	Elena Kadare	44400
“Pas gjurmëve” (1978)	Xhanfise Keko	Skifter Këlliçi	152000
“Vajzat me kordele të kuqe” (1978)	Gëzim Erebara	Luan Rama,	14900
“Ditët që sollën pranverën” (1979)	Vladimir Kasaj	Teodor Laço	0
“Një natë nëntori” (1979)	Vladimir Kasaj	Vladimir Kasaj	0
“Balonat” (1979)	Ismail Zhabjaku	Muharrem Skënderi, Halil Kamberi	400

“Këshilltarët” (1979)	Xhezair Dafa	Kujtim Gjonaj	9520
“Mysafiri” (1979)	Hysen Hakani	Mark Dodani, Hasan Prela	16300
“Ne vinim nga lufta” (1979)	Spartak Pecani	Vladimir Meçaj	20150
“Radiostacioni” (1979)	Rikard Larja	Ismail Kadare	4850
“Gëzhoja e vjetër” (1980)	Saimir Kumbaro	Aleksandër Lalo	163,000
“Një ndodhi në port” (1980)	Hysen Hakani	Kadri Piro dhe Lirim Pëllumbi	11,000
“Një shoqe nga fshati” (1980)	Piro Milkani	Ruzhdi Pulaha	707000
“Agimet e stinës së madhe” (1980)	Albert Minga	Gjergji Melo	205550
“Edhe ne luftuam” (1981)	Jani Tane	Gaqo Bushaka	0
“Kërcënimi” (1981)	Mark Topallaj	Apostol Nasi	6350
“Në prag të lirisë” (1981)	Ibrahim Muço, Kristaq Mitro	Ibrahim Muço	24755
“Një ngjarje në liqen” (1982)	Jani Tane	Fatmir Dibra	0
“Një natë pa dritë” (1982)	Gëzim Erebara	Gëzim Erebara	3050
“Qortimet e vjeshtës” (1982)	Kristaq Dhamo	Peçi Dado	11700
“Si gjithë të tjerët” (1982)	Spartak Pecani	Ruzhdi Pulaha	26500
“Besa e kuqe” (1982)	Pirro Milikani	Dhimitër Anagnosti, Vath Košeshi	126000
“Era e ngrohtë e thellësive” (1982)	Vladimir Prifti	Naum Prifti, Vladimir Prifti	17500

“Nëntori i dytë” (1982)	Viktor Gjika	Dhimitër Shuteriqi, Kiço Blushi	258200
“Njeriu i mirë” (1982)	Ibrahim Muço, Kristaq Mitro	Nexhati Tafa	149000
“Rruga e lirisë” (1982)	Esat Musliu	Lavdie Leka, Natasha Lako	1300
Fundi i një gjakmarrjeje (1983)	Rikard Ljarja	Agim Gjakova	8,700
“Dora e ngrohtë” (1983)	Kujtim Çashku	Neshat Tozaj	8550
“Një emër midis njerëzve” (1983)	Muharrem Fejzo	Natasha Lako	21300
“Koha nuk pret” (1983)	Kujtim Meçaj	Natasha Lako	1300
“Gracka” (1983)	Saimir Kumbaro	Neshat Tozaj	36,400
“Gjurmë në dëborë” (1984)	Edmond Tare	Roland Gjoza	17,200
“Militanti” (1984)	Piro Milkani	Kiço Blushi	27850
“Nata e parë e lirisë” (1984)	Esat Musliu	Vath Koreshi	43100
“Vendimi” (1984)	Kristaq Dhamo	Spiro Dede, Neshat Tozaj	156000
“Asgjë nuk harrohet” (1985)	Esat Ibro	Teodor Laço	172400
“Hije që mbeten pas” (1985)	Esat Musliu	Diana Çuli, Esat Musliu	86400
“Historiani dhe kameleoni” (1988)	Saimir Kumbaro	Saimir Kumbaro, Qamil Buxheli	76,500
		TOTALI *Shifra të rrumb.	7,477,125

Tematika e filmave të listuar ⁶¹ :

1. “Skënderbeu” (1953).

Film shqiptaro-sovjetik me regji të Sergei Yutkevich dhe skenar të Mikhail Papava. Dervishi thotë se në të “shihet qartë ndikimi rus pasi Papa dhe Vatikani paraqiten si armiq të Shqipërisë”. Sipas tij, kjo sepse “kështu e donin interesat ruse”. Në rrjet, vetëm duke përlogaritur shikueshmërinë e arritur në platformën e përmbajtjes së vetëgjeneruar në “YouTube” nga postimet e këtij filmi – në mënyrë pirate – në shumë kanale përdoruesish, rezulton se “Skënderbeu” është parë më tepër se 296 mijë herë.

2. “Furtuna” (1959).

Film me temë nga Lufta e Dytë Botërore. Regji e Kristaq Dhamos, skenar i Fatmir Gjatës dhe Yuri Ozerovit. Sipas Dervishit, këtu “ndërtohen skena imagjinare të luftës së komunistëve kundër italianëve, të cilët paraqiten si budallenj që këndojnë kur shkojnë të luftojnë”. Nga komenti i ish-drejtorit të Arkivit të Ministrisë së Brendshme nuk përdoren fjalë të tjera kur vjen puna për të përshkruar se “një prej idiotësive të këtij filmi është se britanikët paraqiten si miq me gjermanët”. Në platformën e përmbajtjes së vetëgjeneruar në “YouTube” rezulton se “Furtuna” është parë më tepër se 12 mijë herë.

3. “Debatik” (1961).

Me regji të Hysen Hekanit dhe skenar të Selman Vaqarit, Niko Kolekës dhe Gëzim Erebarës. Sipas Dervishit, filmi “zmadhon tej

61. Kastriot Dervishi, “Propaganda në filmat e komunizmit: Ekonomati te filmi “Lulëkuqet mbi mure, babai i Nexhmijes” postim në Facebook, i botuar në Panorama, 23 Mars 2017. <https://bit.ly/2rwJYlc>

mase rolin e kalamajve gjatë luftës, ndërsa i paraqet fashistët se merren me kalamaj, madje se i vrasin. Fashizmi nuk është marrë kurrë me kalamaj, sepse në të vërtetë me ta janë marrë komunistët në vitet 1945–1954, teksa i kanë futur në kampet me tela me gjemba. Po ashtu në film janë të qarta parimet e luftës së klasave, sipas së cilës fukarenjtë dhe të pashkolluarit e donin Shqipërinë ndërsa intelektualët dhe të pasur nuk e donin”. Për këtë koment, Dervishi u shënjestrua nga portale të ndryshme si “Tema” apo “Dritare.net” se i “del në mbrojtje fashizmit”. Në “YouTube”, filmi “*Debatiku*” ka gjeneruar më tepër se 67 mijë shikime.

4. “Detyrë e posaçme” (1963).

Një film gjithashtu me regji të Kristaq Dhamos dhe skenar të Safet Kurtit, që, sikurse pretendohet, “është i bazuar në ngjarje të vërtetë” dhe ku, sipas Dervishit, “ngrihet lart roli i Sigurimit të Shtetit në kombinacionet me lojën e “Frontit të Rezistencës”. Në “YouTube” ky film është shikuar mbi 69 mijë herë.

5. “Toka jonë” (1964).

Një film nga Hysen Hakani dhe Peçi Dado, i cili sipas regjimit fliste për “dobishmëritë e reformës agrare në veri të vendit”. Sipas Dervishit, ky film bazohet mbi “parimet e luftës së klasave duke përligjur vjedhjen e pronës si veprim të ligjshëm”. Sipas tij, synimi i këtij filmi “është demaskimi i kulakut” dhe prandaj nuk duhet transmetuar. “Toka jonë” është parë më tepër se 12 mijë herë në “YouTube”.

6. “Vitet e para” (1965).

Tjetër film nga Kristaq Dhama dhe Fatmir Gjata. Ky i fundit veprën e ka trajtuar më parë në një roman ku përfshin ngjarje të bazuara në histori që pretendohen si të vërteta. Film i bën fjalë për

“sabotimet e tharjes së kënetës së Maliqit”, që sipas Dervishit është “fund e krye falsifikim”. Sipas tij, “në këtë film paraqiten amerikanët si organizatorë të ‘sabotimit’, intelektualët si tradhtarë dhe rreckamanët si njerëz që e donin atdheun”. Vetëm në “YouTube” ky film është parë më shumë se 41 mijë herë.

7. “Komisari i dritës” (1966).

Filmi i Dhimitër Anagnostit dhe Lllazar Siliqit trajton “përpjekjet për të arsimuar vendin dhe luftën kundër bandave dhe reaksionarëve në Mirditë”. Filmi pretendohet të jetë bazuar mbi ngjarje të vërtetë, por që Dervishi thotë se bëhet për ta “paraqitur klerin katolik si imoral dhe kundër kulturës”, ndërsa nga ana tjetër krejt kundër tyre “komunistët shfaqen si përkrahës të dijes”. Në platformën e përmbajtjes së vetëgjeneruar në “YouTube”, ky film është parë më tepër se 81 mijë herë.

8. “Duel i heshtur” (1967).

Edhe ky film, me regji nga Dhimitër Anagnosti dhe skenar prej Nasho Jorgaqit, thuhet se është bazuar në ngjarje të vërtetë. Ai merr shkas prej historisë së Spiro Kotes, i cili në vitin 1947 thuhet se vrau “tre tradhtarë që kërkonin të arratiseshin dhe ktheu në portin e Durrësit një motovedetë që u kërkua të rrëmbehej”. Dervishi thotë se “si subjekti, ashtu edhe filmi me gjoja lidhje me amerikanët është falsifikim historik”. Megjithatë falë aktrimit të arrirë dhe realizimit filmik ai ka zënë vend te dashamirësit e filmave. Në “YouTube” – në ato kanale të cilat nuk janë mbyllur ende – “Duel i heshtur” është parë më tepër se 1 mijë herë.

9. “Ngadhënjim mbi vdekjen” (1967).

Tjetër film që trajton Luftën e Dytë Botërore. Me regji nga Gëzim Erebara dhe Piro Milkani, ai thuhet se bazohet në ngjarje të vërtetë, në historinë e varjes në litar të dy partizaneve Bule Naipi dhe Persefoni Kokëdhima më 17 korrik 1944 në Gjirokastër. Sipas Dervishit, filmi priret të “masivizojë prezencën e gjermanëve në Gjirokastër” në një kohë që sipas tij ajo kishte “prezencë simbolike atje” dhe jo me “disa divizione”. Tjetër detaj që nuk qëndron sipas tij është fakti se në film “nazistët marrin edhe funksione policore, duke kontrolluar shtëpi”. Në “YouTube” ky film është parë mbi 20 mijë herë.

10. “Horizonte të hapura” (1968).

Tjetër film që pretendohet se bazohet në ngjarje të vërtetë. Me regji nga Viktor Gjika dhe skenar të Dritëro Agollit, ai trajton “punën dhe përpjekjet për të industrializuar vendin”. Ngjarjet vendosen në portin e Durrësit. Në të spikat personazhi antagonist i Robert “Çamçakëzit” i kthyer më pas në nofkë dhe batutë për shumë breza, aq sa edhe në vitet 2000 u përdor në politikë. Dervishi thotë për filmin se ai është i “frymëzuar nga revolucioni kulturor kinez dhe figura komike e Lej Fenit”. Sipas tij, nga këto vepra “individit nuk ka hallin e vet, por të ndërmarrjes, apo pronës socialiste”. “Horizonte të hapura” është parë mbi 15 mijë herë vetëm në “YouTube”.

11. “Prita” (1968).

Tjetër film me fokus te “Lufta Nacionalçlirimtare”. Me regji të Mit’hat Fagut dhe skenar të Xhevat Alibalit, ai trajton “përpjekjen e forcave partizane për të luftuar okupatorin nazist”. Sipas analizës së Dervishit, filmi nuk duhet transmetuar pasi shtrembëron realitetin historik duke “masivizuar luftën e komunistëve në skena

me të vërtetë komike” në raport me heroizmin dhe me “gjeranë frikacakë”, të cilët janë të paditur nga pikëpamja ushtarake përballë “të diturve partizanë”. “Prita” në “YouTube” ka pasur më shumë se 160 mijë “views”.

12. “Njësiti gueril”

Një film nga Hysen Hakani dhe Muharrem Skënderi, që sipas Dervishit nuk duhet të transmetohet pasi “ligjëron veprimet terroriste të kohës së luftës” pra që manipulon kështu historinë. Në “YouTube” ky film është parë më tepër se 5 mijë herë.

13. “I teti në bronz” (1970).

Filmi nga Viktor Gjika dhe Dritëro Agolli ngre si antagonist kryesor figurën e Sali Protopapës, i cili në jetë reale ishte Sejfi Protopapa, i angazhuar me Ballin Kombëtar, më vonë shkencëtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Agolli e pati trajtuar më parë Sali Protopapën në librin e tij “Komisari Memo” (1969), ku bazohet edhe filmi. Në arsyetimin e tij për mostransmetimin, sipas Dervishit, ky film “mishërohen parimet e luftës së klasave”. Sipas tij, “partizanët dhe ballistët janë vendosur në role të pavërteta, ndërsa pozicioni i ushtrisë gjermane në rol shumë të theksuar, me përkushtim për t’u marrë me probleme fshatare”. “I teti në bronz” rezulton të jetë parë mbi 87 mijë herë në “YouTube”.

14. “Lugina e pushkatarëve” (1970).

Me regji nga Todi Bozo dhe Vitore Çeli, filmi bën fjalë për “luftën ndaj diversantëve në mbrojtje të pushtetit popullor”. Subjekti ka në plan forcat ndihmëse të kufirit që janë gjithmonë në “mbrojtje të atdheut”. Sipas Dervishit, në kinematografinë komuniste “diversantët janë gjithnjë me mjekra dhe synojnë të prishin ditët e

lumtura të rendit socialist”. Në fakt, ky film përfshihet në ata lloje filmash jo shumë të përhapur për shikuesit dhe në “YouTube”, mes kanaleve të ndryshme të përdoruesve, vështirë të numërohen më shumë se 5 mijë shikime.

15. “Gjurma” (1970).

Film nga Kristaq Dhama dhe Peçi Dado, ku në qendër vendoset një mjek, i cili “joshet nga konceptet mikroborgjeze” për shkak të ndikimit të të tjerëve. Sipas Dervishit në film del roli i “elementit armik” që synon të “minojë pushtetin” dhe të arratiset. Ky element ndërmerr edhe veprime kriminale në funksion të arritjes së qëllimeve të tij. Në “YouTube” filmi është parë mbi 22,500 herë.

16. “Mëngjese lufte” (1971).

Film nga Kristaq Dhama e Dhimitër Xhuvani. Tema që trajtohet është Lufta Nacionalçlirimtare. Skena ku fëmijët arrijnë t’i marrin rrobat ushtarëve gjermanë, ndërsa këta janë të paaftë të veprojnë, është një nga më të njohurat nga ky film. Sipas komentit të Dervishit, “edhe këtu gjermanët paraqiten me detyra policore, sigurisht duke denigruar ballistët si bashkëpunëtorë të tyre” gjë që sipas tij manipulon historinë dhe jep një realitet krejt tjetër krahasuar me dinamikën e ngjarjeve të atyre viteve. “Mëngjese lufte” në “YouTube” ka mbi 60 mijë shikime dhe mund të klasifikohet ndër filmat e ndjekur.

17. “Kur zbardhi një ditë” (1971).

Film nga Piro Milkani, Ksenofon Dilo e Anastas Kondo me temë kryesore Luftën Nacional-Çlirimtare. Sipas Dervishit filmi, i cili është i ndërtuar në tre pjesë me skenarë të ndryshme, në njërin prej tij “synon denigrimin e ballistëve duke i lidhur ata me

pushtetin, si pianecë të degraduar”. Në platformën e përmbajtjes së vetëxheneruar, “YouTube”, ky film është parë mbi 77 mijë herë.

18. “Malet me blerim mbuluar” (1971).

Realizim nga Dhimitër Anagnosti, me në qendër Luftën Nacional-Çlirimtare. Vëmendia i kushtohet jetës së partizanëve dhe vështirësive për të ndihmuar të plagosurit. Dervishi thotë se herë pas here në film “përdoret shprehja ballist, me konotacion fyes ndaj atyre që iu drejtohet”. I publikuar disa herë në mënyrë pirate në YouTube, filmi është parë mbi 352 mijë herë.

19. “Krevati i perandorit” (1973).

Film nga Endri Keko dhe Dritëro Agolli. Në qendër është monologu i një partizani, i cili vë në krahasim pushtetin komunist me pushtetin e kaluar. Ky film nuk i kalon 30 minutat. Sipas Dervishit “mbështetet mbi parimet e luftës së klasave”. Pavarësisht se subjekti kryesor është perandori italian, në thelb është triumfi i komunistëve mbi pushtetin e vjetër. Sipas ish-drejtorit të Arkivit të Ministrisë së Brendshme “paraqitet si pozitive përmbysja e madhe sociale e vitit 1944, kohë kur inteligjenca e vendit, ose u vra ose përfundoi burgjeve dhe injoranca erdhi në pushtet”. Ky film nuk është shumë i ndjekur. Në “YouTube” rezulton të jetë hequr shpesh nga rrjeti dhe në dy-tri kanale ishte publikuar për çështje dy-tre muajsh, me rreth 150 shikime.

20. “Operacioni Zjarri” (1973).

Një film nga Muharrem Fejzo, Mark Dodani dhe Enver Isufi, që pretendohet të jetë bazuar mbi ngjarjen e vërtetë të ndodhur në vitin 1953 ku “pushteti arriti të zbulojë një rrjet që synonte rrëzimin e sistemit”. Në qendër vendoset lufta ndaj bandave dhe ku

hiperbolizohet dhe lavdërohet veprimtaria e Sigurimit të Shtetit. Sipas Dervishit, përmes këtij filmi “veprimtaria antikomuniste priret të shfaqet si terroriste”. “Operacioni Zjarri” rezulton të jetë parë më shumë se 50 mijë herë në rrjet.

21. “Cuca e maleve” (1974).

Dramë e Loni Papës e kthyer në vepër teatrale, por dhe në balet. Në qendër vendoset figura e gruas dhe “lufta ndaj zakoneve prapanike”. Në thelb kultura fetare dhe ritet zakonore të zonës së veriut shfaqen si injorancë, ndërsa sipas Dervishit, kjo vepër “frymëzohet nga revolucioni kulturor kinez”. Pjesa teatrale e sjellë në film është parë në rrjet më tepër se 76 mijë herë.

22. “Shtigje të luftës” (1974).

Film nga Piro Milkani, Safet Kurti dhe Skënder Plasari. Në qendër vendoset lufta në fshatin e Pezës dhe që pretendohet të ketë marrë frymëzim nga “ngjarje të vërteta”. Sipas Dervishit “ka manipulime të shumta. Enver Hoxha paraqitet si organizator i mbledhjes së Pezës, po ashtu personazhi kryesor (Kanani) që ka qenë një terrorist e gjobëvënës, paraqitet si hero popullor”. Në platformën e përmbajtjes së vetëgjeneruar “YouTube”, ky film është shikuar më tepër se 176 mijë herë.

23. “Beni ecën vetë” (1975).

Film nga Khanfize Keko dhe Kiço Blushi që sipas Dervishit bazohet “në filma të ngjashëm të kinematografisë sovjetike”. Theksi vihet mbi paraqitjen e jetës në fshat si një jetë më e mirë sesa ajo në qytet, propaganda e vendoset te shumëfishimi i perceptimit se falë regjimit gjërat ishin ndryshuar rrënjësisht. Në rrjet, vetëm në “YouTube” ky film është parë më tepër se 172 mijë herë.

24. “Në fillim të verës” (1975).

Realizuar nga Gëzim Erebara dhe Peçi Dado. Në film trajtohet përpjekja për t’i bërë ballë pushtimit fashist. “Ilegalët komunistë” realizojnë një plan për të hedhur në erë një depo me municione në një zonë bregdetare. Batuta e Jaho Labit (Sandër Prosi) “Trimi i xha Jahos!” ka zënë vend në fjalorin e batutave të përditshmërisë edhe të kohës së sotme. Sipas Dervishit, ky film trajton me “ekzagjerim të tepruar aktivitetin e njësitit gueril” dhe për rrjedhojë manipulon edhe historinë. Në film, ndërkohë, përmendet me nënkuptim edhe ndikimi i Hoxhës në “operacione të tilla” me referimin si “komandanti, shoku Shpati”. Në “YouTube”, “Në fillim të verës” është shikuar mbi 211 mijë herë.

25. “Rrugicat që kërkonin diell” (1975).

Film nga Saimir Kumbaro, Rikard Ljarja e Dhimitër Xhuvani. Subjekti ka të bëjë me një të ri të varfër gjatë Luftës së Dytë Botërore, i cili pasi njihet me partizanët angazhohet duke transportuar shtypin e duke shpërndarë trakte. Sipas Dervishit ky film “bazohet në zgjimin e rolit të klasës punëtore kundër borgjezisë, në luftë për rendin e ri, ndërsa Partia Komuniste jepet si zgjidhje, e vetmja që do t’i sillte të mirën Shqipërisë”. Në “YouTube” ky film është parë mbi 38 mijë herë.

26. “Udhëtim në pranverë” (1975).

Film muzikor realizuar nga Qerim Mata, Gjergji Vlashi e Avni Mula, në qendër vendosen dy të rinj, një këngëtare dhe një shofer, i cili e shoqëron atë në një udhëtim nëpër Shqipëri. Sipas Dervishit, “filmi duket sikur është nisur jashtë propagandës, por në mjaft pjesë vendosen këngë dhe foto kushtuar Enver Hoxhës, duke shfaqur një adhurim që i afrohet neverisë”. Ky film numëron mbi 27,600 shikime në “YouTube”.

27. “Dimri i fundit” (1976).

Një film nga Ibrahim Muçaj, Kristaq Mitro dhe Nexhat Tafa, që sipas Dervishit ka skena “thellësisht qesharake”. Përmes këtij punimi Ish-Kinostudio përpiqej të hiperbolizonte më tej Luftën Nacional-Çlirimtare. “Në film, ushtria gjermane merret me disa gra të e fshatit, a thua se kishte ndonjë rëndësi të madhe. Krijohet përshtypja se ky fshat duhej të ishte Stalingradi,” thotë Dervishi në analizën e tij. Në “YouTube” ky film është parë mbi 198 mijë herë.

28. “Fijet që priten” (1976).

Një film nga Muharrem Fejzo dhe Neshat Tozaj. Sërish fokusi vihet te e ashtuquajtura “vigjilencë revolucionare”. Një agent i huaj vjen në Shqipëri për të aktivizuar një agent tjetër dhe për të sabotuar industrinë e “pushtetit popullor”, por që i gjithë operacioni bie nën aktivitetin e “zbulimit”. Dervishi e cilëson këtë film të patransmetueshëm për faktin se propagandon “fantazitë e Sigurimit të Shtetit”. “Një shqiptar që dikur kishte bashkëpunuar me nazistët vjen i maskuar pas shumë vitesh si shtetas i huaj, këtë herë në shërbim të amerikanëve, britanikëve, etj. Në realitet nuk ka ndodhur asnjë rast i tillë,” thotë ai. Në “YouTube” ky film rezulton me më tepër se 25 mijë shikime.

29. “Ilegalët” (1976).

Realizim i Rikard Ljarjas, Saimir Kumbaros dhe dyshes Abaz Hoxha e Peçi Dado. Ngjarjet zhvillohen gjatë luftës, ku një agent italian kërkon të infiltrohet mes partizanëve, por që pikaset nga “vigjilencia dhe largpamësia e komunistëve”. Sipas Dervishit ky film, si pjesë e propagandës komuniste është me një hiperbolizim të madh për faktin se sipas tij pjesa më e madhe e partizanëve ishin “me arsim fillor”. “Të pashkollët ishin më lart se kuadri i shkolluar në Itali për punë spiunazhi,” thotë ai. Në “YouTube” ky film rezulton të jetë shikuar mbi 61 mijë herë.

30. “Lulëkuqet mbi mure” (1976).

Film i Dhimitër Anagnostit i bazuar te romani autobiografik “Bonjakët” i Petraç Qafëzezit. Ngjarjet subjekt zhvillohen në një jetimore. Fokusi vendoset te aktiviteti “debatikas” kundër fashizmit. Ajo që në film përcillet me dramë dhe patriotizëm – me poezi të Fan Nolit – në fund mbyllet me shprehjen e mësuesit Luan Sina (Timo Flloko): “Ja pra të dashur fëmijë, kjo është Partia Komuniste shqiptare, është ajo nënë për të cilën ju kam folur”. Sikurse e thotë Dervishi, “fëmijët bëhen spiunë të komunistëve dhe në fund shfaqin besimin te roli i Partisë Komuniste. Administrata e jetimores paraqitet e pashpirt”. Ndërkohë ai zbulon se në film shfaqet edhe roli i ekonomistit të jetimores, që sipas Dervishit “në të vërtetë këtë funksion e ka pasur babai Nexhmije Hoxhës”, fakt të cilin sipas tij “skenaristët nuk e kanë ditur”. “Lulëkuqet mbi mure” kategorizohet ndër filmat më të shikuar të ish-Kinostudios. Në “YouTube” rezulton të jetë parë mbi 219 mijë herë.

31. “Përballimi” (1976).

Film i Viktor Gjikës që bazohet te romani i Teodor Laços. Ngjarjet vendosen fill pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Vendi i rrënuar tërësisht nga lufta, përballtet me urinë, ndërsa pushteti aplikon ndaj popullatës politikën e “konfiskimeve dhe grumbullimeve”. Sipas Dervishit filmi nuk duhet transmetuar për faktin se pasqyron qartë me propagandë pikëpamjet komuniste ndaj klerit. “Mbahen lart parimet e luftës së klasave, duke goditur kulakët, avokatët, mësueset e moralin e tyre, borgjezinë e vogël, etj” thotë Dervishi, i cili shton se kriza e vitit 1947–48 vinte më së shumti “si rezultat i politikës së gabuar të Partisë Komuniste në raport me Jugosllavinë”. Në vitin 1947, sipas Dervishit, “Shqipëria me kërkesë të jugosllavëve nuk mbolli drithë, por pambuk për industrinë jugosllave”. Në “YouTube” ky film është parë më tepër se 279 mijë herë.

32. “Pylli i lirisë” (1976).

Film i Gëzim Erebarës dhe Kiço Blushit. Ngjarjet vendosen sërish gjatë luftës. Propaganda në këtë film fokusohet në shtresat e varfra duke nxjerrë sipas Dervishit “se patriotizmi doli nga shtresat e ulëta të shoqërisë”. Filmi përbuz pronarët dhe sidomos ballistët ndërsa kleri ortodoks paraqitet si i lidhur me pushtuesit. Në “YouTube” ky film është parë mbi 300 mijë herë.

33. “Tinguj luftime” (1976).

Film i Khanfize Kekos me skenar të Flamur Topit. Subjekti është një jetim që punësohet në një familje të kamur dhe befas rezulton të jetë i talentuar në violinë. Sipas Dervishit, filmi ka tipare të theksuara të “luftës së klasave ku borgjezia shtyp vegjelinë, madje edhe fëmijët”. Në “YouTube” rezulton të jetë parë mbi 122 mijë herë.

34. “Tokë e përgjakur” (1976).

Film nga Ibrahim Muço, Kristaq Mitro, Kiço Blushi dhe Nexhati Tafa. Në qendër vendoset çështja e pronës ku në këndvështrimin dhe propagandës komuniste lavdërohet “reforma agrare”. Sipas Dervishit ky film nuk duhet transmetuar për faktin se trajton luftën e klasave ndërsa “pronarët e tokave paraqiten si kriminelë apo gjakpirës”. Në “YouTube” nuk rezulton të jetë shumë i përhapur si film dhe për rrjedhojë rezulton të jetë parë rreth 1.400 herë.

35. “Zonja nga qyteti” (1976).

Film komedi i Piro Milkanit, Ruzhdi Pulahës dhe Agim Krajkës. Një nënë nga qyteti vendos të ndjekë të bijën që është caktuar me punë në fshat, atje ku kjo e fundit ka plot paragjykime, por që në fund “i hedh poshtë”. Edhe pse në tërësi ka plot situata gazmore,

propaganda është tejet e theksuar në të. Jeta aktive në fshat është fokusi kryesor, ndërsa edhe ngjarjet më të vështira si përmbytjet paraqiten si lehtësisht të përballueshme nga “angazhimi vullnetar”. Sipas Dervishit, ky film nuk duhet transmetuar për shkak se paraqet një “imazh krejt tjetër të fshatit, ndryshe nga mizeria e fukarallëku që mbizotëronte atje”. Filmi “Zonja nga qyteti” është ndër filmat më të shikuarit e ish-Kinostudios dhe kjo rezulton edhe nga vëzhgimi në “YouTube” atje ku është parë më tepër se 719 mijë herë.

36. “Thirrja” (1976).

Film nga Fehmi Hoshafi dhe skenar nga Kujtim Gjonaj e Ilinden Spasse, që bazohet në romanin “Zjarre” të shkrimtarit Setrjo Spasse dhe që i kushtohet thirrjes për të prishur objektet e kultit në fund të viteve ‘60, ndërtimin e kooperativave, thyerjes së zakoneve dhe traditave, etj. Dervishi thotë se “figura e priftit këtu paraqitet shumë negative, si mishërim i së keqes”. Filmi është realizuar në kohën e lëvizjeve revolucionare të kopjuara nga revolucioni kulturor kinez. Në “YouTube” ky film numëron mbi 93,600 shikime.

37. “Njeriu me top” (1977).

Një film i Viktor Gjickës që bazohet te romani i Dritëro Agollit me të njëjtin titull. Sipas Dervishit, ky film nuk duhet transmetuar për faktin se tjetëron historinë. “Ballistët goditen si shkaktarë të të gjitha të këqijave, partizanët paraqiten sikur nuk dignin shtëpi teksa ky fakt është i shumëvërtetuar në vitet 1943–44,” thotë Dervishi. Ndërkohë filmi në “YouTube” është parë mbi 176 mijë herë.

38. “Shembja e idhujve” (1977).

Realizim i Piro Milkanit, Skënder Drinit dhe Feim Ibrahimit. Bazohet në romanin me të njëjtin titull dhe në propagandën e saj ka për bazë “luftën për arsimimin e vendit në zonat rurale dhe zhdukjen e zakoneve prapanike”. Sipas Dervishit ky film nuk duhet transmetuar në televizionin publik për shkak se sipas tij ka si motiv “përçarjen kombëtare”. Nga ana tjetër kleri katolik paraqitet si “mbrojtës i injorancës” ndërsa xhandari/kapteri (Robert Ndrenika) sipas Dervishit “vihet me kast të flasë në gegënisht, për të nënkuptuar se janë të trashë”. Në “YouTube” filmi nuk ka shumë vizualitet ndërsa është parë mbi 4 mijë herë.

39. “Tomka dhe shokët e tij” (1977).

Një film nga Xhanfize Keko dhe Nasho Jorgaqi. Në qendër vihet sërisht Lufta e Dytë Botërore – edhe pse kanë kaluar më shumë se 30 vite nga fundi i saj, tematika e luftës mbetet kryesore për Kinostudion dhe retorikën e propagandës komuniste. Një grup fëmijësh përballen me ushtrinë gjermane. Pikërisht ky fakt cilësohet nga Dervishi si një “banalitet”. Teksa e përfshin në listën e tij të filmave që nuk duhen transmetuar, ai ironizon duke thënë se “ushtrisë gjermane arrin t’ia kallë një kalama nga Berati dhe shokët e tij”. Megjithatë realizimi i mirë artistik bën që ky film të jetë ndër më të ndjekurit. Në “YouTube” rezulton me mbi 334 mijë shikime.

40. “Koncert në vitin 1936” (1978).

Film i Saimir Kumbaros me skenar të Kiço Blushit e Dhimitër Shuteriqit, i cili vë në qendër të vëmendjes vajtjen e dy artisteve për një koncert në Lushnjë gjatë periudhës së Mbretit Zog. Dervishi shprehet se filmi nxjerr periudhën e monarkisë si të prapambetur, me administratë të paaftë, ndërsa “falsifikohen ngjarje historike

si Kongresi i Lushnjës, i cili kishte organizator pikërisht Ahmet Zogun. Në platformën “YouTube” ky film është parë mbi 10,000 herë.

41. “Gjeneral gramafoni” (1978).

Realizim i Viktor Gjickës, Vath Koreshit dhe Aleksandër Peçit. Ngjarjet ndodhin në vitet '30 dhe përmes jetës së një naftëtari i cili është dhe klarinetist i zoti, kërkojnë të flasin për një realitet ku ndikimi i italianëve fashistë ishte intensifikuar aq sa po “përgatitej pushtimi i Shqipërisë”. Dervishi thotë se ky film nuk duhet transmetuar për faktin se “jep në mënyrë të shtrembër raportet shqiptaro-italiane në zonën e Kuçovës së atyre viteve”. Ai pretendon se ka të dhëna dokumentare, që hedhin poshtë çdo pretendim historik që kërkon të ngrejë filmi. “Dokumentet provojnë se grevat e punëtorëve të asaj kohe janë bërë me dijeni të plotë dhe leje të qeverisë (monarkiste)”. Po ashtu, sipas tij, prefekti i Beratit “nuk ka qenë mendjelehtë sa të vihej në dispozicion të italianëve”. Vetëm në “YouTube”, “Gjeneral gramafoni” është parë mbi 70 mijë herë.

42. “I treti” (1978).

Film televiziv i realizuar – në 4 seri nga 60 minuta – nga Radiotelevizioni Shqiptar, me regji të Albert Mingës, skenar të Neshat Tozajt dhe muzikë të Limos Dizdarit. Tema kryesore e filmit është “Sigurimi” dhe bazohet te romani i Tozajt, “Në kërkim të të tretit”. Dervishi e cilëson aspak të transmetueshëm pasi është i bazuar “thellësisht në imagjinata Sigurimi, sikur të huajt po merreshin aq shumë me Shqipërinë dhe një komunist të saj”. Megjithatë prej faktit se në të luajnë aktorë, si Sandër Prosi, Ferdinand Radi, Reshat Arbana, Margarita Xhepa e plot të tjerë, gjeneron shikueshmëri aq sa në “YouTube” të ketë mbi 7 mijë shikime.

43. “Kur hidheshin themelet” (1978).

Është një tjetër realizim i Radiotelevizionit Shqiptar, të cilin Dervishi e ka përfshirë në listën e tij. Ky film është i bashkëpunimit mes Vladimir Priftit dhe Kol Jakovës. Sipas Dervishit nuk duhet transmetuar pasi “bazohet mbi parimet e luftës së klasave. Ligjërohen veprimet terroriste të komuniste ndaj klasave të tjera, të cilat paraqiten me përsëkrime të errëta. Po ashtu roli negativ i misioneve të huaja.” Edhe ky film është parë rreth 7 mijë herë në “YouTube”.

44. “Në pyjet me borë ka jetë” (1978).

Realizim i Rikard Ljarjas, Zija Çelës dhe Agim Krajkës. Filmi merr spunto nga kinematografia sovjetike dhe ka tërësisht tipare propagandistike. Një transferim pune në veri, i detyron dy personazhet kryesore – burrë e grua – të përballen me kushtet e vështira atje. Por sikurse e do propaganda, gjithçka rezulton të jetë paragjykim pasi të dy gjejnë një “mjedis shoqëror të shëndetshëm”. Sipas Dervishit, ky film nuk duhet transmetuar pasi paraqet një këndvështrim joreal të gjendjes që ka pasur realisht fshati. Në “YouTube”, “Në pyjet me bore ka jetë” është shikuar më shumë se 62 mijë herë.

45. “Nusja dhe shtetrrrethimi” (1978).

Film nga Ibrahim Muçaj, Kristaq Mitro dhe Elena Kadare. Sërish vazhdohet me tematikën e luftës. Ngjarjet bëjnë fjalë për pushtimin nazist, ku një vajzë, Shpresa, aktivizohet si partizane dhe kryen një atentat. Pas kësaj ajo del në ilegalitet. Filmi, sipas Dervishit, nuk duhet të transmetohet për faktin se deformon realitetet historike duke i paraqitur gjermanët më së shumti me “role policore, më së shumti të e interesuar për të arrestuar një komuniste”. “Nusja dhe shtetrrrethimi” është parë në “YouTube” më shumë se 40 mijë herë.

46. “Pas gjurmëve” (1978).

Filmi i Xhanfize Kekos, Skifter Këllicit dhe Nikolla Zoraqit. Ngjarjet bëjnë fjalë për Shqipërinë e pasluftës dhe në qendër vendoset një grup fëmijësh, që arrin të identifikojë një “grup armiqsh” dhe të lajmërojë “organet e Sigurimit”. Dervishi e cilëson tërësisht të patransmetueshëm një film të tillë, për shkak se fëmijët këtu edukohen “të bëhen spiunë e të jenë vigjilentë mbi “armikun” ndërsa gjatë filmit shihen skena të konfiskimeve ndaj pronarëve”. Në “YouTube” ky film është parë mbi 152 mijë herë.

47. “Vajzat me kordele të kuqe” (1978).

Një film nga Gëzim Erebara, Luan Rama dhe Aleksandër Lalo. Tema e luftës dhe aktivitetit antifashist nga të rinjtë dhe të rejat. Ngjarjet zhvillohen në Institutin Femëror në Tiranë ku një vajzë pushkatohet për shkak të përfshirjes së saj në demonstrata. Dervishi thotë se ky film nuk duhet të transmetohet pasi bazohet mbi trillime historike. “Nuk njihet asnjë rast i pushkatimit të ndonjë femre me gjyq gjatë luftës,” thotë ai. Në “YouTube” “Vajzat me kordele të kuqe” është parë mbi 14 mijë herë.

48. “Ditët që sollën pranverën” (1979).

Një film nga Vladimir Kasaj dhe Teodor Laço, i cili flet për periudhën e pas-luftës. Në qendër vihet zona e veriut të Shqipërisë dhe përpjekjet e komunistëve për të shtrirë ndikimin edhe në ato zona. Dervishi këmbëngul se ky film nuk duhet transmetuar në televizionin publik pasi “Ivizjen shtypëse komuniste në veri të vendit e paraqet si pranverë”. Online ky film nuk gjendej i publikuar në platformën YouTube.

49. “Një natë nëntori” (1979)

Realizim i Vladimir Kasajt në bashkëpunim me RTSH-në dhe që në qendër vendos periudhën gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare. Sipas Dervishit ky film nxit stereotipet sipas këndëvështrimeve ideologjike dhe politike komuniste, kinse “tregtari ishte reaksionar dhe njeri që u pi gjakun popullit dhe karrocieri i drejtë e i ndershëm”. Ky film nuk rezulton të jetë publikuar online në “YouTube”.

50. “Balonat” (1979).

Realizim i Ismail Zhabjakut, Muharrem Skënderit, Halil Kamberit, Avni Mulës dhe Robert Radojës. Sipas këtij filmi “lufta Antifashiste zgjoi edhe fëmijët” aq sa ata të angazhoheshin në një mënyrë përcjelljeje “parullash” përmes balonave. Sipas Dervishit, ky film nuk duhet transmetuar sepse hiperbolizon luftën dhe përcjell si realitet historik angazhimin e fëmijëve. “Nuk njihen raste të tilla” thotë në analizën e tij ai, ndërsa shton se në fund është manipulim shtënja me armë ndaj “fëmijëve”. Filmi nuk është shumë i përhapur në internet, dhe për këtë, në ato pak kanale ku është postuar në “YouTube” rezulton me rreth 400 shikime.

51. “Këshilltarët” (1979).

Film i Xhezair Dafës, Kujtim Gjonajt dhe Sokol Shupos. Ai bazohet në romanin me të njëjtin titull të Fatmir Gjatës dhe pretendohet të ketë rrjedhë nga “ngjarje e vërtetë”. Ngjarjet vendosen në periudhën e pushtimit nazist ku një grup anëtarësh të këshillit antifashist arrestohen gjatë një ceremonie dasme. Nazistët arrestojnë edhe dhëndrin dhe i vënë përpara zgjedhjes, ose të pushkatohen ose të nënshkruajnë kundër këshillit. Sipas Dervishit, ky film është manipulativ, nxit parimet e luftës së klasave, bazohet në ngjarje të ndodhur për hakmarrje dhe përzier ballistët me gjermanët. Në “YouTube” ky film rezulton të jetë parë mbi 9 mijë herë.

52. “Mysafiri” (1979).

Realizim i Hysen Hakanit, Mark Dodanit, Hasan Prelës dhe Shaqir Kodrës. Në qendër të filmit vendoset aktiviteti agjenturor dhe “vigjilenca revolucionare”. Sipas Dervishit, ai bazohet në trillime të Sigurimit të Shtetit dhe për këtë nuk duhet të transmetohet. “Të huajt, amerikanët, anglezët italianët, etj, na kanë inat që ne kemi arritur kaq shumë suksese dhe duan të na përmbysin rendin socialist,” ironizon në komentin e tij ish-drejtori i Arkivit në Ministrinë e Brendshme. Në “YouTube” ky film është parë mbi 16 mijë herë.

53. “Ne vinim nga lufta” (1979).

Film i realizuar nga Spartak Pecani, Vladimir Meçaj dhe Shaqir Kodra. Ngjarjet vendosen në Shqipërinë e pasluftës ku komunistët aplikojnë konfiskimet dhe shtetëzimet masive duke u marrë “borgjezëve” pronat dhe pasuritë materiale. Në këtë film film, që ka nota të qarta të luftës së klasave, spikat sjellja prej “sabotatori” e një llogaritari i cili ndihmon “borgjezët e shpronësuar dhe bashkëpunëtorë të fashizmit që të fshehin flori”. Dervishi thekson se ky film nuk duhet të transmetohet pasi “veprimet terroriste të komunistëve paraqiten si të ligjshme, apo dhe si reforma”. Në “YouTube”, “Ne vinim nga lufta” është parë mbi 20 mijë herë.

54. “Radiostacioni” (1979).

Një film nga Rikard Ljarja, Ismail Kadare dhe Zef Çoba. Skenari bazohet te romani i Kadaresë “Nëntori i një kryeqyteti” dhe ka të bëjë me ditët e çlirimit të Tiranës dhe rivënies në punë të Radios. Dervishi këmbëngul se ky film nuk duhet transmetuar pasi “beteja e Tiranës erdhi pas prishjes së marrëveshjes së komunistëve me gjermanët (duhej dukur sikur po luftohej). Në plan të parë shihen

luftime me ta, por në thelb është paraqitja e errët e klasave të tjera” - thotë ai. I njohur për batutën e Metes (Birçe Hasko): “Ju flet Tirana!” ky film është parë në “YouTube” më shumë se 4 mijë herë.

55. “Gëzhoja e vjetër” (1980)

Film i Saimir Kubaros dhe Aleksandër Lalos. Në qendër vendoset zbardhja e një vrasjeje dhe rritja e vigjencës. Sipas Dervishit kjo ishte në dukje, por “në thelb del armiku i pushtetit, biri i një tregtari që mundohet të mësojë sekrete të një uzine ushtarake nga një shok i tij dhe për këtë arsye edhe e vret”. Filmi frymëzon individin të ishte vigjilent ndaj armikut dhe “të kishte të lartë ndërgjegjen komuniste”. Në rrjet është postuar disa herë dhe në total numëron mbi 163 mijë shikime.

56. “Një ndodhi në port” (1980).

Realizim i Hysen Hekanit, Kadri Piros dhe Lirim Pëllumbit i cili flet për sabotimet në lidhje me të dhënat laboratorike të kontrollit të mallit. Synim ishte frymëzimi i vigjencës revolucionare, që duhet të kishte populli. Sipas Dervishit filmi jep idenë se Shqipëria ishte rrethuar egërsisht nga “kapitalisto-revizionizmi që mendjen e kishte te Shqipëria dhe nxitja e aktivitetit të armikut të klasës”. Në “YouTube” ky film është parë mbi 11 mijë herë.

57. “Një shoqe nga fshati” (1980).

Film komedi nga Piro Milkani, Ruzhdi Pulaha dhe Agim Krajka. Seria e dytë e “Zonjës nga qyteti (1976)” nuk ndryshon në thelb nga e para. Sërish propagandohet “jeta e mirë në fshat si rrjedhojë e reformave të mbara me prosperitet nga pushteti popullor”. Edhe për këtë, Dervishi thekson se nuk duhet transmetuar pasi rikthen në vëmendje një realitet fiktiv mbi gjendjen në fshat në kohën e

komunizmit. Sidoqoftë, për shkak të interpretimit të aktorëve të njohur si Violeta Manushi, Robert Ndrenika apo Rajmonda Bulku ky film mbetet ndër më të ndjekurit. Në “YouTube” rezulton të jetë parë mbi 700 mijë herë.

58. “Agimet e stinës së madhe” (1980).

Realizim televiziv i Albert Mingës në Radiotelevizionin Shqiptar. Ngjarjet vendosen në kohën e pasluftës ku “pushteti komunist mundohet të rindërtojë vendin” por has në armiqësinë e “klasave të përmbysura” të cilat organizohen në “banda” për të penguar reformat. Dervishi, në listimin në filmat që nuk duhen transmetuar, thekson se ky realizim “mishërohet nga parimet e luftës së klasave dhe për ligj veprimet terroriste të komuniste në ditët e para të pushtetit të tyre”. “Agimet e stinës së madhe” rezulton të jetë parë në “YouTube” mbi 205 mijë herë.

59. “Edhe ne luftuam” (1981).

Film nga Jani Tane dhe Gaqo Bushaka, një përshtatje televizive në bashkëpunim me RTSH-në, e shfaqjes teatrale të grupit të Pallatit të Pionerve të Tiranës dhe që trajtonte pjesëmarrjen e fëmijëve në Luftën Nacional-Çlirimtare. Sipas Dervishit ky film nuk duhet transmetuar në televizionin publik pasi “hiperbolizon rolin e fëmijëve në luftë dhe thekson etiketimet tradhëtarë”. Në “YouTube” ky film nuk gjendet i postuar.

60. “Kërcënimi” (1981).

Film nga Mark Topallaj, Apostol Nasi dhe Robert Radoja. Në qendër të tij vendoset agjuntura dhe “vigilenca revolucionare”. Në thelb vendoset dilema e “denoncimit të armikut”. Në këtë film arrihet në propagandimin e absurdit të “denoncimit të vetvetes”.

Dervishi e thekson se filmi rrjedh nga “imagjinata që nuk kanë ndodhur asnjëherë prej Sigurimit të Shtetit”. Sipas tij, ky film nxjerr idenë sikur “ato pak ambasada të huaja në Tiranë, interesoheshin për objektet ushtarake të Shqipërisë sikur ne të ishim ndonjë superfuqi”. Në “YouTube”, “Kërcënimi” është parë mbi 6 mijë herë.

61. “Në prag të lirisë” (1981).

Realizim prej Ibrahim Muços, Kristaq Mitros dhe Kujtim Laros. Filmi pretendohet se “bazohet në ngjarje të vërtetë” dhe bën fjalë për periudhën e vitit 1944 kur krijohet qeveria kuislinge, dhe sipas Dervishit “i manipulon tërësisht” ndodhitë. Propaganda komuniste e trajton këtë temë me këndvështrime dashakeqe duke i përcjellë “shtrembër forcat e tjera politike që nuk ishin të ideologjisë së saj”, siç është rasti i Partisë Socialdemokrate të Musine Kokalarit. Sipas Dervishit “filmi është ndërtuar në formën agjitative sikur Partia Komuniste e kishte të drejtë legjitime pushtetin” dhe për faktin se mbizotërohet nga “fryma klasore” ai nuk duhet të transmetohet. “Në Prag të Lirisë” është parë në “YouTube” më shumë se 24 mijë herë.

62. “Një ngjarje në liqen” (1982).

Film nga Jani Tane dhe Fatmir Dibra realizim në bashkëpunim me RTSH-në dhe që bën fjalë për disa fëmijë, të cilët gjejnë një varkë në liqen dhe teksa e rregullojnë dhe ia çojnë ndërmarrjes së peshkimit, zbulojnë “një armik të klasës”. Filmi sipas Dervishit nuk duhet transmetuar pasi ishte propagandistik dhe synonte “vigjilencën e fëmijëve për të zbuluar armikun e sistemit”. Në “YouTube” ky film nuk gjendet i publikuar, me gjasa prej faktit se arkivi i RTSH-së nuk është digjitalizuar ende i gjithi dhe kjo mund të ketë ndikuar që nga kjo arkivë të mos ketë shumë piratime.

63. “Një natë pa dritë” (1982).

Filmi Gëzim Erebarës, Kiço Blushit dhe Hajg Zaharjanit. Në qendër vendoset jeta e shkrimtarit Migjeni (Millosh Gjergj Nikolla) bazuar kjo – sipas pretendimeve – në ngjarje të vërteta. Por sipas Dervishit, ky film paraqet “krejtësisht shtrembër realitetin e viteve ‘30, të cilin e sheh vetëm me nota të errëta e paragjykuese”. Në argumentet e tij për ta listuar këtë film si të patransmetueshëm, Dervishi shton se ai i “përmbahet agjitacionit antizogist të propagandës zyrtare të kohës dhe është edhe antifetar dhe antikulturor”. Në “YouTube” ky film është parë mbi 3 mijë herë.

64. “Qortimet e vjeshtës” (1982).

Film i Kristaq Dhamos, Peçi Dados dhe Limoz Disdarit. Bën fjalë për Shqipërinë e viteve ‘30 të rrëfyer sipas këndvështrimit të një studenti të quajtur Kujtim Stefi (Kastriot Çausi), por i kushtohet figurës së Qemal Stafës. Edhe pse pretendohet se bazohet në ngjarje të vërteta, Dervishi thotë se ai “zhvillohet në funksion të propagandës së regjimit komunist, mbi fillesat e lëvizjes komuniste dhe rëndësisë së saj, duke dhënë mesazhin se vetëm komunizmi e shpëton Shqipërinë”. Në “YouTube” “Qortimet e vjeshtës” është parë mbi 11 mijë herë.

65. “Si gjithë të tjerët” (1982).

Film i Spartak Pecanit, Ruzhdi Pulahës dhe Aleksanër Peçit. Subjekt i filmit është jeta e “përmirësuar” e jetimëve prej “zhvillimit të vendit nga fryma e pushtetit popullor”. Vullneti (Edmond Topi), i cili është jetim, përballet me jetën duke përfutur nga ndihma e drejtoreshës dhe e një ustai, kjo në mënyrë që të fitojë edhe dashurinë e jetës së tij, Jetën (Matilda Makoçi). Sipas Dervishit, ky film nuk duhet të transmetohet pasi nuk përcjell realitetin e kohës,

pasi sipas tij “ka qindra raporte zyrtare që tregojnë diskriminimin e jetimëve në regjimin komunist”. Në “YouTube”, “Si gjithë të tjerët” është parë mbi 26 mijë herë.

66. “Besa e kuqe” (1982).

Realizim i Piro Milkanit, Dhimitër Anagnostit, Vath Koreshit dhe Zef Çobës. Në qendër të filmit vendoset historia e pesë heronjve të Vigut (Ahmet Haxhia, Naim Gjylbegu, Ndoc Mazi, Hydajet Lezha dhe Ndoc Deda) mbetur të vrarë në fshatin me të njëjtin emër në Mirditë më 21 gusht 1944. Regjimi komunist i shpalli ata “heronj”. Sipas Dervishit, ky material i Kinostudios nuk duhet transmetuar pasi është “manipulum historik”. Ai e argumenton këtë duke thënë se “Mirdita në atë kohë (1944) nuk e pranonte regjimin komunist që po sillnin partizanët”. “Besa e kuqe” është parë në “YouTube” mbi 126 mijë herë.

67. “Era e ngrohtë e thellësive” (1982).

Tjetër realizim filmik i Radiotelevizionit Shqiptar, i vënë në jetë nga Vladimir Prifti, Naum Prifti dhe Aleksandër Lalo. Fokusi vendoset në jetën sociale dhe në marrëdhëniet njerëzore të “klasës punëtore”. Në mënyrë të mirëfilltë sipas një shablloni të thjeshtë propagandistik, ideologjia, “të mirat dhe arritjet e sistemit” përcillen përmes personazhit kryesor Arbeni (Xhevdet Ferri) i cili kalon një kalvar të gjatë peripecish derisa sistemohet me punë dhe lidhet me dashurinë e tij Valin (Shpresa Bërdëllima). Sipas Dervishit, filmi nuk duhet transmetuar pikërisht prej nivelit të lartë propagandistik. Në “YouTube” ky realizim është parë mbi 17 mijë herë.

68. “Nëntori i dytë” (1982).

Realizim i Viktor Gjikkës, Dhimitër Shuteriqit, Kiço Blushit dhe Kujtim Laros. Një nga filmat kryesorë të Kinostudios dhe që ngjall ndërgjegjen kombëtare për faktin se i kushtohet shpalljes së pavarësisë më 28 nëntor 1912. Por ka probleme kur vjen puna pikërisht në kontekstin historik. Për këtë Dervishi është i mendimit që të mos transmetohet, edhe pse në tërësi ai e pranon se filmi është përpjekur t'i qëndrojë ca larg ideologjisë dhe ndikimit të komunistëve. Por ai e vë theksin te “nxjerrja në pah si protagonistë i disa figurave jo të spikatura, si për shembull Hysen Hoxha (xhaxhai i diktatorit)” problem ky që duhet të kesh disi njohuri më të thella për historinë që ta kuptosh thjesht duke e parë nga filmi. Sikurse u përmend, për faktin se provokon ndërgjegjen kombëtare, është një nga filmat më të shikuar të ish-Kinostudios. Në “YouTube” është parë mbi 258 mijë herë.

69. “Njeriu i mirë” (1982).

Film nga Ibrahim Muço, Kristaq Mitro, Nexhati Tafës dhe Hajg Zaharjanit. Tematika e viteve ‘80 është tashmë më sociale dhe skenari është disa herë më i realizuar. Në këtë film fokusi vihet te marrëdhëniet njerëzore dhe jetës së përditshme. Por sipas Dervishit ai nuk duhet transmetuar. “Pavarësisht se përgjithësisht i përmbahet në temën kryesore të tij dashurisë dhe luftës së të aftit me të paafin, nuk i shpëton dot elementëve të luftës së klasave, si çështja e biografisë dhe “hatasë” së origjinës nga Ballit Kombëtar”. Në “YouTube” ky film është parë mbi 149 mijë herë.

70. “Rruga e lirisë” (1982).

Realizim i Esat Musliut, Lavdie Lekës, Natasha Lakos dhe Limoz Dizdarit. Në qendër të filmit vendoset figura e gruas dhe

pjesëmarrja e saj në luftën antifashiste. Fokusi vihet te “mposhtja e zakoneve prapanike e konservatore” të jetës patriarkale. Edhe pse pretendohet të jetë bazuar në ngjarje të vërtetë, sipas Dervishit ky film nuk duhet të transmetohet për faktin se i kushtohet “Kongresit të grave komuniste në Berat”. Dervishi thotë se “filmi e paraqet këtë kongres (të vitit 1944), në të vërtetë formal dhe pa ndonjë ndikim në jetën e jetës, si ngjarje të madhe historike”. Edhe pse në këtë realizim luajnë aktore të njohura si Roza Anagnosti apo Tinka Kurti, “Rruga e lirisë” është parë rreth 1.300 herë.

71. “Fundi i një gjakmarrjeje” (1983).

Realizim i Rikard Ljarjes dhe Agim Gjakovës, i cili ka në qendër të vëmendjes periudhën e monarkisë, të cilën e vë nën kornizën e gjakmarrjes mes dy familjeve malësore. Sipas Dervishit filmi paraqet regjimin e Mbretit Zog kinse nxiste gjakmarrjet “se ashtu mbante pushtetin” duke ndikuar kështu në stereotipizimin dhe nxjerrjen në një përfundim të gabuar historik për kohën. Në “YouTube” ky film është parë mbi 8,700 herë.

72. “Dora e ngrohtë” (1983).

Film i Kujtim Çashkut, Neshat Tozajt dhe Haig Zaharjanit. Në qendër të plotit vendoset jeta e Besimit (Artur Gorishti) i cili nuk gjen “ngrohtësi” (mbështetje) te njerku i tij, Ahmeti (Reshat Arbana). “Zgjidhja” e problemit ofrohet nga Partia, “shokët e klasës”. Sipas Dervishit “Dora e ngrohtë” është “film tipik agjitativ, i mbizotëruar nga parimet e luftës së klasave, ku një armë kriminale e Partisë së Punës si Sigurimi i Shtetit, ka marrë rol edukativ”. Paraqitja e klasave të përmbysura në rrugë vagabondazhi është mirëfilli pejorative dhe fyese për këtë shtresë të përndjekur. Ironia më pas sipas Dervishit është fakti se “hetuesi është personazh i dashur, i cili madje del edhe xhiro me ish-të pandehurin, i cili

ka hyrë në ‘rrugë të drejtë’, pas dënimit që i dha partia”. “Dora e ngrohtë” është parë në “YouTube” mbi 8 mijë herë.

73. “Një emër midis njerëzve” (1983).

Realizim i Muharrem Fejzos, Natasha Lakos dhe Aleksandër Lalos. Filmi i kushtohet jetës së Avni Rustemit (Bujar Asqeriu), aktivitetit të tij politik dhe zhvillimet përpara “Revolucionit të Qershorit 1924”. Edhe pse në tërësi është realizim i mirë, çalon nga aspekti i trajtimit të historisë me “këndvështrime ideologjike, proletare” dhe të deformuar të jetës reale të viteve ‘20. Dervishi këmbëngul se ky film nuk duhet transmetuar sepse “i paraqet të gjitha faktet historike në funksion të politikës së Partisë së Punës, falsifikohen si ngjarja e atentatit mbi Esat Toptanin, po ashtu edhe zhvillimet politike të viteve 1920–1924”, që karakterizohen nga “filli i luftës së klasave dhe i përçarjes”. Në “YouTube”, “Një emër midis njerëzve” është parë mbi 21 mijë herë.

74. “Koha nuk pret” (1983).

Film me dy seri nga 60 minuta realizuar nga Radiotelevizioni Shqiptar nën kujdesin e Kujtim Meçajt, Dhimitër Xhuvanit dhe Vangjel Lekajt. Ngjarjet zhvillohen gjatë ditëve të fundit të pushtimit nazist dhe fokusi është te veprimtaria agjenturore e Sigurimit të Shtetit, që “neutralizon krerët e një agjente të huaj që kërkon të sabotojë hyrjen e Qeverisë në Tiranën e çliruar”. Sipas Dervishit ky realizim nuk duhet të transmetohet pasi përpjekjet për të kundërshtuar vendosjen e regjimit komunist propagandohen si “mbeturina të reaksionit”. Në “YouTube”, “Koha nuk pret” nuk gjendet shumë i përhapur dhe është parë diçka më shumë se 1.300 herë.

75. “Gracka” (1983).

Film nga Saimir Kumburo dhe Neshat Tozaj me subjekt agjenturën e fshehtë, ku vihet në pah forca e Sigurimit të Shtetit. Sipas Dervishit ky film i kushtohet të ashtuquajturës “radiolojë ‘Liqeni i Vajkalit’ organizuar nga këshilltarët sovjetikë nëpërmjet Sigurimit të Shtetit”, por që roli i tyre në film “nuk del fare”, ndërsa shtetet që “i donin të keqen Shqipërisë” paraqiten Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe. Dervishi këmbëngul se ky film “ngre në pjedestal armën e Sigurimit të Shtetit”. Në platformën “YouTube” ky film është parë mbi 36,400 herë.

76. “Gjurmë në dëborë” (1984).

Realizim nga Edmond Tare dhe Roland Gjoza, subjekt i të cilit janë forcat e kufirit dhe “rreziku nga armiku i jashtëm”. Ngjarjet zhvillohen në një Postë Kufiri ku një grup ushtarësh vihen në pararojë pasi zbulojnë disa gjurmë nga ku dyshojnë për futjen e “një bande agjente të huaj”. Sipas Dervishit filmi ka në qendër propagandën e “vigjilencës revolucionare të masave mbi armikun e klasës” dhe ku “diversanti paraqitet me të njëjtat stereotipe dhe paragjykimet si në filmat e tjerë. Në “YouTube” ky film është parë mbi 17,200 herë.

77. “Militanti” (1984).

Realizim i Piro Milkani, Kiço Blushit dhe Kujtim Laros. Filmi i kushtohet “militantit” Vasil Shanto dhe ngjarjet vendosen në Shkodrën e pushtuar nga fashistët. Personazhi me emrin Visar Shundi (Timo Flloko) kërkon “të ngjallë ideologjinë komuniste”. Edhe pse realizimi kinematografik ka cilësi artistike, sidomos prej aktrimit të Fllokos, sipas Dervishit, ky film nuk duhet transmetuar pasi ka “manipulime të shumta historike, mbizotërohet nga parime

të luftës së klasave dhe urrejtjes ndaj forcave të tjera politike jokomuniste”. Në “YouTube”, ky film është parë më tepër se 27 mijë herë.

78. “Nata e parë e lirisë” (1984).

Film nga Esat Musliu, Vath Koreshi dhe Kujtim Laro. Sërish, ashtu si përgjatë gjithë prodhimtarisë së saj të ish-Kinostudios, tematika e luftës nacionalçlirimtare nuk reshtet së propozuari nga organet e Partisë. Ngjarjet në këtë film zhvillohen në Beratin e sapoçliruar, ku një grup partizanësh përpiqen të rikthejnë normalitetin në qytet. Dervishi këmbëngul që ky film të mos transmetohet sepse sipas tij “propagandon natën e parë të robërisë komuniste si natë lirie, ndërsa në qendër të filmit janë vjedhjet që i bëhen pasurisë së individëve që për tekat e pushtetit të ri quhen reaksionarë”. Në “YouTube”, ky film është parë mbi 43 mijë herë.

79. “Vendimi” (1984).

Film i Kristaq Dhamos, Spiro Dedes, Neshat Tozajt dhe Kujtim Laros. Edhe pse pretendohet të jetë bazuar në ngjarje të vërtetë, sipas Dervishit ky film “nuk i shpëton frymës së manipulimit të fakteve. Në qendër të filmit janë ngjarjet e majit 1942 në Tiranë, kohë kur gjithë dokumentacioni i Partisë Komuniste ra në dorë të italianëve. Por filmi nuk njih fare si protagonistë drejtuesit e Partisë Komuniste si Miladin Popoviçin dhe Dushan Mugoshën, duke u orvatur haptazi ta paraqesë Enver Hoxhën si drejtuesin e PKSH-së”. Megjithatë ky film gjendet mjaft i shpërndarë në “YouTube” dhe rezulton të jetë parë mbi 156 mijë herë.

80. “Asgjë nuk harrohet” (1985).

Realizim i Esat Ibros, Teodor Laços dhe Aleksandër Lalos. Filmi bën fjalë për ditët e sotme, por sillet herë-pas-herë me kontekste të së kaluarës për t'i veshur personazhet me më shumë tipare. Në mes diskutohet një ngjarje e së kaluarës që përfshin edhe hetuesinë. Sipas Dervishit, ky film bazohet në një ngjarje të vërtetë, por që faktet i “janë shtrembëruar të gjitha”. Sipas tij qëllimi i filmit “është të sjellë vijimësinë armiqësore të Ballit Kombëtar”. “Asgjë nuk harrohet” është parë në “YouTube” mbi 172 mijë herë.

81. “Hijet që mbeten pas” (1985).

Një film nga Esat Musliu, Diana Çuli dhe Maksim Shehu. Edhe pse në dukje ka temë sociale, në thelb ky film ka punën e një të riu që përballë një çështjeje që implikon edhe familjarët e së dashurës së tij, zgjedh të “refuzojë dashurinë” dhe të vendosë “me kurajë zgjidhjen e çështjes”. Sipas Dervishit, ky realizim nuk duhet transmetuar pasi në synimet propagandistike ka pasur si qëllim “të fusë frymën e përçarjes dhe të denoncimit brenda familjes”. Në “YouTube”, ky film është parë mbi 86 mijë herë.

82. “Historiani dhe kameleoni” (1989).

Film nga Saimir Kumbaro e Qamil Buxheli që flet për vitet e monarkisë ku trillohet një ngjarje kinse Mbreti Zog kërkonte të provonte prejardhjen e tij nga një familje e lashtë fisnike dhe për këtë angazhon një historian të huaj. Sipas Dervishit ky film nuk duhet transmetuar, pasi “paraqet një tablo krejt të pavërtetë, denigruese dhe poshtëruese të kohës”. Në “YouTube” ky film është parë mbi 76,500 herë.

REFERENCA

Fatos Lubonja, “Biznesi banal me nostalgjinë e komunizmit”; Korrieri, 16 dhjetor 2009 <https://bit.ly/2teqtz2>

Kastriot Dervishi, “Propaganda në filmat e komunizmit: Ekonomati te filmi Lulëkuqet mbi mure, babai i Nexhmijes” postim në Facebook, i botuar në Panorama, 23 Mars 2017. <https://bit.ly/2rwJYlc>

Artan Puto dhe Eldon Gjika, “Kinematografia shqiptare midis nostalgjisë, groteskut dhe të ardhmes. Një histori e treguar nga kineastët”, 2008, Revista Përpijka. Nr. 25

Jonila Godole, “Debati për kujtesën, përtej Kinostudios”; Gazeta Panorama, 27 mars 2017. <https://bit.ly/2WVbUxE>

Intervistë e Fatmira Nikollit me Piro Milkani, “Ndalimi i filmave të komunizmit: Çdokush e ka pultin në dorë”; “Gazeta Shqiptare”, 14 mars 2017. <https://bit.ly/2SpbX6F>

Artikull, “Ndalimi i filmave? Reshat Arbana: Ç’ të shohim, si bëhet seks tresh?!”; Panorama, 23 mars 2017 <https://bit.ly/2tg5EDj>

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, përgjigje kërkese për informim, datë 27/02/2018.

Arkivi Qendror Shtetëror; Dosja 71, viti 1961, “N. Sh Turizmit, Dega e Propagandës dhe Kulturës, relacion drejtuar Komitetit Qendror mbi punën e Albturizmit”.

Arkivi Qendror Shtetëror; 489, Presidiumi i Kuvendit Popullor viti 1989; 6, Drejtoriae Dekorimeve; Dosja 213 – Ceremoniae dekorimit për dhënien e titullit “Hero i Punës Socialiste” e dekoratave të tjera të larta disa kuadrove të Luftës Nacionalçlirimtare e të ndërtimit

socialist me rastin e 45-vjetorit të Çlirimit të Atdheut.
Qendra Kombëtare e Kinematografisë u krijua me Ligjin nr. 8096,
datë 21.3.1996 “Për kinematografinë”.

Intervistë me Alma Milen, “Ndalimi i filmave, shpërthen regjisori
Saimir Kumbaro: Po na trajtojnë si kriminelë”; Panorama 20 Mars
2017. <https://bit.ly/2SHXmlO>

Kastriot Dervishi, “Propaganda në filmat e komunizmit/
“Ekonomati te filmi “Lulëkuqet mbi mure, babai i Nexhmijes”
postim në Facebook, i botuar në Panorama 23 Mars 2017. [https://
bit.ly/2rwJYlc](https://bit.ly/2rwJYlc)

Ligje dhe dokumente zyrtare

Kontrolli i Lartë i Shtetit; Auditim i performancës së
Radiotelevizionit Shqiptar: “Projekti i digjitalizimit”; 2014 [https://
bit.ly/2MV2E8f](https://bit.ly/2MV2E8f)

Vendim Nr. 3 dt. 4.8.2017 Ministria e Kulturës; Këshilli
Kombëtar për të Drejtat e Autorit.

Vendim Nr. 4 dt. 10.10.2017 Ministria e Kulturës; Këshilli
Kombëtar për të Drejtat e Autorit.

Ligji nr. 35/2016, dt. 31.3.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të
drejtat e tjera të lidhura me to”.

Ligji nr. 9353, datë 3.3.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në
ligjin nr. 8096 datë 21.3.1996 Për kinematografinë”

Ligji nr. 9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të” (LDA).

VKM nr. 232, dt. 19.4.2006 “Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit”.

AMA; Raport vjetor 2017; <https://bit.ly/2DYNnAr>

RTSH; “Raport vjetor mbi ecurinë e RTSH” (2017) <https://bit.ly/2t7mMuW>

Kontrata e Shërbimit të Transmetimit Publik, AMA-RTSH
<https://bit.ly/2BmV55F>

RTSH, Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve të RTSH gjatë vitit 2017 <https://bit.ly/2I3vSTw>

RTSH, Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve të RTSH gjatë vitit 2015 <https://bit.ly/2SAM82N>

Intervista të renditura sipas kohës

Jonid Jorgji, Regjisor

Fatos Risto, Drejtor për programacionin në “Tring”

Agim Poçari, Drejtor për programacionin në “DigitAlb”

Rozeta Ferri, Drejtoreshë për programacionin në “RTSH”

Erald Kapri, Anëtar i Këshillit të Ankesave në “AMA”,

Esat Musliu, Kryetar i “FMAA”

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë
Debati mbi filmat e ish-kinostudios : propagandë apo
pasuri kombëtare?! : studim / IDMC. – Tiranë :
Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë, 2020

128 f. ; 14.8*21 cm.

Bibliogr.

ISBN 978-9928-4482-6-2


1.Filma artistikë 2.Komunizmi dhe shoqëria
3.Propaganda publike 4.Debate 5.Intervista
6.Shqipëri

791.43(496.5) (047.53)

Ky studim i IDMC-se është një kontribut i çmuar njohës, ndërgjegjësues e mediativ mbi trashëgiminë më agresive propagandistike të diktaturës, të ngjallur në hapësirën e lirive demokratike. Çështjen e kësaj trashëgime të diktaturës ky studim e shtron midis alternativës “propagandë” apo “pasuri kombëtare”, duke ofruar historikun, të dhënat, konsultimet me shifra të matshme dhe pikëpamjet e palëve të kundërta në debatin e vitit 2017 mbi filmat e periudhës komuniste. Dukuria është parë në planin historiko-ideologjik, e mandej, se si nga kjo kufomë e artit, nxirren përfitime jo të vogla, tash e 30 vite, nga po ajo korporatë që i pati krijuar këto filma indoktrinues. Është po kjo korporatë autorësh, që dashje - padashje ushtroi një kulturocid kombëtar në shërbim të propagandës, si në asnjë kulturë totalitare komuniste të Lindjes!

Agron Tufa
Ish- Drejtor i ISKK, Shkrimtar

ISBN 978-9928-4482-6-2



9 789928 448262 >